# ANALIZA E VEPRIMTARISË SË KËRKIMIT SHKENCOR NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS PËR VITIN 2024-2025

**GRUPI I PUNËS:**

1. PROF.DR. ERINDA LIKA
2. PROF. DR. ENDRIT KULLAJ
3. DR. ALKETA GREPCKA
4. ALMAIDA RAMAJ

## PËRMBAJTJA

**REALIZIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT** ........ **4**

FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)
FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)
INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE

**2. TË DHËNA MBI PROJEKTET E KËRKIMIT SHKENCOR** ........ **47**
FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)
FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)
INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE

**3. TË DHËNA MBI LIDHJEN E KËRKIMIT SHKENCOR MBI MËSIMDHËNIEN** ........ **51**
FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)
FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)

**4. INFRASTRUKTURA NË MBËSHTETJE TË KËRKIMIT SHKENCOR** ........ **76,86,97,106,114,118**

FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)
FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)

**5. STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR** ........ **80,91,101,108,115,123**
FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)
FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)

**6. ANALIZA E PRODUKTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR PËR VITIN 2025** ........ **126**

# LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| **UBT** | Universiteti Bujqësor i Tiranës |
| **FBM** | Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit |
| **FEA** | Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit |
| **FBU** | Fakulteti I Bioteknologjisë dhe Ushqimit |
| **FSHP** | Fakulteti I Shkencave Pyjore |
| **FMV** | Fakulteti I Mjekësisë Veterinare |
| **IRGJ** | Instituti I Resurseve Gjenetike |
| **BA** | Bordi i Akreditimit |
| **ASCAL** | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë |
| **MAS** | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| **SWG** | Study Working Group |
| **AADF** | Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim |
| **ADA** | Agjencia Austriake për Zhvillim |
| **AKKSHI** | Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit |
| **APPEAR** | Programi Austriak i Partneritetit në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin për Zhvillim |
| **ASHSH** | Akademia e Shkencave e Shqipërisë |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **CEPPUS** | Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare |
| **COST** | Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji |
| **DG EAC** | Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin, Rininë, Sportin dhe Kulturën |
| **DK** | Departamenti i Kimisë |
| **DSHUB** | Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë |
| **DTAU** | Departamenti i Teknologjisë Agro-Ushqimore |
| **ERC** | Këshilli Evropian i Kërkimeve |
| **Erasmus+** | Programi i Veprimit të Komunitetit Evropian për Lëvizshmërinë e Studentëve Universitarë |
| **ERDF** | Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal |
| **FAO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi. |
| **FBU** | Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit |
| **FSHN** | Fakulteti i Shkencave të Natyrës |
| **GMK** | Grup Mësimor-Kërkimor |
| **GIZ** | Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| **ICT** | Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë, Gjenevë |
| **Interreg Euro-MED** | Programi Evropian i Bashkëpunimit Territorial – Rajoni Mesdhetar |
| **MSCA** | Aksionet Marie Skłodowska-Curie |
| **PIKSH** | Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor |
| **PKKZH** | Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit |
| **QKU** | Qendra e Kërkimit të Ushqimit |
| **READ** | Ekspertizë Kërkimore nga Diaspora Akademike |
| **StG** | Grante Fillestare |
| **SE** | Shkëmbim Stafesh |
| **UBT** | Universiteti Bujqësor i Tiranës |
| **UT** | Universiteti i Tiranës |
| **UNIDO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial |
| **WBF** | Fondi i Ballkanit Perëndimor |

Veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njërën prej tre shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i njësive kruesore në UBT. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit akademik duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor, me ndikimin në jetën ekonomiko-sociale të vendit dhe me rritjen e stafit akademik në fushën e kërkimit shkencor.

Analiza kërkimore shkencore në UBT përgjatë vitit 2025 është bazuar në disa aspekte të rëndësishme si vijon më poshtë:

- politikat e kërkimit shkencor;
- lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
- produktet e stafit akademik të departamentit në fushat e kërkimit shkencor;
- Bashkëpunimi me Universitetin Boku, Vienna në drejtim të kërkimit shkencor;

## 1. REALIZIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

### 1.1 FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDIT (FBM)

FBM synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke promovuar inovacionin në teknologjitë bujqësore dhe mjedisore, bazuar në parimet e ruajtjes së natyrës dhe kujdesit për burimet strategjike si uji, toka dhe biodiversiteti. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit luan një rol qendror në kërkimin shkencor në Shqipëri, duke qenë institucioni udhëheqës në prodhimin e njohurive dhe inovacioneve në bujqësi, blegtori dhe shkencat mjedisore. Synimet e tij përqendrohen në zhvillimin e kërkimit aplikativ dhe të transferueshëm te fermerët, forcimin e bazës shkencore për politikat bujqësore, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe përgatitjen e profesionistëve të rinj me aftësi moderne menaxheriale e teknike. Fakulteti synon gjithashtu konsolidimin e partneriteteve kombëtare e ndërkombëtare, promovimin e inovacionit, dhe rritjen e ndikimit të kërkimit në ekonominë rurale dhe sigurinë ushqimore të vendit.

Kerkimi shkencor në nivel Departamenti zhvillohet në kuadrin e strategjisë së kërkimit shkencor të Fakultetit të ndara sispas specifikave të fushave që mbulon secili prj tyre.

Në mënyrë të përmbledhur kërkimi shkenvor në FBM eshte është aktivitet shumë planesh duke synuar në:

- Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, tokë, bime, kafshë, ujra, pejsazhe, dhe mbrojtja e mjedisit.
- Zgjerimin e njohurive në lidhje me praktikat e mira të prodhimit bujqësor dhe mbarështimit të kafshëve nëpërmjet futjes së teknologjive inovative
- Përdorimin e njohurive të gjeneruara nga kërkimi për pasurimin e kurrikulave dhe procesit te mësim dhënies si dhe trajnimin praktik të studentëve
- Përmirësimin e reputacionit dhe figurës akademike të Institucionit
- Rritjes profesionale dhe akademike të stafit të FBM
- Zgjerimi I mundësive për bashkëpunime me institucione të tjera brënda dhe jashtë vëndit
- Përmirësimin e politikave dhe masave shtetërore për bujqësinë
- Krijimin e punësimeve të reja nga diversifikimi I aktiviteteve bujqësore.

Sipas fushave të kërkimit janë përcaktuar objektivat dhe planifikuar aktivietet për realizimin e tyre. Sipas departamenteve:

- **DSHA** ka të përcaktuara mirë 15 fusha kërkimore shkencore realizimi i të cilave në pjesën dërmuese është bërë sipas planeve për secilën. Vetëm në dy fusha kërkimore ka mungese raportimi per reaizimin e aktiviteteve. . Vlen të përmendet se puna e kryer nga stafi i departit është mundësuar nga mbështetja financiare nga projektet kombëtare sidomos ato të lidhura me : *Prodhimin Bimor, Bimët aromatiko-mjekësore dhe Cilësisë së ujërave.*
- **DMBN** ka të përcaktuar një fushë kërkimi shkencor të lidhur mjedisin & burimet natyrore (toka, uji, biodiversiteti, mbetjet, kimikatet, ndryshimet klimatike). Te specifikuara nw katwr nwn fusha kwrkimi: Ndotja, degradimi dhe bio-rehabilitimi i tokave; Kontrolli i ndotjes së ujit, vlerësimi i cilesise dhe menaxhimi i integruar i burimeve ujore; Kontrolli i cilësisë së ajrit, reduktimi i ememetimeve te ndotesve dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike ; Ruajtja e biodiversitetit, restaurimi ekologjik dhe shërbimet e ekosistemeve
- **DSHZ** ka të përcaktua tre fusha kërkimore shkencore të lidhura me aspektet e të ushqyerit, përmirësi mit gjenetik dhe mbarështimti të kafshëve të fermës.
- **DHAP** ka një Strategji të Kërkimit Shkencor 2021-2025. Kjo Strategji përcakton edhe fushat prioritare të kërkimit në Departament dhe GMK duke u mbështetur tek disa fusha kërkimi të qëndrueshme në këto 10 vitet e fundit. Në total janë tre fusha kërkimi të ndara me nënfusha për secilën nga GMK e departamentit: fusha A. Intensifikimi i qëndrueshëm në hortikulturë; fusha B : Ndërvepriet bimë hortikulturë mjedis dhe fusha C; sistemet e projektimit të peisazhit . Departamentit vazhdon të ruajë objektiva të kërkimit që çojnë përpara njohuritë në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi të pranuara në nivel ndërkombëtar. Intensifikimi i Qëndrueshëm në Hortikulturë, Ndërveprimet Bimë Hortikulturore–Mjedis,Sistemet dhe Projektimi i Peizazhit për të arritur dhe ruajtur një lidership kombëtar dhe rajonal. Një avancim i rëndësishëm ishte edhe vënia në funksionim e "Horti Smart Lab" një laborator i ri kërkimor dhe mësimor që do të avancojë më tej kërkimin në fushën e teknologjive të vjeljes, pasvjeljes e cilësisë. Ky laborator u promovua në disa evente duke tërhequr vëmendjen e disa donatorëve si GIZ dhe FAO që mund të ofrojnë bashkëpunim.
- **DMB** ka të përcaktuara një fushë kërkimi me tre objektiva të cilat lidhen me fudha të kërkimi të lidhura me disagnostikimin e demtuesve karantinore, hartimin e pketave te kotrollit të integruar dhe implementimi i kontrollit biologjik
- **DAP** realizon kërkimin në dy fusha atë të akuakulturës dhe hidrobiologjisë dhe peshkimit. Kërkimi synon në përmirësimin e teknologjive të rritjes së peshqve të kultivuar dhe sigurimin e cilësise se produkteve të akuakulturës. Në fushën e dytë sybohet të zgjerohet informacioni në lidhje me me menaxhimin e peshkimit ne rajone te ndryshme te Shqiperise dhe diversitetin e gjallesaveujore dhe rezervave peshkore, si dhe futjen e metodave të qëndrueshme të peshkimit duke minimizuar ndikimin negativ në mjediset ujore. Fushat e Kerkimit Shkencor ne ne menyre specifike, GMK e Akuakultures, fokusi i veprimtarisë kërkimore te saj janë teknologjitë e reja në fushën e akuakulturës detare dhe atë të ujërave të brendshme, shëndeti i peshqve dhe cilësia e siguria e produkteve të akuakulturës. Gjithashtu një fushë e re kërkimi e këtij grupi është akuariologjia dhe kultivimi i peshqve dekorativë. Lidhur me GMK e Peshkimit dhe Hidrobiologjise, fokusi i aktiviteteve te kerkimit shkencor vendoset kryesisht në biodiversiteti i gjallesave ujore, dinamiken

e popullatave peshkore dhe rezervat e tyre, shfrytëzimin e qëndrueshëm te rezervave, menaxhimin e integruar te burimeve peshkore dhe minimizimin e ndikimit të aktivitetit të peshkimit në habitatet ujore dhe biodiversitetin perkates. Në fokus janë gjithashtu çështjet që lidhen me përbërjen dhe parametrat fiziko-kimikë të trupave ujore, problemet e kontaminimit organik, mikrobiologjik apo mbetjet kimike në trupat ujore.

| Nr | Fakulteti/ Departamenti | Fusha e kerkimit shkencor | Objektivi/at* | Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete | Realizimi i aktiviteteve | Afati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FBM/DSHA | Prodhimi i bimeve te arave | Perseritja e eksperimenteve fushore ne kuadet te doktorates me titull "Ndikimi i marrëdhenies së N dhe K në qëndrueshmërinë e prodhimit dhe pjellorinë e tokës, në kushte të ndryshme klimatike dhe tokësore" | Ringritur eksperimenti ne EDE dhe marre rezultatet e vitit 2024-2025 | Ka kryer analizat e bimes dhe te tokes. Ka kryer 3 prezantime ne kuader te doktoratures. Prezantimi i fundit do te mbahet ne muajt pasaardhes | 2022-2025 |
| 2 | FBM/DSHA | Perberesit fitokimike ne Bimet mjekesore | *Achillea millefolium* – etnobotanika, biaktiviteti i përbërësve fitokimikë në zona të ndryshme të vendit tonë dhe përdorimet e saj mjekësore. | Analizimi i vajrave esenciale si dhe analizimi i mostrave te tokes dhe bimes per permbajtjen e mirodhe makroelementeve ne mostrat e grumbulluara gjate vitit te dyte si dhe kultivimi i farave te bimes se Achillese ne kushte laboratorike | Jane realizuar analizat fitokimike ne bime si dhe jane analizuar mikro dhe makroelemntet ne toke dhe ne bime. Ka kryer 3 prezantime ne kuader te doktoratures. Prezantimi i fundit do te mbahet ne muajt pasaardhes | 2022-2025 |
| 3 | FBM/DSHA | Rritja e Diversitetit Bujqësor: Vlerësimi I potencialit te rritjes se Nigella Sativa L. në Tokat bujqesore Shqiptare" | Vleresimi dhe karakterizimi I gjenotipeve te ndryshme te Nigella Sativa L bazuar ne parimet e qendrueshme te Kombeve te Bashkuara SDG2030 | Grumbullimi I materialit gjenetik nga bankat gjenetike te Ukraine, Poloni ,Washington dhe kompani prodhimi te farave.Ngritur eksperimenti ne 3 zona:1-FDE UBT,2-FDE Korce,3-QTTB Shkoder ku jane marre rezultatet e vitit te pare | Jane realizuar analizat e proteinave, karbohidrateve dhe yndyrnave ne bime. Ka kryer 3 prezantime ne kuader te doktoratures. Prezantimi I fundit do te mbahet ne muajt pasaardhes | 2022-2025 |
| 4 | FBM/DSHA | Dixhitalizimi ne bujqesi | Mbledhja e te dhenave klimatike, topografike, fiziko-kime dhe social ekonomike. Perpunimi ne ArcGIS 10.2, dhe standartizimi i kritereve dhe nenkritereve ne klasa pershtatshmerie sipas | Perpunimi dhe ndertimi i i bazes se te dhenave. Generimi i materialit harografik ne ArcGIS per seicilin nenkriter. | Perdorimi GIS per uljen e aplikimit te agrokimikateve si dhe shfrytezimin e burimeve natyrore. Ka kryer 3 prezantime ne kuader te doktoratures. Prezantimi I fundit do te mbahet ne muajt | 2022-2025 |
| 5 | FBM/DSHA | Permiresimi gjenetik i bimeve, kultivimi I qendrueshem | "Ngritjae nje eksperimenti ne kuadrin e doktoratures me titull "Vlerësimi i diversitetit gjenetik të hikërrorit (*Fagopyrim esculentum* ), përmirësimi gjenetik dhe potencialet e kultivimit në Shqiperi. | Permiresimi gjenetik i bimeve, kultivimi I qendrueshem | Ka vonesa ne kryerjen e analizave. Ka kryer 2 prezantime ne kuader te doktoratures. Prezantimi I fundit do te mbahet ne muajt pasaardhes | 2022-2025 |
| 6 | FBM/DSHA | Cilësi ujërash | Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse të DSHA në sigurimin e të ardhurave | Realizimi me sukses i projekteve PKKZH të fituara. | Pregatitja e raporteve te pjesshme ose te plota per mbylljen e tyre, sipas afatit të përcaktuar. | 2023-2024 |
| 7 | FBM/DSHA | Ngritja e nje laboratori për bujqësinë | Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse të DSHA në sigurimin e të ardhurave | Realizimi me sukses i projektit PIKSH të fituar. | Mobilimi i laboratorit dhe montimi e paisjeve dhe fillimin e punes shkencore | 2025 |
| 8 | FBM/DSHA | Shkëmbim stafi dhe studentësh | Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat | Realizimi me sukses i projekteve COST: HORIZON; ERASMUS të fituara. | Pregatitja e raporteve te pjesshme ose te plota per mbylljen e tyre, sipas afatit të përcaktuar. | 2023 - vazhdim |
| 9 | FBM/DSHA | BAM | Vleresimi i linjave te rigonit te krujuara ne fushen ekperimentale | Vazhdimi i punes ne terren | Identifikimi I linjave te cilat kane cilesi te pershtateshme per kompanite e MAPs ne shqiperi | 2025 |
| 10 | FBM/DSHA | BAM | Identifikimi I diversitet gjenik tek Althea officinalis ne fushen eksperimentale | Vazhdimi i punes ne terren | vleresim paresor per linjat qe mund te futen ne nje program te permiresimit gjenetik | 2025 |
| | FBM/DSHA | BAM | Percaktimi I standarteve dhe manualeve te tharjes per maps ne fushen | Vazhdimi i punes ne terren | pergatitja e manuale te tharjes per Maps te ndryshme | 2025- |
| 11 | FBM/DSHA | BAM | Studimi i bimëve qe permbajne Alkaloidet Pirolizidine (PA), bashke shoqëruese të Bimeve Aromatike dhe Mjekesore (BAM) të kultivuara, mundësitë e kontrollit në funksion të ruajtjes dhe rritjes se cilësisë të BAM, | Vazhdimi i punes ne terren | | 2025-2026 |
| 12 | FBM/DSHA | Vleresimi I linjave te rigonit te krujuara ne fushen ekperimentale | Vleresimi morfologjik, agronomi, permbajtja kimike | Pune ne terren | Identifikimi I linjave te cilat | 2025-2026 |
| | FBM/DSHA | Identifikimi I diversitet gjenik tek Althea officinalis ne fushen eksperimentale | Identifikimi I linjave | Pune ne terren | Vleresim paresor per linjat qe mund te futen ne nje program te permiresimit gjenetik | 2025-2027 |
| 13 | FBM/DSHA | Percaktimi I standarteve dhe manualeve te tharjes per maps ne fushen ekperimentale | Percaktimi I standarteve | Pune ne terren | Pergatitja e manuale te tharjes per Maps te ndryshme | 2025- |
| 14 | FBM/DSHA | Studimi i bimëve qe permbajne Alkaloidet Pirolizidine (PA), bashke shoqëruese të Bimeve Aromatike dhe Mjekesore (BAM) të kultivuara, mundësitë e kontrollit në funksion të ruajtjes dhe rritjes se cilësisë të BAM, financuar AKKSHI 2024-2026 | | A. Ibraliu, N Kadiasi, R. Tako | | 2025-2026 |
| 15 | FBM/DSHA | Mek.Bujqesore | Niveli dhe shkalla e mekanizimit Reethi Fier. | Studimi ne njesine frakull e Divjake I nivelit e shkalla e mekanizimit | Sipas programit jemi ne perfundim te tij. | 2024-2025 |

**Tabela 1.1:** Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit (FBM)

| Nr. | Fakulteti/ Departamenti | Fusha e kerkimit shkencor | Objektivi/at* | Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete | Realizimi i aktiviteteve | Afati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FBM/DSHZ | Vlerësimi kimik dhe nutritiv i ushqimeve per blegtorine | Analizimi i kampioneve të ushqimeve për ferma gjedhi , në funksion tehartimit te racioneve ushqimore | Kampione ushqimesh nga 9 ferma gjedhi. | Janë kryer 600 analiza | Gjatë viti |
| 2 | FBM/ DSHZ | Vlerësimi i diveristetit gjenetik te kafsheve te fermë | Nuk ka patur aktivitet konkret. | | | |
| 3 | FBM/DSHZ | Teknologjite inovatime ne mbareshtimin eirpertypesve dhe monogastrikëve | Nëpërmjet trajnimeve ne ferme të prezntohem mundesite per inovacion e teknologji te avancuara. | Trajnime në fermat e gjedhit, dhenve dhe dhive, si dhe ne fermat e bletëve | Janë kryer 9 trajnime ne fermë. | Gjatë viti |
| 4 | FBM/DMB | Mbrojtje Bimesh | Diagnostikimi i dëmtuesve karantinorë e të zakonshëm | Kërkimi shkencor i studenteve në Master Shkencor e Doktorature. | Në laborator | |
| 5 | FBM/DMB | Mbrojtje Bimesh | Hartimi i paketave të kontrollit të integruar | Diagnostikimi i dëmtuesve për përcaktimin e zonave të mbrojtura nga dëmtuesit karantinorë | Në laborator | |
| 6 | FBM/DMB | Mbrojtje Bimesh | Implementimi i kontrollit biologjik për demtuesit kryesore. | Percaktimi i agjenteve te dobishem ne kuadrin e mbrojtjes biolgojike. | Në fushë | |
| 7 | FBM/DMBN | Shkenca mjedisore dhe burimet natyrore (toka, uji, biodiversiteti, mbetjet, kimikatet, ndryshimet klimatike | Të japë kontribut përmes rritjes së njohjes për çështjet mjedisore dhe adresimin e zgjidhjes së tyre | Zhvillimi i kërkimit si pjesë e studimeve të ciklit të tretë dhe plotësimi i kritereve për mbrojtjen e doktoraturave në Shkencat Mjedisore | Çdo vit | |
| | **Nën Fushë** | | | | | |
| | **FBM/ DMBN** | : Ndotja, Degradimi dhe Bio-Rehabilitimi i Tokave | Të vlerësohet shkalla, burimet dhe ndikimet e ndotjes së tokës si dhe të zhvillohen strategji rehabilitimi të bazuara shkencërisht që rikthejnë shëndetin e tokës si ekosistem dhe | Realizimi i kerkimit shkencor si pjesë e ciklit të tretë të studimeve doktorate në Shkencat Mjedisore, artikuj, pjesemarrje ne konferenca, etj | Çdo vit | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | mbështesin prodhimin e qëndrueshëm bujqësor | | | |
| | **FBM/DMBN** | Kontrolli i Ndotjes së Ujit, Vlerësimi i Cilesise dhe Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore | Të vlerësohet statusi kimik, bilogjik dhe sasior i ujërave, të identifikohen presionet dhe burimet ndotëse, modelimi i emetimit te ndotesve si dhe të hartohen qasje të integruara të menaxhimit në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuader të Ujit, për të siguruar mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore dhe ekosistemeve | | | |
| | FBM/DMBN | Kontrolli i Cilësisë së Ajrit, Reduktimi i Ememetimeve te Ndotesve dhe Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike | Të vlerësohen dhe modelohen emetimet e ndotësve të ajrit, të vlerësohen ndikimet mjedisore dhe shëndetësore, dhe të zhvillohen strategji efektive për zbutjen e ndotjes së ajrit dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike | | | |
| | FMB/DMBN | Ruajtja e Biodiversitetit, Restaurimi Ekologjik dhe Shërbimet e Ekosistemeve | Të vlerësohet statusi i biodiversitetit dhe degradimi i ekosistemeve, të identifikohen kërcënimet kryesore dhe të zhvillohen masa restaurimi dhe konservimi që rrisin qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ruajnë funksionet ekologjike dhe sigurojnë shërbimet e ekosistemeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm | | | |
| | FBM/DAP | Akuakulture | Teknologjitë e reja në fushën e akuakulturës detare dhe atë të ujërave të brendshme<br>Shëndeti i peshqve dhe cilësia e siguria e produkteve të akuakulturës<br>akuariologjia dhe kultivimi i peshqve dekorativë | Kerkim ne literarture dhe perditesimi i informacioneve dhe dijeve per hartiminin e kurrikulave te drejtimit ne Akuakulture, te pershtatura me modelin e BOKU-Vjene | | |
| | FBM/DAP | Peshkimi dhe Hidrobiologjia | Biodiversiteti i gjallesave ujore<br>Dinamiken e popullatave peshkore dhe rezervat e tyre, | Kerkim ne literarture dhe perditesimi i informacioneve dhe dijeve per hartiminin e kurrikulave te drejtimit ne | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shfrytëzimin e qëndrueshëm te rezervave menaxhimin e integruar te burimeve peshkore dhe minimizimin e ndikimit të aktivitetit të peshkimit në habitatet ujore dhe biodiversitetin perkates | Peshkim, te pershtatura me modelin e BOKU-Vjene | | |
| **Nr** | **Fakultet/ Departament** | **Fusha e kërkimit shkencor** | **Objektivat*** | **Realizimi i aktiviteteve** | **Afati** | **Komente** |
| 1 | **DHAP** | **PDHA Intensifikimi i Qëndrueshëm në Hortikulturë** | *Prodhimi qëndrueshëm në hortikulturë* | Studimi mbi testimin e folive mulçiruese të biodegradueshme | 2025 | |
| | | | *Përshtatshmëria e nënshartesave dhe kultivarëve* | Disa studime të kultivarëve të pemëve bërthamore | 2025 | |
| | | | *Hershmëria e disa produkteve hortikulturore* | - | 2025 | |
| 2 | **DHAP** | **Ndërveprimet Bimë Hortikulturore – Mjedis** | *Përshtatja e bimëve hortikulturore ndaj një klime që ndryshon* | Aktivitete në kuadër të projekteve | 2025 | |
| | | | *Përmirësimi i prodhimtarisë nëpërmjet manipulimit të rizosferës* | Disa tema masteri shkencor dhe studime të mirëfillta | 2025 | |
| 3 | **DHAP** | **Sistemet e Projektimit të Peizazhit** | *Përmirësimi i shërbimeve të ekosistemeve* | Studime në kuadër të doktoraturës | 2025 | |
| | | | *Rëndësia e peizazhit urban në promovimin e shëndetin dhe të mirëqenies publike* | | 2025 | |
| | | | *Integrimi i materialeve bimore dhe arkitekturës së peizazhit* | Disa studime në nivelin master | 2025 | |

## KONKLUZION

### a) Përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të kërkimit shkencor;

Fushat e kërkimit përputhen me strategjinë e kërkimit në FBM. Analiza e aktivitetit kërkimor në departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit tregon një angazhim të gjerë dhe shumëdrejtimësh në fushat shkencore prioritare, me rezultate të prekshme veçanërisht në departamentet që disponojnë infrastrukturë të konsoliduar laboratorike ose që janë të lidhura me sektorin prodhues dhe fermat.kanë realizuar një gamë të gjerë aktivitetesh kërkimore, eksperimentale dhe inovative. Analiza e punës së raportuar në tabelë tregon si vijon më poshtë:

**Departamenti i Shkencave Agronomike (DSHA)**

- **Projektet e doktoraturës kanë vijuar sipas planifikimit**, ku të gjithë doktorantët kanë realizuar eksperimentet fushore, analizat laboratorike dhe prezantimet e kërkuara. Për një projektstudimi ka pasur vonesa për shkak të problematikave në terren me realizimin e kesperimentit, por aktivitetet pritet të finalizohen në muajt në vijim.
- **Projektet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare** (PKKZH, AKKSHI, HORIZON, COST, ERASMUS) janë zbatuar sipas afatit, duke siguruar rezultate konkrete dhe duke gjeneruar të ardhura shtesë për institucionin.
- **Eksperimentet fushore në kulturat bujqësore, bimët mjekësore dhe aromatike (BAM), përmirësimin gjenetik dhe cilësinë e tokave dhe ujërave** kanë dhënë rezultate të matshme dhe të dokumentuara.
- **Ngritja e laboratorit të ri për bujqësinë** ka avancuar sipas projektit dhe pritet të rrisë ndjeshëm kapacitetin kërkimor të Departamenteve në vitet e ardhshme.
- **Mobilitetet e stafit dhe studentëve** nëpërmjet projekteve europiane kanë forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe transferimin e njohurive.
- **Digitalizimi i të dhënave në bujqësi** përmes GIS përfaqëson një drejtim inovativ që përputhet me praktikat bashkëkohore të bujqësisë së zgjuar (Projekt nga AKKSHI dhe studim doktorature).

**Departamenti i Shkencave Zooteknike** (DSHZ) ka realizuar objektivin për vlerësimin kimik dhe nutritiv të ushqimeve për blegtorinë, duke analizuar **600 mostra** nga nëntë ferma gjedhi, aktivitet që kontribuon drejtpërdrejt në hartimin e racioneve ushqimore dhe mbështetjen e performancës blegtorale. Për inovacionet në mbarështim, janë zhvilluar **9 trajnime në ferma** gjedhi, dhish, dhenësh dhe bletësh, të cilat kanë rritur përhapjen e teknologjive bashkëkohore në fermat shqiptare. Megjithatë, fusha e vlerësimit të diversitetit gjenetik nuk ka shënuar aktivitet konkret gjatë vitit.

**Në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve (DMB),** objektivat kërkimore janë realizuar në përputhje me planifikimet: janë kryer diagnostikime laboratorike të dëmtuesve karantinorë dhe atyre të zakonshëm, janë zhvilluar kërkime për hartimin e paketave të kontrollit të integruar dhe janë realizuar eksperimente në fushë për identifikimin e agjentëve të dobishëm në kuadrin e kontrollit biologjik. Aktivitetet janë integruar në temat e studimeve Master dhe Doktoratë, duke forcuar lidhjen mes kërkimit dhe formimit akademik.

**Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrorore (DMBN)** ka pasur një aktivitet kërkimor të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, duke kontribuar në studime mbi ndotjen dhe degradimin e tokave, ndotjen e ujërave, cilësinë e ajrit, ndikimet e ndryshimeve klimatike, si dhe restaurimin ekologjik dhe ruajtjen e biodiversitetit. Këto fusha përbëjnë boshtin e studimeve të nivelit të tretë (Doktoratë), të cilat

përfshijnë prodhim shkencor, artikuj dhe pjesëmarrje në konferenca, duke siguruar progres të vazhdueshëm drejt objektivave të programit.

**Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit (DAP)** ka përmbushur objektivat nëpërmjet studimeve teorike dhe përditësimit të informacionit shkencor për hartimin e kurrikulave të reja të programeve në akuakulturë dhe peshkim, të bazuara në modelet ndërkombëtare si ai i Universitetit BOKU të Vjenës. Në këtë departament janë adresuar çështje që lidhen me biodiversitetin ujor, dinamikën e popullatave peshkore, shëndetin e peshqve dhe sigurinë ushqimore.

**Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit (DHAP)** ka zhvilluar një sërë studimesh kërkimore në kuadër të objektivave të tij: intensifikimi i qëndrueshëm i prodhimit hortikulturor, ndërveprimet bimë–mjedis dhe sistemet e projektimit të peizazhit. Janë realizuar studime mbi nënshartesat dhe kultivarët, testimin e materialeve biodegraduese, tema masteri dhe doktoraturash, si dhe kërkime mbi ndikimin e peizazhit urban në mirëqenien publike.

Në tërësi, fakulteti ka realizuar një pjesë të konsiderueshme të objektivave të planifikuara, me ndikim të drejtëpërdrejtë në mësimdhënie, përgatitjen e studentëve dhe lidhjen e kërkimit me sektorin bujqësor, mjedisor dhe agro-ushqimor. Megjithatë, vihen re edhe fusha ku aktiviteti ka qenë minimal ose i munguar, veçanërisht në drejtim të diversitetit gjenetik, duke sinjalizuar nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e bashkëpunimeve kërkimore në nivel departamental dhe ndërdepartamental.

Bazuar në këto të dhëna, **mund të konkludohet se objektivat kërkimore janë përmbushur në masën më të madhe**, dhe departamentet kanë ruajtur ritmin e zhvillimit kërkimor edhe në kushte sfiduese infrastrukturore dhe laboratorike.

**b) PËRPUTHSHMERIA E FUSHAVE TË KËRKIMIT NË NIVEL DEPARTAMENTESH ME FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR NË FAKULTET.**

Fushat e kërkimit në nivel departamentesh tregojnë një koherencë të lartë me orientimet strategjike të kërkimit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), duke reflektuar qasje sistemike dhe ndërdisiplinare në trajtimin e çështjeve agro-mjedisore. Përputhshmëria vlerësohet në disa dimensione teknike:

**Koherenca tematike me prioritetet e fakultetit:**

- Çdo departament adreson drejtpërdrejt një grup tematikash që përbëjnë boshtet kërkimore të FBM, si: menaxhimi i qëndrueshëm i prodhimit bujqësor, bio-sigurimi i zinxhirit ushqimor, mbarështimi i kafshëve, bioteknologjitë e avancuara, mbrojtja integruar e bimëve, degradimi i tokës, ndotja e ujit dhe ajrit, ndikimet klimatike dhe ruajtja e biodiversitetit.
- Këto fusha përbëjnë prioritetet strategjike të fakultetit për kërkim dhe inovacion, dhe departamentet kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në to.

**Specializime të dallueshme që plotësojnë strukturën kërkimore të FBM:**

- **DSHZ** kontribuon në bio-nutricion blegtoral, vlerësim kimik të ushqimeve, mbarështim të qëndrueshëm dhe aplikim të teknologjive inovative në fermë.
- **DMB** fokusohet në diagnostikim fitosanitar, patologji bimore, kontroll biologjik, protokolle të IPM dhe menaxhim të rrezikut fitosanitar.
- **DMBN** mbulon një spekter të gjerë të shkencave mjedisore, me theks në mbrojtjen e mjedisit, hidro-ekologji, ekologji tokësore, vlerësim të cilësisë së ajrit, ciklet biogeo-kimike dhe proceset e rehabilitimit ekologjik.

- **DAP** adreson sistemet ujore, akuakulturën, shëndetin e peshqve, ekologjinë e ujërave të brendshme dhe menaxhimin e rezervave peshkore.
- **DHAP** kontribuon në teknologjitë hortikulturore, adaptimin e kultivarëve në kushtet klimatike, materialet biodegraduese, rizosferën si sistem funksional dhe planifikimin e peizazhit me bazë ekologjike.

**Ndërdisiplinaritet i shprehur qartë**

- Fushat e kërkimit mes departamenteve krijojnë ndërveprime teknike që mundësojnë integrimin e kërkimit në shkallë ekosistemi (tokë-ujë-bimë-kafshë-klimë).
- Shumë prej çështjeve që trajton fakulteti—si ndotja e ujit, menaxhimi i tokës, prodhimi i qëndrueshëm, ekologjia e peizazhit dhe teknologjitë inovative në bujqësi—kërkojnë bashkëpunim ndër departamentesh, i cili tashmë evidentohet në studimet Master, Doktoratë dhe projektet aplikative.

**Harmonizim me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe Direktivave të BE-së**

- Fushat e kërkimit të departamenteve reflektojnë objektivat ndërkombëtare si SDG 2 (Zero Hunger), SDG 6 (Ujë i pastër dhe kanalizime), SDG 13 (Ndryshimet klimatike) dhe SDG 15 (Jeta në tokë).
- Në të njëjtën kohë, temat kërkimore të DMBN dhe DAP lidhen ngushtë me Direktivën Kuadër të Ujit, Strategjitë e BE-së për biodiversitetin, strategjinë "Farm to Fork" dhe objektivat e Green Deal.
- Ky harmonizim dëshmon përputhshmërinë e kërkimit me standardet europiane.

**Lidhja e drejtpërdrejtë e aktivitetit kërkimor me programet studimore**

- Në shumicën e departamenteve, temat e Masterit dhe Doktoraturës janë të orientuara nga prioritetet kërkimore të fakultetit, duke siguruar vijueshmëri midis kërkimit, mësimdhënies dhe zhvillimit të kapaciteteve akademike.
- Kjo përputhshmëri garanton që kërkimi shkencor të mos mbetet i izoluar, por të integrohet në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve.

**Strukturë kërkimore e qëndrueshme dhe e konsoliduar**

- Departamentet që disponojnë laboratorë aktivë (p.sh. Mbrojtja e Bimëve, Agromjedisi, Mikrobiologjia, Ushqimet për Kafshët) arrijnë nivel më të avancuar kërkimi dhe prodhim më të lartë shkencor.
- Kjo tregon përputhshmëri funksionale: fusha të caktuara kërkimi zhvillohen pikërisht aty ku ekziston infrastruktura dhe ekspertiza përkatëse.

Në tërësi, fushat e kërkimit të departamenteve janë të harmonizuara me politikat dhe objektivat e kërkimit të fakultetit, duke mbështetur një qasje holistike dhe ndërdisiplinare në studimin e sistemit agro-mjedisor. Ky nivel përputhshmërie garanton eficiencë, koherencë shkencore dhe potencial të lartë për zhvillim të projekteve të avancuara kërkimore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.

## 1.2 FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) kryen veprimtari kërkimore bazë ose të zbatuar, studime shkencore, ofron ekspertizë për të tretë si dhe veprimtari të tjera që synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kërkimit. Kërkimi shkencor në FEA realizohet në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së UBT-së, si dhe fushat parësore të identifikuara nga AKKSHI. Fakulteti në fillim të çdo viti akademik përcakton fushat, drejtimet, vëllimin e punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore - shkencore. Njësia kryesore dhe njësitë bazë të FEA-s nxisin realizimin e tyre nga personeli akademik.

Veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njërën prej tre shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit të tij akademik duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor, me ndikimin në jetën ekonomiko-sociale të vendit dhe me rritjen e stafit akademik në fushën e kërkimit shkencor. Roli që ka Fakulteti sot në lidhje me perspektivën e kërkimit pritet të shoqërohet me rritje të financimit dhe ndërkombëtarizimin duke ruajtur avantazhin krahasues në burimet njerëzore dhe eksperiencën institucionale.

### 2.1 REALIZIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Gjatë vitit 2024-2025 u krye rishikimi i fushave prioritare të kërkimit si një përgjigje ndaj kushteve dhe problematikave të kohës dhe ndryshimeve strukturore. Rishikimi i fushave kërkimore ka ardhur si domosdoshmëri e zhvillimit të performancës akademike të stafit, kryesisht e kolegëve doktorantë. Objektiv kryesor i FEA – s është gjithashtu t'i inkurajojë doktorantët dhe jo vetem për analiza të thelluara kritike e të argumentuara në fushat hulumtuese përkatëse, si edhe të nxisi kërkimet dhe studimet me karakter aplikativ në fushat përkatësë të kërkimit shkencor.
Kryesisht departamentet kanë arritur objektivat kërkimore nëpërmjet projekteve dhe punëve të përbashkëta të kryera me studentët e niveleve Doktorature, Master dhe Master ekzekutiv. Megjithatë ia vlen të theksohet se këtë vit aktiviteti kërkimor ka qenë më lartë dhe më cilësor se vitin që shkoi, kjo dallohet jo vetëm nga numri më i lartë i botimeve si produkti direkt i kërkimit por edhe nga një numër më i lartë në revista të indeksuara në Scopus / Web of Science.

- **Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural** edhe pse është relativisht i vogël, ka tejkaluar realizimin e aktiviteteve të planifikuara kjo falë kapaciteteve të stafit akademik eksperiencës, por edhe falë natyrës ndërdisiplinore të tij.
- Kërkimi në **departamentin e Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural** mbështetet në tre drejtimet kryesore të punës të EPZHR: Politikat e qëndrueshme dhe të Zhvillimit rural, Ekonomiksi i aplikuar në bujqësi dhe Çështje të përdorimit optimal të burimeve ekonomike nëpërmjet optimizimit të përdorimit të tyre dhe përdorimin e burimeve natyrore. Ky departament përbëhet nga një staf akademik me një eksperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe studime, e botime të njohura edhe në shkallë ndërkombëtare. Personeli akademik gjatë karrierës së tij ka realizuar një numër të konsiderueshëm botimesh, vlera e të cilave tregohet në bazë të citimeve për secilin autor.
- Stafi akademik i **departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit** e ka zhvilluar aktivitetin e tij, mësimdhënie dhe kërkim-shkencor, në 3 drejtime të rëndësishme; Administrim, Drejtim dhe Marketing. Kërkimi shkencor në këtë departament përbën një drejtim të rëndësishëm të veprimtarisë së stafit

akademik. Theksojmë se kërkimi shkencor është i fokusuar në fushat prioritare të si në Strategjitë e menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi, Strategjitë dhe politikat e menaxhimit të agrobiznesit, Strategjitë dhe politikat e integrimit dhe kooperimit të fermerëve në tregje etj.

- Qëllimet dhe objektivat e **Departamentit të Gjuhëve të Huaja** lidhen ngushtësisht me studime të thelluara në fushën e terminologjisë, përmirësimin e metodave të mësimdhënies në funksion të lëndës gjuhë e huaj anglisht etj, si edhe studim mbi ndikimin e drejtpërdrejtë që kjo lëndë ka, jo vetëm në formimin e përgjithshëm të studentit, por edhe si një vlerë e shtuar në prezantimin me terminologjinë e fushës në funskion të studimeve të thelluara në lëndë të tjera që lidhen me profesionet specifike.
- **Departamenti Financë Kontabilitet** ka si fushë prioritare kërkimi Menaxhimi dhe vendimmarja financiare me objektiv kryesor në drejtim të përdorimit të metodave satistikore në kuadër të drejtimit dhe vendimmarrjes financiare.

**KONKLUZION:**

Të gjitha fushat e kërkimit të departamenteve:

- janë mbuluar me aktivitete kërkimore-shkencore të personelit akademik.
- kanë pasur përfshirje të studentëve.
- kanë pasur pjesëmarrje në konferenca shkencore.
- kanë pasur publikime në formën e artikujve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht.
- kanë përputhshmëri të plotë të fushave të kërkimit të Departamenteve me fushat e kërkimit shkencor në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit.
- kanë një qasje multidisiplinare në kërkim.
- Fusha e kërkimit të DGJH shërben si një fushë mbështetëse për fushat e kërkimit në departamente të tjera.

**Tabela 1.2 :** Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit Dhjetor 2024 - Nentor 2025 (FEA)

| Fakulteti/ Departamenti | Fusha e kërkimit shkencor | Objektivi/at* | Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete | Realizimi i aktiviteteve | Afati | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dep: Drejtimi Agrobiznesit | Strategjitë e menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi. | Analiza e efektivitettit të strategjive të menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Strategjitë dhe politikat e menaxhimit të agrobiznesit. | Studimi i strategjive dhe politikave të menaxhimit të agrobiznesit | Pjesëmarrja në projekte dhe studime,;Botime të artikujve shkencorë;Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Strategjitë dhe politikat e integrimit dhe kooperimit të fermerëve në tregje | Analiza e nivelit te integrimit dhe kooperimit te fermereve. Evidentimi i problematikave dhe alternativave per tejkalimin e tyre | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Botime të artikujve shkencorë;Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Strategjitë dhe politikat e financimit të sipërmarrjeve private në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të tyre | Analiza e e efektivitetit te strategjive dhe politikave te financimit të sipërmarrjeve private në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të tyre | Botime të artikujve shkencorë;Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Probleme të menaxhimit dhe marketingut në zinxhirin e furnizimit/vleres/ofertes per produktet ushqimore përfshire cluster-at. | Analiza e strategjive dhe prktikave te marketingut në zinxhirin e furnizimit per produktet ushqimore përfshire cluster-at. | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Aspekte të analizes se tregjeve dhe sjelljes konsumatore per produktet ushqimore. | Studim tregu dhe analize e sjelljes konsumatore per produktet ushqimore | Pjesëmarrja në projekte dhe studime,;<br>Botime të artikujve shkencorë;<br>Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.<br>Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Probleme të menaxhimit të zinxhirëve të furnizimit në klasterat e prodhimit të ushqimeve | Stuidim i poblematikave te menaxhinit të zinxhirëve të furnizimit në klasterat e prodhimit të ushqimeve dhe percaktimi i alternativave per tejkalimin e tyre | Pjesëmarrja në projekte dhe studime;<br>Botime të artikujve shkencorë;<br>Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.<br>Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Standardet në lidhje me ushqimit (harmonizimi në EU) dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë në organizatat e agrobiznesit/organizatat e prodhimit të ushqimit | Studimi i spekteve te menaxhimit te cilesise dhe sigurise ushqimore,<br>Vleresimi i stadit te organizatave te agrobiznesit ne lidhje me plotesimin e standardeve dhe problematikat e ndeshura | Botime të artikujve shkencorë;<br>Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.<br>Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Analiza e riskut të tregjeve të produkteve bujqësore dhe sigurimet në bujqësi | Analiza e rriskut ne tregjet e produkteve bujqësore dhe sigurimeve në bujqësi | Botime të artikujve shkencorë; | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Studime doktorale të studentëve të departamentit | | |
| | Efektiviteti i menaxhimit të projekteve, ex-ante dhe ex-post analysis. | Analiza ex-ante dhe ex-post | Botime të artikujve shkencorë;<br>Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi.<br>Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Menaxhimi i institucioneve publike | Vlerësim i impaktit te modeleve te menaxhimit ne institucionet publike | Botime të artikujve shkencorë; | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | | | Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Studime doktorale të studentëve të departamentit | | |
| **Dep: Ekonomi dhe Politika të Zhvillimit Rural** | Analiza ekonomike dhe vlerësimi i impaktit të politikave publike me fokus të veçantë në politikat e zhvillimit Bujqësor dhe rural; | Ofrimi i ekspertizës për nivelin e politikave publike në bujqësi dhe zhvillimin rural dhe propozimin e instrumente të rinj politike.<br>Realizimi i 3 studimeve PDH | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Kryer | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Vlerësimi i efektivitetit dhe impakti i përdorimit të burimeve natyrore dhe ambjentit; | Analiza e efektivitetit dhe impaktit të politikave përmes një doktorature | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Në vazhdim | 2025-2026 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Ekonomia e mbetjeve dhe riciklimit; | Realizimi i kërkimi në nivel doktoral | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Në vazhdim | 2025 - 2026 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Shërbimet ekosistemike dhe agromjedisore, identifikimi, vlerësimi, dhe përdorimi i tyre ne ndihmë të politikave të zhvillimit rural. | Realizimi i një kërkimi në nivelin doktoraturë | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Në vazhdim | 2025-2026 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ekonomia e gjelbër dhe analiza e efektivitetit ekonomik; | Realizimi i 3 artikujve shkencorë | Pjesëmarrje në konferenca, botime në revista | Kryesisht të përmbushura | 2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Organizimi i sistemeve të prodhimit dhe fermave në zonat rurale. | Realizimi i një kërkimi në nivelin doktoraturë | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Kryesisht të përmbushura | 2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Planifikimi dhe organizimi hapësinor i zonave rurale; | Realizimi i 3 studimeve ne nivel Master Ekzekutiv | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Kryer | 2024 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Rritja e konkurueshmërisë në tregjet bujqësore; | Realizimi i një kërkimi në nivelin doktoraturë | Kryerja e një kursi metodologjik me qëllim rritjen e kapaciteteve | Kryesisht të përmbushura | 2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Politikat e kohezionit social dhe bashkëpunimi midis aktorëve lokalë në kuadër të projekteve | Realizimi i 1 studimi ne nivel master Ekzekutiv | Kryerja e një teze diplome. Shkrimi dhe realizimi i projekte kërkimore dhe studimeve; Ofrimi i trajnimeve; Botime shkencore | Në vazhdim | 2026 | |
| | Identifikimi dhe vlerësimi problemeve social ekonomike të grupeve vulnerabël në hapësirat rurale | Realizimi i nje Scientifik Report | Kryerja e seksioneve të veçuara | Kryer | 2023-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Dep: Financë Kontabilitet** | Menaxhimi dhe vendimmarrja financiare | Përdorimi i metodave satistikore në kuadër të drejtimit dhe vendimmarrjes financiare. | Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, kryesisht të stafit, por edhe të studentëve.<br><br>2 Student PHD<br><br>Studime te doktoratures ne Dep. | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca nga stafi i departamentit në lidhje me këtë fushë studimi.<br><br>U realizua prezantime. Prezantim i referimeve te dyta te doktoranteve te regjistruar 2022-2023 si dhe prezantim i referimeve te treta te doktoranteve te regjistruar 2021-2022. Pjesemarrje ne konferenca.<br><br>Në vazhdim | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Risku financiar dhe i biznesit në njësitë ekonomike dhe në institucionet financiare | | 1 Student PHD Studime të doktoraturës në Dep. | U realizua prezantimi i 3 | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Financimi i sektorit bujqësor dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë | Realizimi i punimeve të diplomës me studentët e programeve Master nga çdo anëtar i stafit akademik të departamentit. | Studime të doktoraturës në Dep. | | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | | | 2 Student PHD | | | |
| | | | Udhëheqja në realizimin e punimit të diplomës të studentëve nga çdo anëtar i stafit akademik të departamentit dhe mbrojtja me sukses e punimit të diplomës nga studentët. | Në vazhdim | | |
| | | | | U realizuan prezantimet. | | |
| | Politikat monetare dhe fiskale në kuader të mbështetjes së sipërmarrjes private dhe zhvillimit ekonomik | Realizimi i punimeve të diplomës me studentët e programeve Master nga çdo anëtar i stafit akademik të departamentit | 1 student PHD<br><br>Studime të doktoraturës në Dep. | U realizuan prezantimet, dhe ne process mbrojtje | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Udhëheqja në realizimin e punimit të diplomës të studenteve nga çdo anëtar i stafit akademik të departamentit dhe mbrojtja me sukses e punimit të diplomës nga studentët. | | | |
| | Implementimi i Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit në njesitë ekonomike. | Edukimi kontabel, auditues dhe implementimi i SKK dhe SNKK. | 2 student PHD Studime të doktoraturës në Dep. | Në vazhdim U realizua prezantimet | 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | Forcimi i cilësisë së raportimit financiar dhe rritja e besueshmërsisë së informacionit kontabël të njësive ekonomike. | Pjesëmarrja e dep në projektin (IPSAS-et), ku synimi është që në të gjithë sektorin publik të kalohet plotësisht në hartimin e pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare dhe në konsolidimin e pasqyrave financiare. | Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë të stafit akademik. | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura. |
| | | | 2 student | Ne vazhdim | | |
| | | | Studime te doktoratures ne Dep. | | | |
| **Dep: Menaxhim i Turizmit Rural** | Politikat dhe strategjitë e zhvillimit të Turizmit të qëndrueshëm | Realizim studimesh në fushën e politikave dhe strategjive të turizmit në bashkëpunim dhe udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizuan 2 studime<br>U realizua 1 temë diplome me studentët e Master Profesional<br>U prezantuan 3 punime shkencore në 3 konferenca të ndryshime ndërkombëtare<br>U publikua një artikull shkencor në revistë ndërkombëtare | 1 Tetor 2024- 15 Nëntor 2025 | U realizua |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Menaxhimi i cilësisë në Turizmin Rural dhe mikpritja | Realizim studimesh në fushën e cilësisë së turizmit dhe të mikpritjes vetë ose në bashkëpunim ose udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë . Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional ose bachelor . Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizuan 2 studime. U realizua 1 temë diplome me studentët Master Profesional në Menaxhim i Turizmit Rural. U realizuan 2 punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare dhe u prezantuan në 3 punime në konferenca ndërkombëtare | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U tejkalua |
| | Sipërmarrjet Turistike dhe menaxhimi tyre | Realizim studimesh në fushën e destinacioneve dhe të turizmit alternative vetëm ose në bashkëpunim ose udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë .<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional ose bachelor.<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore. | U realizuan 1 temë diplome me studentet e Masterit:<br>U realizua një publikim .U realizuan 3 prezantime në konferencë shkencore ndërkombëtare<br>Vazhdon në process puna kërkimore për faktorët menaxherial në zhvillimin e turizmit në kuadrin e punimit të doktoraturës për 1 doktorante .<br>Eshtë në process një punim doktorature mbi lidhjen midis tregut të punës në fushën e turizmit dhe personelit<br>U realizua një publikim.<br>U realizuan 3 prezantime në konferencë shkencore ndërkombëtare. | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U tejkalua |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Destinacionet turistike dhe turizmi alternativ (ekoturizëm, agroturizëm, turizmi aventurës etj) | Realizim studimesh në fushën e destinacioneve dhe të turizmit alternative vetëm ose në bashkëpunim, ose udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional ose bachelor<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizuan 1 tema diplome me studentët e Masterit Profesional (per destinacionet turistike dhe për agroturizmin).<br>U realizua 1 prezantim në konferencë shkencore ndërkombëtare | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U realizua plotësisht |
| | Turizmi Rural dhe territori(burimet natyrore, mjedisi, kultura) | Realizim studimesh në fushën e produkteve lokale, me tregues gjeografik, tadicional në lidhje me ekonominë lokale, turizmin me fokus turizmin rural në bashkëpunim dhe udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizuan tema diplome: 2 punime me studentët e Masterit Profesional në “Menaxhim i Turizmit Rural”<br>U realizuan 7 prezantime në konference shkencore ndërkombëtare .<br>U realizua dhe u publikuan 4 artikuj shkencor në revista shkencore ndërkombëtare nga tw cilwt 2 publikime i referohen GDP dhe Teknologjise në zhvillimin rural. | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U Tejkalua |
| | Tregu turistik dhe sjellja konsumatore | Realizim studimesh në fushën e sjelljes konsumatorit turistik në bashkëpunim dhe udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore E99 | U realizuan 1 temë diplome me studentët:<br>Nje (1 ) teme me studentët e Masterit Profesional<br>Zero (0) tema studimi me studentët e nivelit bachelor në Menaxhim i Turizmit Rural, për arsye të mosplotësimit të kritereve të studentëve për punim diplome (mesatare ulët)<br>U realizuan 1 prezantime në | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U realizua |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konferenca shkencore ndërkombëtare | | |
| | Produktet e territorit, ushqimi organik dhe turizmi rural | Realizim studimesh në fushën e produkteve lokale, me tregues gjeografik, tadicional në lidhje me ekonominë lokale, turizmin me fokus turizmin rural në bashkëpunim dhe udhëheqje të studentëve | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizuan 2 prezantime në konferenca shkencore ndërkombëtare (konferencën ICOALS V).<br>U realizua dhe u publikuan 2 artikuj shkencor në revistë shkencore ndërkombëtare<br>U realizua me sukse një projekt i financuar nga AKKSHI, i cili pati dy produkte kërkimore (konferencë dhe publikim) dhe ka material të mjaftueshëm për publikime të tjera.<br>Në proces të realizimit të kërkimit shkencor me 2 studentë doktorature në lidhje me produktet lokale dhe ato tradicionale –produkte të origjinës, të cilat kanë dhënë edhe disa punime në konferenca | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U realizua |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndërkomëtare dhe artikuj shkencorë | | |
| | Kuadri rregullator në turizëm | Realizim studimesh në fushën rregullatore në përgjithësi në lidhje bujqësinë dhe zhvillimin rural me fokus turizmin | Realizimi i të paktën një studimi në këtë fushë<br>Realizimi i një punimi diplome me Masterin Profesional ose bachelor<br>Publikim i një artikulli ose 1 pjesëmarrje në konferencë shkencore | U realizua 1 temë me studentët e Masterit Profesional në "Menaxhim i Turizmit Rural"<br>U realizuan 2 prezantime në konferenca shkencore ndërkombëtare (përfshirë edhe ICOALS 5)U realizua një publikim në revistë shkencore. | 1 Tetor 2023- 15 Nëntor 2025 | U realizua |
| **Departamenti Matematikë dhe Informatikë** | Vleresim i impaktit te politikave dhe projekteve te zhvillimit bujqesor dhe rural me metoda statistikore dhe ekonometrike. | Përdorimi i metodave statistikore dhe ekonometrike për vlerësimin e impaktit të politikave dhe projekteve të zhvillimit bujqësor dhe rural | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Botime të artikujve shkencorë;Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Vlerësim i eficiencës se sektorit bujqësor dhe agrobiznesit me metoda statistikore dhe ekonometrike | Përdorimi i metodave statistikore dhe ekonometrike për studimin dhe vlerësimin e eficiencës se sektorit bujqësor dhe agrobiznesit | Pjesëmarrja në projekte dhe studime, Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Siguria ushqimore përmes perceptimit të konsumatoreve, evidentimi i faktorëve përcaktues me metoda empirike dhe implikimet politike | Evidentimi i faktorëve përcaktues në sigurinë ushqimore | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Përmirësimi i sistemit dhe procesit të menaxhimit në agrobiznes me ndihmën e metodave matematike. Vlerësim i përdorimit efikas të inputeve bujqësore me metoda matematike | Përdorimi i metodave matematikore për vlerësimin e përdorimit efikas të inputeve bujqësore | Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Përmirësimi i strukturave dhe modeleve të prodhimit dhe shpërndarjes së prodhimit bujqësor me ndihmën e metodave matematike | Përdorimi i metodave matematikore për përmirësimin e modeleve të prodhimit dhe shpërndarjes së prodhimit bujqësor | Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Krijimi/ sigurimi i një baze matematikore për të modeluar lloje të ndryshme të sjelljes së firmave në treg. Modelimi i strategjive matematikore për agjentet e tregut në rastet kur ata bashkëveprojnë ose jo me njeri-tjetrin | Modelim matematikor i strategjive dhe sjelljes së firmave në treg | Botime të artikujve shkencorë; Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtarë | Botime të disa artikujve dhe pjesëmarrje në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. Studime doktorale të studentëve të departamentit. | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rëndësia dhe ndërtimi i aplikacioneve/ softeve informatike në mbështetje të zhvillimit të agrobiznesit. Krijimi i sistemeve gjithëpërfshirëse dixhitale të fermerëve shqiptar | Studimi i situatës aktuale të përdorimit të aplikacioneve dhe IoT në funksion të bizneseve bujqësore | Shkrimi dhe realizimi i projekteve kërkimore dhe studimeve; Ofrimi i trajnimeve; Botime shkencore | Botime të disa artikujve shkencorë dhe pjesëmarrja në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi; Pjesëmarrja në trajnime. Studimet doktorale në këtë fushë, të dy prej stafit akademik të Informatikës | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Vlerësimi dhe rëndësia e përdorimit të BI (Inteligjencës Biznesi) në sistemet elektronike qeveritare në funksion të zhvillimit bujqësor (Government data - farming) | Studimi i përdorimit të BI në funksion të zhvillimit bujqësor | Pjesëmarrja në projekte dhe studime; Ofrimi i trajnimeve; Botime shkencore | Pjesëmarrja në trajnime. Botime të disa artikujve shkencorë dhe pjesëmarrja në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| | Vlerësimi i rëndësisë së përdorimit të e-Agriculture (metoda inovative për zhvillimit e sektorit të agrobiznesit), për produktet tipike vendase dhe ndikimi i saj në të ardhurat e familjeve në zonat rurale | Studimi i rëndësisë së përdorimit të e-Agriculture dhe ndikimi i saj në të ardhurat e fermerëve | Shkrimi dhe realizimi i projekteve kërkimore dhe studimeve; Ofrimi i trajnimeve; Botime shkencore | Pjesëmarrja në trajnime. Botime të disa artikujve shkencorë dhe pjesëmarrja në konferenca, në lidhje me këtë fushë studimi. | Viti akademik 2024-2025 | Aktivitete kryesisht të përmbushura |
| **Dep: Gjuhëve të Huaja** | NA | NA | NA | NA | NA | NA |

## 1.3 FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka në përmbërjen e tij katër departamente, ky secila njësi ka fushën e vetë të kërkimit dhe grupet kërkimor shkencor. Anëtarët e grupeve kërkimore bashkëpunojnë në grup për realizimin e kërkimit shkencor dhe projekteve të përbashkëta.

**Tabela 1.3 :** Departamentet dhe Grupet mësimore-kërkimore në FMV

| DEPARTAMENTI | GMK |
|---|---|
| **Departamenti i Moduleve Morfo-Funksionale** | Shkencat bazë në Mjekësinë Veterinare |
| **Departamenti i Moduleve Paraklinike** | Diagnozat Veterinare |
| | Patologjitë Veterinare |
| **Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar** | Siguria Ushqimore dhe Shëndeti Publik |
| | Epidemiologjia dhe Biopatologjitë me interes veterinar |
| **Departamenti i Lëndëve Klinike** | Sëmundjet e Kafshëve të Fermës dhe Shoqërimi |
| | Riprodhimi i Kafshëve dhe Kirurgjia Veterinare |

Politikat e kërkimit shkencor në FMV janë të lidhura ngushtë me strategjitë kombëtare për zhvillimin e arsimit të lartë. UBT ka nisur një proces të thellë reformash për transformimin e plotë të ofertës akademike, shkencore dhe të transferimit të njohurive, përmes zbatimit të Strategjisë "UBT–BOKU 2030", pjesë e këtij transformimi është edhe FMV. Këto politika synojnë krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, forcimin e institucioneve të arsimit të lartë, si edhe rritjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

**Tabela 1.3:** Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit (FMV)

| **Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Plani dhe proçeset e planifikuara** | **Aktivitete dhe detyrat konkrete** | **Fakulteti/ Drejtoria/Sektori përgjegjës** | **Realizimi sipas planit strategjik** | **Afati** | **Komente** |
| **1.** | Rritja e kapaciteteve të stafit akademik dhe ndihmës | Realizimi i doktoraturave jashtë vendit nga doktorantët e rinj. Specializime afat shkurta dhe trajnime jashtë vendit. | FMV / Dekanati / Rektorati | Rritja e personelit akademik në kërkim (Reflektohet nëpërmjet projekteve të ndryshme) Ndjekja e një pjesë programit të studimeve të doktoratës, në vëndet e BE | 2022 - 2025 | Projekti i mbështetur nga GIZ dhe Erasmus+ ka mundësuar që kërkuesit e rinj në FMV të realizojnë një pjesë të doktoraturës jashtë vendit. Ky objektiv është përmbushur plotësisht gjatë vitit akademik 2023-2024. |
| **2.** | Punime me cilësi më të lartë me interes për botën akademike; | Prezencë më e lartë në revista të huaja me impakt faktori të lartë; Numri i citimeve për secilin autor sipas SCOPUS | FMV/Dekanati/ Zyra e Shkencës | Numri i botimeve për secilin anëtar të stafit dhe nr. artikujve me IF; Citime për cdo autor. Së paku 5 citime/vit/per staf | 2024-2025 | Numri i botimeve në revista IF ka disa vite që ne FMV ka rritje nga viti në vit. Këtë vit janë realizuar 40 artikuj në revista me IF. Botimet në këto revista janë rrjedhoj e përpjekjeve të vazhdueshme që realizon personeli akademik në bashkëpunim me partnerë të huaj. Tematikat e kërkimit janë në përputhje me akset e kërkimit në çdo GMK. Bashkëpunimi ndërdisiplinor është një tjetër arritje e këtyre botimeve me rëndësi shkencore pasi trajtojnë problematika që janë aktuale në vendin tonë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **3.** | Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së laboratorëve të kërkimit | Rritja e numrit dhe përmirësimi i kushteve të ambjenteve: Inventarizim i përvitshëm i laboratoreve dhe pajisjeve të tyre për funksionimin; Sigurimi i mirëmbatjes së pajisjeve; Sigurimi në kohë i terreneve, reagentëve, medikamenteve etj. | Rektorati/Dekanati/ Administratori | Ngritja e godinës së re në FMV (klinika e kafshëve të shoqërimit); inventarizimi i përvitshëm i paisjeve dhe mirëmbajtja e tyre | 2024-2025 | Në kuadër të projekteve të financuara nga AKKSHI janë realizuar mjaft analiza në laboratorët kërkimor të FMV. Në këto analiza janë përfshirë edhe studentë në kuadër të realizimit të temave të tyre të diplomave. Gjithësesi ende ka mangësi në mirëmbajtjen apo vënien në punë të disa paisjeve. |
| **4.** | Rritja e bashkëpunimit brenda dhe jashtë universitetit | Objektiva të qarta për bashkëpunimin ndërmjet GMK brenda fakultetit; bashkëpunimi gjithashtu me struktura të tjera me interesa të përbashkëta | Dekanati/ Departamentet/ GMK/Stafi akademik dhe ai ndihmës | Rritja e bashkëpunimit nëpërmjet organizimit të simpoziumeve, konferencave të ndryshme në departamente, në universitet, si dhe organizimi me struktura të tjera jashtë universitetit | 2024-2025 | Në kuadër të projekteve bilatarale, AKKSHI-it, READ, dhe Universiteti i Thesalise janë organizuar dy simpoziume shkencore dhe nje Workshop ku janë prezantuar punime shkencore me objekt kryesor qasjen "Një Shëndet". Objektiv i përmbushur gjatë këtij viti. |
| **5.** | Rritja e marrëdhënieve me biznesin, fermat, dhe Institucionet qeveritare | Identifikimi i qartë i marrëdhënieve me biznesin, Institucionet dhe fermat për të siguruar nevojën e tyre për transferimin e njohurive | Dekanati/ Departamentet/ GMK | Lidhja e kontratave e marrëveshjeve në kuadër të bashkëpunimit si në fushën e kërkimit ashtu edhe në atë mësimor | 2024-2025 | Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka një bashkëpunim të suksesshme me institucione partnere si brenda dhe jashtë vendit. Në këto institucione bëjnë pjesë AKKSHI, AKVMB, Akademia e Shkencave, ISUV dhe Urdhrin e Mjekut Veterinar etj; Ky parteneritet ka ndihmuar dhe në realizimin e praktikave profesionale për studentët e vitit të fundit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **6.** | Rritja e të ardhurave për kërkim nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe fondeve qeveritare | Pjesëmarrje aktive në partneritet me ekipe universitare evropiane/rajonale në aplikime për projekte të përbashkëta kërkimore. Pjesëmarrje aktive në aplikime në kuadër të Programit Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim | Departamentet / GMK | Paraqitja e disa projekteve kërkimore në kuadër të PKKZH të financuar nga AKKSHI. | 2022-2025 | Gjatë këtij viti është vërejtur një rritje në aplikimin e projekteve të AKKSHI-it krahasuar me vitin 2024, ku FMV-ja ka fituar dy projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo pikë është komplementar me objektivat e mësipërme. |

**Konkluzione:**

Bazuar në një plan zhvillimi veprimtaria kërkimore në FMV është fokusuar në realizimin e disa objektivave dhe qëllimeve si më poshtë:

a. **Rritja e kapaciteteve të stafit akademik dhe ndihmës akademik:**

Ngritja e kapaciteteve të personelit akademik është një proces i vazhdueshëm që synon përmirësimin e aftësive profesionale, pedagogjike dhe kërkimore të stafit, me qëllim përmbushjen sa më të mirë të kërkesave të studentëve dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Realizimi i studimeve të doktoraturës jashtë vendit nga doktorantët e rinj, pjesë e personelit akademik të FMV-së, përfaqëson një ndihmesë reale për forcimin e këtij stafi. Gjatë viteve të fundit, personeli akademik i FMV-së është angazhuar në projekte të ndryshme shkencore, trajnime, workshop-e, seminare dhe specializime jashtë vendit, të cilat japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve njerëzore. Një rol të veçantë në këtë drejtim ka programi i specializimit afatgjatë në fushën e "Sigurisë Ushqimore dhe Shëndetit Publik", ku personeli akademik i FMV-së vazhdon të trajnohet nga profesorë të Universitetit të Milanos dhe Universitetit të Portos. Rëndësi e veçantë i është kushtuar gjithashtu edhe specializimeve jashtë vendit për personelin ndihmës, në sajë të bashkëpunimit me programet Erasmus me universitetet partnere.

b. **Punime me cilësi më të lartë me interes për botën akademike:**

Gjatë këtij viti janë realizuar 56 artikuj shkencorë, 40 prej me Impact Factor, të indeksuar në SCOPUS. Kjo ka bërë të mundur që, vit pas viti, indeksi H dhe indeksi i pedagogëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të jetë në rritje të vazhdueshme. Bashkëpunimi me autorë të huaj ka qenë i frytshëm, gjë që reflektohet në publikimet e realizuara si bashkautorë, duke kontribuar në mënyrë domethënëse në pozicionimin sa më të mirë të institucionit në renditjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

c. **Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së laboratorëve të kërkimit:**

Janë intensifikuar përpjekjet për rritjen e numrit të analizave të kryera në laboratorët kërkimorë, si edhe për përmirësimin e kushteve të ambienteve në FMV, veçanërisht në kuadër të projekteve të financuara nga AKKSHI. Zbatimi i projekteve aktuale dhe aplikimi në projekte të financuara nga AKKSHI dhe READ Albania paraqesin një mundësi konkrete për sigurimin e materialeve laboratorike dhe pajisjeve të ndryshme, të cilat ndihmojnë ndjeshëm në rritjen e kapaciteteve kërkimore të laboratorëve.

d. **Rritja e bashkëpunimit brenda dhe jashtë universitetit:**

Rritja e bashkëpunimit brenda dhe jashtë universitetit është një aspekt thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve akademike, si dhe për përmirësimin e cilësisë së kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Në këtë kuadër, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka zhvilluar një bashkëpunim të suksesshëm me institucione partnere si në vend ashtu edhe jashtë tij. Ndër këto institucione përmenden: AKKSHI, AKVMB, Akademia e Shkencave, ISUV, Urdhri i Mjekut Veterinar, si edhe partnerë të tjerë institucionalë dhe akademikë.

e. **Rritja e marrëdhënieve me biznesin, fermat, dhe Institucionet qeveritare:**

Bashkëpunimi dhe forcimi i marrëdhënieve midis universitetit dhe sektorëve si bizneset dhe fermat bujqësore shërben si një urë lidhëse midis arsimit, kërkimit shkencor dhe praktikës. Këto marrëdhënie sjellin përfitime të ndërsjella, pasi fakulteti ka mundësi të zhvillojë kërkimin në mënyrë më praktike, ndërsa bizneset dhe fermat përfitojnë nga ekspertiza akademike. Sot, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka

marrëdhënie bashkëpunimi me operatorët kryesorë në fushën e mjekësisë veterinare, duke dhënë një kontribut real në zhvillimin e praktikave profesionale.

f. **Rritja e të ardhurave për kërkim nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe fondeve qeveritare.**

Gjatë vitit akademik 2024–2025 janë realizuar:

- Forcimi i marrëdhënieve me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit dhe shtimi i aplikimeve të përbashkëta në projekte dhe iniciativa shkencore.
- Organizimi i takimeve periodike me kolegët e grupeve kërkimore–shkencore, me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së publikimeve me faktor impakti.
- Nxitja dhe pjesëmarrja aktive në projekte të ndryshme shkencore, në mënyrë që rezultatet e tyre të shërbejnë sa më mirë për përmirësimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fakultet.

2. **Përputhshmëria e fushave të kërkimit ne nivel departamenti me fushën e kërkimit shkencor në fakultet.**

Njësitë bazë dhe grupet mësimore–kërkimore zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje të plotë me drejtimet strategjike të fakultetit. Dy akset kryesore të kërkimit shkencor në FMV janë: Shëndeti i Kafshëve dhe Shëndeti Publik Veterinar. Kërkimi në nivel departamenti është i orientuar drejt këtyre fushave prioritare, duke siguruar: koherencë akademike; përputhshmëri me strategjinë institucionale; kontribut të drejtpërdrejtë në objektivat e fakultetit. Asnjë nga studimet e personelit akademik nuk konsiderohet jashtë fokusit të kërkimit të FMV-së..

## 1.4 FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU) gjatë periudhës 2024–2025 ka forcuar rolin e tij në kërkimin shkencor dhe inovacionin në bioteknologji, teknologji ushqimore dhe shkenca të ushqimit, duke integruar edhe fusha multidisiplinare. Aktiviteti kërkimor është fokusuar në zhvillime inovative për sistemet ushqimore të qëndrueshme, përmirësimin e cilësisë, sigurisë dhe autenticitetit të produkteve ushqimore, studime mbi mikroorganizmat patogjenë, bio-mbrojtjen në fermentim, parametrat nutrizionalë dhe ndikimin e dietës në shëndetin publik. Ai gjithashtu është orientuar drejt përputhshmërisë me objektivat strategjike kombëtare dhe të Bashkimit Evropian, përfshirë tranzicionin e gjelbër dhe promovimin e inovacionit në shkencë dhe teknologji.

Aktivitetet kërkimore janë zhvilluar në katër departamente dhe gjashtë grupe mësimore-kërkimore, duke rezultuar në mbi 20 tema master, mbi 8 teza doktorature në zhvillim, 60 publikime (49 të indeksuara) dhe më shumë se 120 prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto rezultate dëshmojnë një angazhim të lartë të stafit akademik në projekte dhe programe kërkimore, duke mbështetur bashkëpunime ndërkombëtare dhe forcuar reputacionin e fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Balanca midis kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe projekteve të financuara ka rritur ndjeshëm vizibilitetin akademik dhe shkencor të FBU-së në rajon dhe më gjerë.

Pjesëmarrja e stafit në projekte dhe programe lëvizshmërie gjatë vitit akademik 2024–2025 tregon një angazhim të konsoliduar, me kontribut si anëtarë projektesh, koordinatorë aktivitetesh, investigues kryesorë, lektorë dhe trajnerë. FBU është aktiv në projekte ndërkombëtare si Horizon Europe, MSCA, Interreg Euro-MED, COST, CEEPUS, ICT, APPEAR dhe WBF, si dhe në projekte kombëtare të financuara nga AADF, AKKSHI, projekte bilaterale dhe ASHSH.

Rritja e pjesëmarrjes në projekte shkencore ka sjellë përfitime të shumta, përfshirë zgjerimin e fushave kërkimore, ngritjen e laboratorëve kërkimore të reja tme pajiskje të avancuara, modernizimin e kurrikulave dhe laboratorëve me studentët, rritjen e cilësisë së temave të diplomave dhe forcimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Integrimi në rrjete ndërkombëtare në fushat e shkencave ushqimore, kimisë ushqimore, nutricionit, teknologjisë ushqimore, bioteknologjisë dhe sigurisë ushqimore dëshmon një vizion të qartë të FBU-së drejt kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU) vazhdon të forcojë rolin e tij në kërkimin shkencor dhe inovacionin në bioteknologji, teknologji ushqimore dhe shkenca të ushqimit, si edhe në fusha të tjera me karakter multidisiplinar që përfshijnë shkencat natyrore, mjekësore dhe sociale. I organizuar në katër departamente dhe gjashtë grupe mësimore-kërkimore, FBU gjatë periudhës 2024–2025 ka orientuar aktivitetin kërkimor drejt zhvillimeve të reja shkencore, qasjeve të qëndrueshme dhe forcimit të sigurisë ushqimore. Këto veprimtari kërkimore kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin e strategjisë për kërkimin shkencor të Universitetit Bujqësor të Tiranës, mbështesin prioritetet kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe janë plotësisht në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian për tranzicionin e gjelbër, inovacionin teknologjik dhe garantimin e një sistemi ushqimor të sigurt e të shëndetshëm.

### 1.4.1 Prioritetet strategjike të kërkimit shkencor të FBU-së;

- Inovacioni në teknologjinë ushqimore dhe bioteknologji. Përdorimi i metodave të avancuara për përpunimin e ushqimeve, izolimin e mikroorganizmave, fermentimin, bio-mbrojtjen dhe zhvillimin e produkteve ushqimore inovative. Fokus në aplikimin e bioteknologjisë moderne për prodhime ushqimore, biomateriale, përmirësimin e proceseve biologjike dhe përdorime në mjekësi, industri dhe mjedis.
- Cilësia dhe siguria ushqimore, dhe gjurmueshmëria. Garantimi i standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, i origjinës së produkteve dhe i skemave të cilësisë, si dhe gjurmueshmëria e produkteve ushqimore, përfshirë vajin e ullirit, produktet e pjekjes (buka), pijet alkoolike (birra, vera), produktet me origjinë shtazore dhe bimore, si dhe dizenjimi i produkteve funksionale dhe alternative. Realizimi i studimeve dhe analizave laboratorike për kontrollin e cilësisë dhe adaptimin ose zhvillimin e metodave të reja analitike, duke prioritizuar cilësinë, sigurinë ushqimore dhe autenticitetin e produkteve.
- Zhvillimi i industrisë ushqimore të qëndrueshme dhe prodhimi i qëndrueshëm i ushqimeve. Promovimi i produkteve lokale dhe rajonale, zhvillimi i teknologjive që mbështesin prodhimin ushqimor me ndikim minimal në mjedis dhe me potencial ekonomik. Përfshin inovacione në proceset e prodhimit, reduktimin e mbetjeve ushqimore dhe implementimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese.
- Promovimi i ushqimit të shëndetshëm dhe nutricionit. Studime mbi përbërjen ushqimore, dietat e ekuilibruara, ushqimet funksionale dhe ndikimin e tyre në shëndetin publik, në përputhje me në përputhje me udhëzimet dhe politikat kombëtare dhe te Bashkimit Evropian.
- Tranzicioni i gjelbër dhe sistemi ushqimor i qëndrueshëm. Kërkime që lidhen me mbrojtjen e burimeve natyrore, minimizimin e ndotjes, menaxhimin e mbetjeve nga agro-industria dhe përdorimin e teknologjive të pastra në sektorin ushqimor, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe Marrëveshjen e Gjelbër (Green Deal).
- Forcimi i kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve. Rritja e kapacitetit kërkimor dhe profesional të stafit dhe studentëve, përmes pjesëmarrjes së tyre në projekte kërkimore dhe bashkëpunime

ndërkombëtare, si investigues kryesorë ose udhëheqës shkencorë; shkrimi dhe publikimi i artikujve shkencorë; referime në evente shkencore brenda dhe jashtë vendit; si dhe realizimi i temave të nivelit Master Shkencor dhe tezave të doktoraturës.

- Forcimi i infrastrukturës kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ngritja e laboratorëve të rinj që kanë përfituar financim; zgjerimi i partneriteteve me universitete, institute kërkimore dhe industri të agro-përpunimit, laboratorë reference, si dhe autoritete të kontrollit të ushqimit në Shqipëri dhe Bashkimin Evropian, duke promovuar transferimin e njohurive dhe inovacionin.
- Përputhja me politikat kombëtare dhe prioritetet e Bashkimit Evropian. Kërkimi dhe aktivitetet shkencore janë realizuar në përputhje me politikat kombëtare dhe prioritetet e Bashkimit Evropian, duke u fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në programet evropiane, si Marrëveshja e Gjelbër (Green Deal) dhe strategjia nga Ferma në Tavolinë (Farm to Fork). Kërkimi shkencor ka kontribuar gjithashtu në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UN SDGs), duke siguruar një ndikim afatgjatë dhe përputhje me objektivat strategjike të kërkimit shkencor të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

### 1.4.2 Objektivat e kërkimit shkencor

- Sigurimi i përputhshmërisë së kërkimit shkencor me objektivat strategjike kombëtare dhe të Bashkimit Evropian.
- Zhvillimi i produkteve dhe teknologjive të reja për industrinë ushqimore, duke përfshirë biofermentimin, fermentimin natyral dhe përdorimin e majave alternative.
- Krijimi i produkteve ushqimore dhe proceseve të prodhimit që janë të qëndrueshme, të sigurta, inovative dhe të shëndetshme.
- Përmirësimi i cilësisë dhe autenticitetit të produkteve ushqimore, mbështetja e tregut vendas dhe nxitja e eksporteve.
- Kontrolli i mikroorganizmave patogjenë në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore dhe garantimi i sigurisë ushqimore.
- Kontributi në përmirësimin e dietave ushqimore, mirëqenies dhe shëndetit publik, si dhe promovimi i ushqimeve lokale dhe mesdhetare.
- Zbatimi i studimeve multidisiplinare duke integruar shkencat mjekësore, ekonomike dhe sociale për të kuptuar ndikimin e dietës dhe ushqimit në shëndetin publik.
- Forcimi i bashkëpunimit akademik dhe kërkimor me studentët, industrinë ushqimore, institucionet e arsimit të lartë, si dhe me politik-bërësit vendas dhe ndërkombëtarë.

Programi i kërkimit përfshin projekte specifike në disa fusha kryesore. Në bujqësi dhe ushqim, janë analizuar cilësia dhe autenticiteti i vajit të ullirit, shkalla e pjekurisë së kultivarëve dhe përbërja nutricionale e bimëve si hithra thumbuese (*Urtica dioica* L.). Në bioteknologji dhe sigurinë ushqimore, janë izoluar dhe analizuar mikroorganizmat patogjenë në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, dhe janë studiuar aktivitetet antimikrobike të majave jo-Saccharomyces në birrën artizanale. Në enologji dhe teknologjinë e verës, është analizuar potenciali enologjik i Muskat Hamburg, parametrat e fermentimit të Shesh i Bardhë me maja të ndryshme, si dhe përdorimi i bio-mbrojtjes si alternativë për eliminimin e sulfiteve. Në teknologji ushqimore dhe fermentim, është përdorur brumi i fermentuar natyralisht dhe majat alternative në prodhimin e bukës, dhe janë analizuar parametrat fiziko-kimikë të birrës dhe ujit të përdorur në prodhim. Në shkencat mjekësore dhe sociale, janë zhvilluar studime mbi ndikimin e agjërimit dhe ndërhyrjeve dietike në mikrobiotë, metabolizëm dhe mirëqenie, zgjedhjet ushqimore dhe shëndetin mendor të nxënësve, si dhe mbi tiroiditin Hashimoto.

Aktivitetet e realizuara përfshijnë sigurimin dhe analizimin e mbi 50 mostrave laboratorike për vaj ulliri, birrë, verë, hithër, maltë, bukë dhe ujë, krahasimin me standardet kombëtare dhe ato të BE-së, identifikimin e mikroorganizmave fermentues, studimin e komponimeve bioaktive, analizat fiziko-kimike dhe sensoriale, si dhe përgatitjen e publikimeve shkencore dhe prezantimeve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë periudhës së raportuar janë realizuar mbi 15 tema MSc, mbi 4 teza doktorature janë në zhvillim, janë përgatitur disa artikuj për publikim, ose referime në departament e konferenca ndërkombëtare. Këto aktivitete kërkimore-shkencore kanë kontribuar në avancimin e inovacionit shkencor, zhvillimin profesional të stafit akademik dhe studentëve, si dhe kanë krijuar mundësi për aplikime praktike në industrinë ushqimore, prodhimin e qëndrueshëm dhe sigurinë ushqimore.

### 1.4.3. Departamenti i Teknologjisë Agro-ushqimore

Departamenti i Teknologjisë Agro-Ushqimore (DTAU) ka zhvilluar veprimtari kërkimore gjatë periudhës 2024–2025 në përputhje me objektivat dhe misionin e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit. Kërkimi është organizuar përmes 2 grupeve mësimore-kërkimore: "Grupi Mësimor-Kërkimor i Teknologjisë" dhe "Grupi Mësimor-Kërkimor i Inxhinierisë Ushqimore", me përbërjen si më poshtë:

1. Grupi Mësimor-Kërkimor i Teknologjisë;
2. Grupi Mësimor-Kërkimor i Inxhinierisë Ushqimore;

Gjatë kësaj periudhe, grupet kanë zhvilluar kërkime në fusha kyçe që përfshijnë promovimin e qëndrueshmërisë dhe autenticitetit të vajit të ullirit, izolimin e mikroorganizmave sëmundjeshkaktues në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, studimin e potencialit enologjik të varietetit Muskat Hamburg, analizimin e potencialit alkool formues të maltos nga tre tipe drithrash, përdorimin e brumit të fermentuar natyralisht dhe i majave alternative në prodhimin e bukës, si dhe studimin e parametrave bazë të cilësisë dhe sigurisë së vajit të ullirit shqiptar për eksport. Këto aktivitete janë realizuar përmes sigurimit dhe analizimit të mostrave, krahasimit me standardet kombëtare dhe BE, identifikimit të mikroorganizmave fermentues, analizave fiziko-kimike dhe sensorio-nutrionale, duke rezultuar tema masteri shkencor, 2 teza doktorature në zhvillim, artikuj shkencorë për publikim dhe prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes këtyre aktiviteteve, DTAU ka arritur të përmbushë objektivat strategjikë të Fakultetit dhe të sigurojë përputhshmërinë e fushave të kërkimit në nivel departamenti me prioritetet e fakultetit për inovacion, qëndrueshmëri dhe siguri ushqimore.

### 1.4.4. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë

Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë (DSHUB) ka zhvilluar veprimtari kërkimore gjatë periudhës 2024–2025 në përputhje me objektivat dhe misionin Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU). DSHUB kryen veprimtari sipas fushës së kërkimit të 3 grupeve mësimore-kërkimore:

1. Grupi Mësimor-Kërkimor i Mikrobiologjisë dhe Bioteknologjisë dhe Ushqimore;
2. Grupi Mësimor-Kërkimor i Biologjisë dhe Aplikimi i Metodave të Biologjisë Molekulare në Ushqime;
3. Grupi Mësimor- Kërkimor i Shkencave të Ushqimit dhe Nutricionit;

Aktivitetet kërkimore zhvillohen brenda grupeve mësimore-kërkimore sipas fushave prioritarë të kërkimit, të cilat përfshijnë bioteknologjinë ushqimore, mikrobiologjinë ushqimore, aplikimin e metodave të biologjisë molekulare në ushqime dhe vlerësimin e aspekteve ekologjike të ekosistemeve dhe larmisë biologjike ushqimore. DSHUB ka realizuar analiza mbi baktere laktike në produktet tradicionale të bulmetit, duke përfshirë izolimin, identifikimin dhe testet probiotike dhe teknologjike. Janë kryer gjithashtu analiza të vajrave esenciale dhe aktivitetit të tyre antimikrobik, analiza fiziko-kimike të mjaltit autokton shqiptar, si dhe studime mbi cilësinë e ujërave bregdetare dhe gjendjen shëndetësore të specieve ichtike të

konsumuar në lumin Vjosa. Aktivitetet janë kryer sipas planit strategjik të departamentit dhe kanë rezultuar në përgatitjen e materialeve për artikuj shkencorë dhe raporte të doktoraturës. Kjo veprimtari kërkimore ka mundësuar integrimin e metodologjive inovative dhe teknologjive të avancuara në laboratorët e DSHUB, përmirësimin e kurrikulave dhe përfshirjen aktive të studentëve në projekte praktike dhe hulumtime shkencore. Rezultatet e arritura kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e shkencës ushqimore dhe bioteknologjisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

### 1.4.5 Departamenti Kimisë

Departamenti Kimisë (DK) ka zhvilluar një veprimtari të gjerë kërkimore në përputhje të plotë me misionin dhe fushat prioritare të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU). Gjatë periudhës 2024–2025, kërkimi shkencor në DK është zhvilluar në kuadër të 2 grupeve mësimore-kërkimore:

1. Grupi Mësimor-Kërkimor Kimia Inorganike dhe Analitike;
2. Grupi Mësimor-Kërkimor Kimia Organike;

Kërkimet e DK janë përqendruar në valorizimin e mbetjeve dhe nënprodukteve agro-ushqimore, veçanërisht atyre që lidhen me prodhimin e vajit të ullirit, duke i trajtuar si burime të rëndësishme për përftimin e komponimeve me vlerë të shtuar dhe përdorimin e tyre në fortifikimin e ushqimeve. Një pjesë tjetër e rëndësishme e punës kërkimore lidhet me aplikimin e teknikave moderne të ekstraktimit dhe rikuperimit të komponimeve fenolike, si dhe me vlerësimin e cilësisë së paketimeve ushqimore dhe rolin e paketimit inteligjent e aktiv në ruajtjen e cilësisë dhe sigurisë së produkteve. DK kontribuon gjithashtu në studimin e parametrave fiziko-kimikë të produkteve ushqimore si djathi, vera, gruri dhe mielli, si dhe në vlerësimin e pranisë së metaleve të rënda në perime në zona të ndryshme të vendit. Përmes këtyre kërkimeve, DK mbështet përmirësimin e zinxhirit të furnizimit, ruajtjen e produkteve tradicionale, rritjen e njohurive teknike dhe ndërgjegjësimin e prodhuesve, duke kontribuar drejtpërdrejt në objektivat e FBU për inovacion, siguri ushqimore dhe zhvillim të qëndrueshëm në sektorin agro-ushqimor.

### 1.4.6. Departamenti Qendra e Kërkimit të Ushqimit

Departamenti Qendra e Kërkimit të Ushqimit (QKU) ka zhvilluar veprimtari kërkimore gjatë periudhës 2024–2025 në përputhje me objektivat dhe misionin Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU). QKU përfaqësohet nga 1 grup mësimor-kërkimor: **Cilësia dhe Siguria Ushqimore.**
QKU ka në fokus përmirësimin e teknologjive të përpunimit të ushqimeve dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë ushqimore sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Grupi përdor metoda të avancuara për ekstraktimin e përbërësve me vlera ushqyese nga lëndët e para bimore dhe shtazore dhe synon zhvillimin e teknologjive të reja, promovimin e produkteve rajonale dhe krijimin e produkteve inovative, si dhe përmirësimin e mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi teknologjinë ushqimore. Fokusi kryesor mbetet vlerësimi i produkteve ushqimore të tregut vendas, duke mbështetur sektorin e agropërpunimit në Shqipëri dhe duke kontribuar në përmirësimin e tij përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë periudhës raportuese, grupi ka realizuar gjithsej 15 tema kërkimore, përfshirë 11 tema në nivel Master Shkencor dhe 2 doktorata në zhvillim, disa prej të cilave janë zhvilluar në bashkëpunim me studentët e ciklit të dytë dhe të tretë, duke reflektuar përputhshmërinë e aktiviteteve të grupit me objektivat strategjike të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit.

**Tabela 1.4:** Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit (FBU)

| Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Fakulteti/ Departamenti** | **Fusha e kerkimit shkencor** | **Objektivi/at*** | **Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete** | **Realizimi i aktiviteteve** | **Afati** | **Komente** |
| 1. | FBU / DTAU & QKU | Cilesia & Teknologji Ushqimore | Promovimi i qëndrueshmërisë dhe autenticitetit të vajit të ullirit | Promovimi i qëndrueshmërisë dhe autenticitetit në sektorin e vajit të ullirit | Sigurimi i mostrave, analiza, krahasimi me standardet | 12/ 2026 | - |
| 2. | FBU / DTAU & QKU | Bioteknologji / Siguria Ushqimore | Izolimi i mikroorganizmave patogjenë në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri për arritjen e standardeve të BE | Izolimi i mikroorganizmave sëmundjeshkaktues në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri për arritjen e standardeve të BE në sigurinë ushqimore | Sigurimi i mostrave, analizimi dhe krahasimi me standardet | 12/2026 | - |
| 3. | FBU / DTAU & QKU | Bioteknologji / Teknologjia e Pijeve | Studimi i potencialit enologjik të varietetit Muskat Hamburg | Sigurimi i mostrave, analizimi dhe krahasimi me standardet per studimin e potencialit enologjik të varietetit Muskat Hamburg | Sigurimi i mostrave, analizimi dhe krahasimi me standardet | 12/ 2026 | - |
| 4. | FBU / DTAU & QKU | Teknologji Ushqimore | Studimi i potencialit alkool formues të maltos prodhuar nga tre tipe drithrash | Sigurimi i mostrave, analizimi dhe krahasimi me standardet per studimin e potencialit alkool formues të maltos prodhuar nga tre tipe drithrash | Sigurimi i mostrave, analizimi dhe krahasimi me standardet | 12/ 2026 | - |
| 5. | FBU / DTAU | Bioteknologji / Shkenca Ushqimi | Përbërja nutricionale, komponimet bioaktive dhe vetitë kurative të hithrës thumbuese (*Urtica dioica* L.) | Përcaktimi i treguesve fiziko-kimikë dhe nutricionalë, vlerësimi i potencialit antioksidues të ekstrakteve të përftuara nga hithra<br>Përdorimi i hithrës si shtesë nutricionale dhe ndikimi në produkte;<br>Vlerësimi i parametrave sensorialë dhe kimikë në produktet e reja | Janë kryer analizat paraprake; rezultatet janë në përpunim për shkrim artikulli | 2026 | Publikim |
| 6. | FBU / DTAU | Bioteknologji / Teknologji Ushqimore | Përdorimi i brumit të fermentuar natyralisht në prodhimin e bukës: përmirësimi i teknikave dhe vlerësimi i përbërjes kimike dhe vetive fizike të brumit dhe bukës | Përdorimi i brumit të fermentuar natyralisht në prodhimin e bukës: përmirësimi i teknikave dhe vlerësimi i përbërjes kimike dhe vetive fizike të brumit dhe bukës.<br>Identifikimi i mikroorganizmave fermentues në miell dhe vlerësimi i veprimit të tyre fermentues.<br>Fermentimi natyral i brumit dhe prodhimi i bukës.<br>Analiza e vetive fizike e kimike dhe krahasimi i përfitimeve të kësaj metode me atë tradicionale. | Janë kryer disa teste fermentimi dhe prodhime bukësh; në zhvillim identifikimi i mikroorganizmave | 09/2025 | Review paper, e prezantuar në ICOALS V |
| 7. | FBU / DTAU | Kimia Analitike / Bioteknologji | Studimi i metodave të ekstraktimit të vajit esencial të *Rosmarinus officinalis* dhe krahasimi i përbërësve aktivë dhe karakteristikave të tyre | 1. Zbatimi i katër metodave të ekstraktimit të vajit esencial REO: Tinktura në alkool dhe vaj i bimës së *Rozmarinës*; Distilimi me avull; Ekstraktimi Soxhlet; Hidrodistilimi me Klevenger; Ekstraktimi me dioksid karboni superkritik. 2. Identifikimi i profileve kimike të vajrave REO të marrë nga metodat e ndryshme eksatrktimi dhe vlerësimi sasior i përbërësve aktivë përmes metodës GC-MS | Zbatimi i katër metodave të ekstraktimit; vlerësimi sasior i përbërësve aktivë përmes metodës GC-MS | 09/ 2025 | Tezë doktorature e kandidatit MSc. B. Xhaferaj, udhëhequr nga Prof. Asoc. Dr. A. Kopali |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | FBU / DTAU & QKU | Teknologji & Cilesi Ushqimi | Studimi i parametrave bazë të cilësisë dhe sigurisë së vajit të ullirit shqiptar për eksport | Testimi i cilësisë: Aciditeti i lirë, peroksidet, indeksat e absorbancës K272, K232 dhe ΔK, esterët alkilikë dhe polifenolët total | Testimi i aciditetit të lirë, peroksidet, indeksat K272, K232 dhe ΔK | 06/ 2025 | ITC Project - Albania |
| 9. | FBU / DTAU & QKU | Bioteknologji / Siguria Ushqimore | Izolimi i mikroorganizmave sëmundjeshkaktues në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore për arritjen e standardeve të BE në sigurinë ushqimore | Izolimi i mikroorganizmave sëmundjeshkaktues në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri | Sigurimi i mostrave, analizimi i paraprak | 12/ 2026 | - |
| 10. | FBU / DTAU & QKU | Teknologji & Siguria Ushqimore | Vlerësimi dhe përcaktimi i pesticideve në frutat e thata të prodhuara në Shqipëri | Vlerësimi dhe përcaktimi i pesticideve te frutat e thata të prodhuara në Shqipëri | Sigurimi i mostrave dhe analizimi i tyre, referim në departament, konferenca, publikime | 09/ 2025 | Tezë doktorature e kandidatit MSc. A. Brahollari, udhëhequr nga Prof. Dr. K. Sulaj Bashkëpunim me UT/FSHN |
| 11. | FBU / DTAU & QKU | Teknologji Ushqimore / Bioteknologji | Efektet e inokulimit të njëpasnjëshëm me *Metschnikowia pulcherrima* dhe *Saccharomyces cerevisiae* dhe përbërja kimike e birrës American Pale Ale (APA) | Efektet e inokulimit të njëpasnjëshëm me *Metschnikowia pulcherrima* dhe *Saccharomyces cerevisiae* dhe përbërja kimike e birrës American Pale Ale (APA) | Shkrim artikulli | 12/ 2025 | Publikim, Bashkëpunim me Universitetin e Molise, Itali |
| 12. | FBU / DSHUB/ GKMMB | Bioteknologji / Shkenca Ushqimi | Vlerësimi i potencialit teknologjik dhe probiotik të baktereve laktike në produktet tradicionale të bulmetit në Kosovë | Izolimi i baktereve laktike në produktet tradicionale të bulmetit.<br>Identifikimi i baktereve laktike me metodën MALDI-TOF MS.<br>Vlerësimi i potencialit probiotik dhe teknologjik përmes testeve të proteazës, lipazës, vetisë antimikrobiale dhe aktivitetit acidifikues. | Janë kryer analizat e izolimit, identifikimit dhe testet për proteazën, lipazën, vetinë antimikrobiale dhe aktivitetin acidifikues. | Në vazhdim | Një pjesë e rezultateve është në përpunim për publikimin e një artikulli shkencor |
| 13. | FBU / DSHUB/ GKMMB | Bioteknologji / Siguria Ushqimore | Realizimi i analizave të doktoraturës – Progres Raporte<br>MSc. Elton Basha | Ekstraktimi i 10 vajrave esenciale.<br>Analizimi i profilit kimik përmes GC-MS.<br>Analiza e aktivitetit antimikrobik. | Realizuar plotësisht | Në vazhdim | Tezë doktorature e kandidatit MSc. Elton Basha |
| 14. | FBU / DSHUB/ GKMMB-AU & Universiteti Hasan Prishtina | Bioteknologji / Teknologji Ushqimore | Analizat fiziko-kimike në kampionë mjalti autokton shqiptar nga zona të ndryshme të Shqipërisë | Përcaktimi i treguesve fiziko-kimik në kampionët e mjalti autokton shqiptar nga zona të ndryshme të Shqipërisë | Janë përfunduar analizat për parametrat e përmendur | Në vazhdim | Rezultatet janë në përpunim për realizimin e një artikulli shkencor |
| 15. | FBU / DSHUB/ GMK-BBMAU | Bioteknologji / Shendeti Publik | Realizimi i analizave të doktoraturës – Progres Raporte<br>MSc. Edjona Bici | "Assessment of the Albanian Coastal Water and Beaches Quality in Relation to Public Health" | Realizuar 100% | Në vazhdim | MSc. Edjona Bici |
| 16. | FBU / DSHUB/ GMK-BBMAU | Bioteknologji / Kimia mjedisore | Realizimi i analizave të doktoraturës – Progres Raporte<br>MSc. Nertila Mucollari | Studimi i gjendjes shëndetësore të specieve ichtike të konsumuar në lumin Vjosa, bazuar në nivelet e ndotësve organikë në trupat e tyre | Realizuar 100% | Në vazhdim | MSc. Nertila Mucollari |
| 17. | FBU / DK | Bioteknologji & Ushqim / Kimi Mjedisore | Valorizimi i nënprodukteve të industrisë së përpunimit të vajit | Ekstraktimi i komponimeve fenolike nga nënproduktet e industrisë së vajit të ullirit me metoda të ndryshme ekstraktimi | Aktivitet pjesë e doktoraturës "Ekstraktimi i komponimeve fenolike nga nënproduktet e industrisë së | 12/2025 | Në dhjetor 2025 do të zhvillohet prezantimi i katërt dhe |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | përpunimit të vajit të ullirit dhe aplikimi i tyre si përbërës funksional në produkte ushqimore” | | përfundimtar i doktoraturës |
| 18. | FBU / DK / DTAU | Teknologji & Siguria Ushqimore | Identifikimi i problemeve teknike dhe higjienike në linjën e qumështit | Ekspertët italianë vizituan linjën, provuan pajisjet dhe identifikuan problemet kryesore të zgjidhshme brenda kapaciteteve të projektit | U hartua dhe u dorëzua raport në Rektorat mbi nevojat teknike dhe higjienike të linjës së qumështit | 05–06-2025 | Projekti “PROFIT 0” |
| 19. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore | Trajnimi i studentëve dhe specialistëve për prodhimin e mocarelës | Krijimi i kushteve të përshtatshme teknike dhe higjienike në linjën e qumështit | U vlerësuan kushtet dhe u vendosën impiantet e klorinimit dhe të zbutjes së ujit | 06–09-2025 | Projekti “PROFIT 0” |
| 20. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore | Trajnimi i studentëve dhe specialistëve – Prodhimi i mocarelës | Sigurimi i qumështit nga FDE (ferma e UBT), analiza e mostrave paraprakisht dhe gjatë prodhimit, prodhimi i mocarelës | U realizua prodhimi i mocarelës; pjesëmarrës studentë, specialistë, biznese dhe nxënës të shkollës së mesme | 09/2025 | Projekti “PROFIT 0” |
| 21. | FBU / DK | Cilesi & Siguria Ushqimore | Rëndësia e certifikimeve të produkteve tradicionale shqiptare | Grumbullimi dhe prezantimi i të dhënave ligjore dhe procedurave për regjistrimin e produkteve me origjinë shqiptare | U mbajt workshop në ambientet e UBT mbi rëndësinë e certifikimeve të produkteve tradicionale shqiptare | 09/2025 | Projekti “PROFIT 0” |
| 22. | FBU / DK | Kimi Ushqimore / Siguria Ushqimore | Roli i paketimit inteligjent dhe aktiv në cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore | Workshop mbi paketimin, zinxhirin ftohës dhe mbetjet nga paketimet ushqimore | Janë kryer analizat; realizuar temat e diplomave Master; pjesë e rezultateve janë në përpunim për realizimin e një artikulli shkencor | Në proces | Aktivitet pjesë e PKKZH i financuar nga AKKSHI |
| 23. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore | Roli i paketimit inteligjent dhe aktiv | Workshop për prezantimin e rezultateve të projektit PKKZH | Janë kryer analizat; realizuar temat e diplomave Master; një pjesë e rezultateve u prezantua në ICOALS; shkrim artikulli shkencor | 05/2025 | Aktivitet pjesë e PKKZH i financuar nga AKKSHI |
| 24. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore | Vlerësimi i cilësisë së verërave përmes analizimit të parametrave fiziko-kimikë | Analiza e vetive fiziko-kimike të verërave shqiptare | Rast studimor me kantinën “Faba”, realizuar me studentë të Masterit Profesional “Analizat e Ushqimeve” | 05–09-2025 | Bashkëpunim me kantinën “Faba” |
| 25. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore / Kimi Ushqimore | Vlerësimi i parametrave fiziko-kimikë në djathin e bardhë të lopës të prodhuar në Shqipëri | Analiza e vetive fiziko-kimike të djathrave të bardhë | Vlerësimi i disa parametrave fiziko-kimikë të djathrave të prodhuara në Shqipëri | 05–09-2025 | |
| 26. | FBU / DK | Teknologji Ushqimore / Kimi Ushqimore | Përdorimi i nënprodukteve të industrisë së vajit të ullirit si burim i komponimeve bioaktive natyrale | Përdorimi i nënprodukteve të industrisë së vajit të ullirit në zhvillimin e produkteve të përmirësuara me bazë drithi dhe mishi | Analiza e produkteve të përmirësuara në kuadër të temës së diplomës me studentë të Master | 05–09-2025 | - |
| 27. | FBU / DK | Siguria Ushqimore | Vlerësimi i metaleve të rënda në perime në zona të ndryshme të Shqipërisë | Analizimi i metaleve të rënda në patate, domate dhe spinaq | Analizimi i metaleve të rënda në perime në tre qytete të ndryshme të Shqipërisë; realizim i temës së diplomës të studentit të Masterit Profesional “Analizat e Ushqimeve” | 05–09-2025 | - |
| 28. | FBU / DK | Teknologji & Cilesi Ushqimore | Përcaktimi i ndikimit të vetive të grurit në cilësinë e produkteve | Analizimi i mostrave të grurit me metoda instrumentale; përcaktimi i parametrave të grurit dhe ndikimi në cilësinë e miellit dhe bukës | Realizimi i punimit të diplomës me studentë të Masterit Profesional “Analizat e Ushqimeve” | 05–09-2025 | - |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29. | FBU / QKU | Bioteknologji / Teknologji e Pijeve | Vlerësimi i parametrave të cilësisë së verës së prodhuar nën ndikimin e majave të ndryshme fermentative | Vlerësimi i parametrave të cilësisë së verës së prodhuar nën ndikimin e majave të ndryshme fermentative | Studimi i fermentimit të varietetit Shesh i Bardhë | 11/ 2025 | Prof. Asoc. Onejda Kyçyk & Stafi QKU |
| 30. | FBU / QKU | Teknologji Ushqimore / Teknologji e Pijeve | Vlerësimi i parametrave fiziko-kimikë të birrës së prodhuar nga katër burime uji të ndryshme në vend | Vlerësimi i parametrave fiziko-kimikë të birrës së prodhuar nga katër burime uji të zonave të ndryshme të vendit | Studimi i karakteristikave të birrës | 11/ 2025 | Prof. Asoc. Onejda Kyçyk & Stafi QKU |
| 31. | FBU / QKU | Teknologji Ushqimore | Vlerësimi i cilësisë së vajit të ullirit dhe kushtet e ruajtjes së frutit përpara përpunimit | Vlerësimi i cilësisë së vajit të ullirit dhe kushtet e ruajtjes së frutit të ullirit përpara përpunimit | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/2025 | Temë MSc Prof. Asoc. Onejda Kyçyk, Stafi QKU & MSc Lorjana Hysa |
| 32. | FBU / QKU & DTAU | Bioteknologji / Teknologji Ushqimore | Përdorimi i majave alternative në prodhimin e bukës; vlerësimi funksional i *Metschnikowia pulcherrima* për përmirësimin e performancës së *Saccharomyces cerevisiae* | Përdorimi i majave alternative në prodhimin e bukës: Vlerësimi funksional i *Metschnikowia pulcherrima* si bashkëvepruese për përmirësimin e performancës së *Saccharomyces cerevisiae* | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/2025 | Temë MSc Prof. Asoc. Onejda Kyçyk, Prof. Asoc. Alketa Shehaj, Stafi QKU & MSc Gledis Sina |
| 33. | FBU / QKU | Bioteknologji / Ushqimi / Teknologji Ushqimore | Studimi i parametrave fiziko-kimikë të birrës artizanale APA fermentuar me *Metschnikowia pulcherrima* në bashkëkulturë me *Saccharomyces cerevisiae* | Studimi i parametrave fiziko-kimike të birrës artizanale APA (American Pale Ale) të fermentuar me *Metschnikowia pulcherrima* në bashkëkulturë me maja *Saccharomyces cerevisiae* | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/2025 | Temë MSc Prof. Asoc. Onejda Kyçyk, Stafi QKU & MSc Stelina Prroj |
| 34. | FBU / QKU | Teknologji të qëndrueshme / Ushqimi | Vlerësimi i shkallës së pjekurisë me metoda jo destruktive për përcaktimin e kohës optimale të vjeljes së kultivarit "Kalinjot" | Vlerësimi i shkallës së pjekurisë me metoda jo destruktive për përcaktimin e kohës optimale të vjeljes së kultivarit të ullirit "Kalinjot" | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/2025 | Temë MSc Prof. Asoc. Onejda Kyçyk, Stafi QKU & MSc Griselda Shahini |
| 35. | FBU / QKU | Uji / Teknologji Ushqimore/ Shkencat natyrore | Vlerësimi i ndryshimeve stinore të parametrave fiziko-kimikë të ujit në burime natyrore shqiptare për përdorim në industrinë e birrës | Vlerësimi i ndryshimeve stinore të parametrave fiziko-kimikë të ujit në burime natyrore shqiptare për përdorim në industrinë e birrës | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Fatbardha Lamçe, Stafi QKU & MSc Devanja Nuriu |
| 36. | FBU / QKU | Bioteknologji / Enologji | Vlerësimi i skemave teknologjike të prodhimit të verës përmes karakteristikave biokimike | Vlerësimi i skemave teknologjike të prodhimit të verës nëpërmjet karakteristikave biokimike të saj | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Fatbardha Lamçe, Stafi QKU & MSc Eneda Zaimi |
| 37. | FBU / QKU | Bioteknologji / Enologji | Fermentimi i drejtuar me maja të seleksionuara në prodhimin e verës së bardhë të varieteteve autoktone Pulëz dhe Shesh i Bardhë | Fermentimi i drejtuar me maja të seleksionuara në prodhimin e verës së bardhë të varieteteve autoktone Pulëz dhe Shesh i Bardhë | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Fatbardha Lamçe, Stafi QKU & MSc Romario Mukollari |
| 38. | FBU / QKU | Shkencat mjekësore / Bioteknologji | Agjërimi dhe ndikimi i tij mbi mikrobiotën, metabolizmin dhe mirëqënien: qasje fiziologjike dhe ushqimore | Agjërimi dhe ndikimi i tij mbi mikrobiotën, metabolizmin dhe mirëqënien: Një qasje fiziologjike dhe ushqimore | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Rozarta Nezaj, Stafi QKU & MSc Ylli Gramatiku |
| 39. | FBU / QKU | Shkencat sociale / Mjekësore | Disa nga zgjedhjet ushqimore që mund të ndikojnë në problemet e shëndetit mendor | Disa nga zgjedhjet ushqimore që mund të ndikojnë në problemet e shëndetit mendor | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Rozarta Nezaj, Stafi QKU & MSc Stelina Biba |
| 40. | FBU / QKU | Shkencat mjekësore / Bioteknologji | Ndryshimet metabolike në tiroiditin Hashimoto; vlerësimi i elementëve | Ndryshimet metabolike në tiroiditin Hashimoto: Vlerësimi i elementëve gjurmë dhe i | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | 09/ 2025 | Temë MSc Dr. Rozarta Nezaj, Stafi |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | gjurmë dhe ndërhyrjeve dietike; roli i mikrobiotës së zorrëve | ndërhyrjeve dietike me fokus te avokado dhe patatja e ëmbël, dhe roli i mikrobiotës së zorrëve në menaxhimin e sëmundjes | | | QKU & MSc Melinda Kamberi |
| 41. | FBU / QKU | Shkencat sociale / Ushqimi / Siguria Ushqimore | Njohuritë, qëndrimi dhe praktikat për sigurinë ushqimore të nxënësve të shkollës së mesme | Një studim mbi njohuritë, qëndrimin dhe praktikat për sigurinë ushqimore të nxënësve të shkollës së mesme | Temë Diplome Niveli Master Shkencor | Shtator 2025 | Temë MSc Dr. Rozarta Nezaj, Stafi QKU & MSc Enkeleda Kotarja |
| 42. | FBU / QKU & DTAU | Bioteknologji / Enologji | Bio-mbrojtja si alternativë për eliminimin e sulfiteve në verë; ndikimi në cilësinë dhe vetitë sensoriale të verës Kallmet | Bio-mbrojtja si alternativë për eliminimin e sulfiteve në prodhimin e verës: Ndikimi në cilësinë dhe vetitë sensoriale në verën e prodhuar nga varieteti Kallmet | Referime në departament, konferenca, publikime, shkrim teze | 2026 | Tezë doktorature e kandidatit MSc M. Ruci udhëhequr nga Prof. Dr. R. Kongoli |
| 43. | FBU / QKU & DTAU | Bioteknologji / Ushqimi | Aktivitet antimikrobik dhe metabolitet e fermentimit nga maja jo *Saccharomyces* në birrën artizanale dhe krahasimi me majat tradicionale | Studimi i aktivitetit antimikrobik dhe metaboliteve të fermentimit të prodhuara nga maja jo *Saccharomyces* në birrën artizanale dhe krahasimi me majat tradicionale në prodhimin e birrës | Referime në departament, konferenca, publikime, shkrim teze | 2026 | Tezë doktorature e kandidatit MSc J. Karaulli udhëhequr nga Prof. Asoc. Dr. N. Xhaferaj |

## KONKLUZIONE

**Përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të kërkimit shkencor;**

Gjatë periudhës 2024–2025, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU) ka arritur të përmbushë në mënyrë të konsiderueshme objektivat e tij në fushën e kërkimit shkencor. Shumica e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, ndërsa disa prej tyre vijojnë ende në progres, në përputhje me afatet e planifikuara të projekteve kërkimor-shkencore.
Aktivitetet kërkimore të ndërmarra kanë përfshirë izolimin dhe analizimin e mikroorganizmave patogjenë në industrinë ushqimore sipas standardeve të Bashkimit Evropian; vlerësimin e parametrave të cilësisë dhe autenticitetit të vajit të ullirit; studimin e potencialit enologjik të verërave shqiptare; si dhe përdorimin e brumit të fermentuar natyralisht dhe majave alternative në prodhimin e bukës. Rezultatet e këtyre veprimtarive janë reflektuar në më shumë se 20 tema diplome të nivelit master shkencor, mbi 8 teza doktorature në zhvillim, një sërë publikimesh dhe prezantimesh në konferenca ndërkombëtare, si edhe në analizimin e mbi 819 mostrave laboratorike të produkteve ushqimore.
Këto arritje dëshmojnë se FBU ka avancuar në mënyrë të dukshme në fushat e inovacionit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë ushqimore, duke kontribuar si në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe studentëve, ashtu edhe në zbatimin praktik e njohurive shkencore dhe inovacionin në industrinë ushqimore.

**Përputhshmeria e fushave të kërkimit ne nivel departamenti me fushën e kërkimit shkencor në fakultet;**

Fushat e kërkimit të departamenteve DTA, DSHUB, DK dhe QKU tregojnë një përputhshmëri të plotë me prioritetet dhe fushat kryesore të kërkimit shkencor të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit. Kryesisht, departamentet janë angazhuar në projekte që mbulojnë teknologjinë ushqimore, bioteknologjinë, enologjinë, shkencat e ushqimit, kiminë ushqimore dhe mjedisore, si dhe cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Përveç kësaj, disa projekte kërkimore janë multidisiplinare, duke përfshirë fushat e shkencave natyrore, mjekësore dhe sociale.

- Tematikat e kërkimit shkencor në DTAU gjatë vitit akademik 2024-2025 kanë qënë: Qëndrueshmëria dhe autenticiteti i vajit të ullirit; Izolimi i mikroorganizmave patogjenë në pikat kritike të industrisë ushqimore; Potenciali enologjik i varietetit Muskat Hamburg; Potenciali alkool-formues i maltos nga tre tipe drithërash; Përdorimi i brumit natyral të fermentuar në prodhimin e bukës.
- Fushat e kërkimit shkencor në DSHUB gjatë vitit akademik 2024-2025 kanë qënë: Bioteknologjia ushqimore; Mikrobiologjia ushqimore; Aplikimet e biologjisë molekulare në ushqime; Metoda të integruara për vlerësimin ekologjik dhe larmisë biologjike ushqimore.
- Tematikat e kërkimit shkencor në DK gjatë vitit akademik 2024-2025 kanë qënë: Valorizimi i mbetjeve dhe nënprodukteve agro-ushqimore; Ekstraktimi dhe rikuperimi i komponimeve bioaktive; Fortifikimi dhe përmirësimi i produkteve ushqimore; Cilësia, siguria dhe performanca e paketimeve ushqimore; Aplikimi i paketimit inteligjent dhe aktiv; Monitorimi i zinxhirit ftohës dhe indikatorëve TTI; Analiza fiziko-kimike e produkteve ushqimore (djathë, verë, drithëra, miell); Vlerësimi i ndotësve kimikë (p.sh., metalet e rënda) në produktet ushqimore; Përmirësimi i proceseve tradicionale të prodhimit ushqimor dhe standardizimi i tyre; Mbështetja e prodhuesve për rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë në treg.

Tematikat e kërkimit shkencor në QKU gjatë vitit akademik 2024-2025 kanë qënë: Optimizimi i prodhimit të verës dhe fermentimi i drejtuar; Bio-mbrojtja si alternativë ndaj sulfiteve; Aktiviteti antimikrobik i majave jo-Saccharomyces në birrën artizanale; Parametrat fiziko-kimikë të birrës në varësi të burimit të ujit dhe sezonit; Metoda jo-destruktive për vjeljen optimale të ullirit dhe cilësinë e vajit; Majat alternative në prodhimin e bukës; Parametrat fiziko-kimikë të birrës APA; Agjërimi dhe ndikimi në mikrobiotë, metabolizëm dhe mirëqenie; Ushqyerja dhe ndikimi në shëndetin mendor; Ndryshimet metabolike në tiroiditin Hashimoto dhe roli i mikrobiotës.

## 1.5 FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)

Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) është njësia kryesore, e vetme në vend, që merret me veprimtarinë kërkimore shkencore në një fushë të rëndësishme të ekonomisë, si ajo e pyjeve, dizajnit të interierit dhe industrisë së përpunimit të drurit.

FSHP ka një staf akademik të brendshëm prej 28 pedagogësh, të ndarë në tre departamente, si më poshtë:
1. Departamenti Pyjeve (DP), 10 pedagogë;
2. Departamenti Industri Druri (DID), 11 pedagogë;
3. Departamenti Fizikës dhe Shkencave të Aplikuara (DFSHA), 7 persona;

Një nga detyrat kryesore të FSHP-së është fuqizimi i veprimtarisë kërkimore shkencore, duke krijuar një sistem në gjendje të ndërthurë financimet publike dhe private, të promovojë mobilitete dhe bashkëpunim me fakultete të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Në këtë plan ka rëndësi nxitja e kërkimit bazë dhe të aplikuar, eksperimentimi shkencor, ngritja në një nivel më të lartë e marrëdhënieve me sektorin e prodhimit dhe me institucionet publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, përmes kontratave, marrëveshjeve etj.
FSHP synon të arrijë disa objektiva kryesore, të cilat listohen si më poshtë:

- hapja drejt tregut dhe shoqërisë, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të tyre;
- organizimi dhe nxitja e kërkimit shkencor në bazë të kriterit të cilësisë dhe vlerësimi i kapaciteteve individuale dhe kolektive;
- thithja e burimeve financiare brenda dhe sidomos jashtë vendit, nëpërmjet projekteve, marrëveshjeve me institucione të ndryshme etj.;

- transferimi i njohurive nëpërmjet përmirësimit dhe krijimit të lidhjeve të reja me sektorin prodhues;
- krijimi e një qëndre të përhershme të trajnimit profesional në shërbim të sektorit të pyjeve dhe atij të industrisë së drurit në vend;
- rritja e kapaciteteve laboratorike në funksion të punës kërkimore shkencore;
- përmirësimi i sistemit të informimit në kërkim, nëpërmjet krijimit të një data baze, e cila do të informojë mbi linjat e kërkimit në bazë vendi dhe më gjerë;
- ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje, dizajn interieri dhe industrinë e drurit;
- zgjerimi i rrjeteve bashkëpunuese me universitet/fakultet të tjera, me synimin për të rritur kapacitetet kërkimore të FSHP-së.

Për përmbushjen e këtyre objektivave, FSHP-ja do të ndjekë disa politika për t'iu përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje të ekonomisë në fushat e kërkimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë, si më poshtë:

1. hartimi i planeve të kërkimit shkencor në kudër të reformimit të programit të doktoraturës që UBT planifikon të hapë në kuadër të reformës BOKU;
2. realizimi i projekteve shkencore aplikative;
3. bashkëpunimi me agjencitë dhe institucionet publike të administrimit të pyjeve, si dhe me kompanitë pyjore, me studio dizajni dhe ato të përpunimit të drurit, për zgjidhjen e problemeve në sektorin në fjalë;
4. përfshirja e studentëve të nivelit master dhe sidomos doktorantët e ardhshëm në punën kërkimore – shkencore, referuar pikave 2 dhe 3.

**Tabela 1.5 :** Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit (FSHP);

| **Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Plani dhe proceset e planifikuara | **Aktivitetet dhe detyrat konkrete** | **Fakulteti/ Drejtoria/Sektori përgjegjës** | **Realizimi sipas planit strategjik** | **Afati** | **Komente** |
| 1 | Përmirësimi i prioriteteve aktuale të kërkimit | Rishikimi i prioriteteve të kërkimit nga departamentet, me qëllim përqëndrimin në më pak prioritete të rëndësishme për kërkimin | FSHP | Realizuar | Dhjetor 2024 ÷ Nëntor 2025 | Rishikimi i prioriteteve është realizuar në kuadër të reformës së studimeve të doktoraturës me universitetin BOKU |
| 2 | Vijimi i aktiviteteve në kuadër të projekteve të kërkimit të financuar nga AKKSHI | Vijimi i punës në tre PKKZH, një PTI dhe nje PIKSH | FSHP | Realizuar | Dhjetor 2024 ÷ Nëntor 2025 | 7 projekte aktive, 5 projekte PKKZH, një PTI dhe një projekt PIKSH |
| 3 | Aplikimi për projekte kërkimi të mbështetur nga EU | Aplikim për një projekt Horizon 2020 | FSHP | Pa realizuar | Janar 2025 ÷ Nëntor 2025 | Nuk u gjetën partnerë, si dhe nuk erdhi asnjë ofertë për bashkëpunim |
| 4 | | Aplikim të paktën një projekt Erasmus+ | FSHP | Pa realizuar | Janar 2025 ÷ Nëntor 2025 | |
| 5 | Riorganizimi i programit të doktoraturës | Përcaktimi i fushës së kërkimit të studimeve të doktoratës për të tre departamentet | FSHP | Pa realizuar | Maj 2025 ÷ Tetor 2025 | Në Dhjetor 2024 u bë aplikimi në platformën e-Albania për hapjen e shkollës së doktoraturës. Në Tetor të 2025 erdhi përgjigje negative. |
| 6 | Rritja e numrit të botimeve shkencore (artikuj shkencor, monografi, etj.) | Botimi i të paktën 5 artikujve me Faktor Impakti/Scopus nga stafi akademik | FSHP | Realizuar | Dhjetor 2024 ÷ Nëntor 2025 | Janë botuar 14 artikuj, nga të cilët 10 në revista me factor impakti dhe 25 referime në konferenca shkencore |

**KONKLUZION:**

- Numri i artikujve, ku anëtarët e stafit akademik kanë luajtur rol kryesor mes bashkëautorëve, është relativisht i ulët. Kjo tregon mangësi të kërkimit cilësor nga ana e një pjese të stafit të Fakultetit. Kjo lidhet me disa faktorë si:
  - numri i lartë i pedagogëve me tituj;
  - mungesa e shkollës së doktoraturës;
  - mos angazhimi i një pjese të stafit.
- Mungesa e organizimit në GMK-të ndikon në orientimin e punës kërkimore-shkencore në Fakultet.
- Revista e Universitetit nuk shfrytëzohet nga ana e stafit të FSHP-së.
- Angazhim i pakët i stafit në aplikimin për projekte kërkimore.

Veprimtaritë e kërkimit vazhdojnë të zhvillohen më shumë bazuar në përpjekjet dhe angazhimin individual të stafit akademik dhe akoma jo si produkt i planifikimit të bërë në fillim të viteve akademike nga njësitë bazë.

## 1.6 INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE

Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGjB) në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka për qëllim të zhvillojë kërkimin shkencor dhe ruajtjen e diversitetit gjenetik bimor, duke u fokusuar në koleksionimin, karakterizimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike. Veprimtaria kërkimore shkencore dhe akademike e kërkueseve në Institutin e Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGJB) është bazuar në planin e punës kërkimore të miratuar dhe në prioritetet e punës kërkimore të Universitetit. Veprimtaria kërkimore gjatë vitit akademik 2024-2025 është e ndarë në katër fusha kryesore:

**a)** *Eksplorimi dhe Koleksionimi*: Identifikimi dhe ruajtja e kultivarëve lokalë dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore, si dhe pasurimi i Bankës Gjenetike Kombëtare;

**b)** *Menaxhimi i Koleksioneve Ex Situ*: Përmirësimi i aftësisë mbirëse dhe monitorimi i aksesioneve gjenetike;

**c)** *Rigjenerimi dhe Shumimi i Materialeve Gjenetike*: Rritja dhe ruajtja e varieteteve lokale për të siguruar përdorimin e tyre të qëndrueshëm;

**d)** *Karakterizimi dhe Vlerësimi i Germoplazmës*: Analiza fenotipike dhe molekulare për të identifikuar karakteristika të veçanta dhe unike të aksesioneve.

Në drejtim të veprimtarisë kërkimore dhe botuese, personeli akademik i IRGJB ka marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit, ka realizuar botime në revista shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare me faktor impakti, duke përmirësuar vizibilitetin dhe ndikimin akademik të institutit si dhe ka organizuar ekspedita për mbledhjen e materialeve të reja gjenetike nga zona të ndryshme të Shqipërisë.

Për sa i përket zhvillimit dhe transferimit të teknologjive, IRGJB ka shumëzuar fidanët frutorë dhe farërat për t'i shpërndarë te fermerët, duke kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e varieteteve autoktone. Ai ka transferuar njohuri përmes trajnimeve dhe bashkëpunimit me fermerët për praktika të qëndrueshme bujqësore.

Një sfidë e vazhdueshme është erozioni gjenetik, braktisja e zonave rurale dhe mungesa e infrastruktures për eksplorimet dhe koleksionimet. Në këto kushte është imediate rritja e financimeve institucionale dhe ndërmarrja e politikave mbështetëse për të promovuar vitalizimin e zonave rurale dhe ruajtjen e resurseve autoktone.

IRGJB është përfshirë në projekte bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar.Programi "Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore në

zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare", Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024, financuar nga UBT.Eshtë përfshirë në projektin "Farat autoktone" të zbatuar nga GIZ, Programi "Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural" për farat autoktone duke lidhur fermerët, operatorët e agroturizmit dhe bizneset që promovojnë kultivimin dhe ruajtjen e tyre. Projekti VINECERT – 2025. "*Përzgjedhja e materialit bimor te vreshtit autokton shqiptar të kontrolluar nga viruset në funksion të çertifikimit të materialit mbjellës bimor"*. Financuar nga Akademia e Shkencave të Shqiperisë .Politikat e kërkimit shkencor në IRGjB janë të orientuara drejt ruajtjes së pasurisë gjenetike kombëtare dhe fuqizimit të rolit të institucionit si një qendër kërkimore dhe inovacioni në sektorin bujqësor.

### 1.6.2.Veprimtari për punën kërkimore në IRGJB

## Fushat prioritare të kërkimit

1. *Eksplorimi & Koleksionimi i Resurseve Gjenetike të Bimëve.*
2. *Menaxhimi i koleksioneve ex situ (me fara dhe fushore).*
3. *Rigjenerimi dhe shumimi i materialit gjenetik të gjermoplazmës së vendit.*
4. *Karakterizimi dhe vlerësimi i aksesioneve të gjermoplazmës së vendit.*

Tabela 1.6: Realizimi i fushave prioritare të kërkimit shkencor në IRGJB

| Fusha e kërkimit shkencor | Objektiviat* | Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete | Realizimi i aktiviteteve |
|---|---|---|---|
| "Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore në zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare", **Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024.** **Faza I** | Vlerësimi i nivelit të erozionit të specieve dhe varieteteve lokal në fjalë, llojet e rreziqeve dhe propozimi i një plani veprimi për shpëtimin (një raport i detajuar ku përfshihen këto të dhëna) që mund të ndihmojë në ruajtjen e këtyre pasurive natyrore; | 1. Hulumtimi i të dhënave për zonat në studim nga literatura ekzistuese<br>2.Përgatitja e hartave topografike, organizmi i logjistikës dhe ndarja në grupe pune<br>3.Vizita në terren për identifikimin e bimëve me interes, evidentimi i shkallës së përdorimit/shfrytëzimit të llojeve bimore<br>4. Karakterizimi i bimësisë së identifikuar | Të dhënat nga regjistrimet gjatë eksplorimit përfshijnë identifikimin e gjithsej **90 specieve dhe 435 varietete** |
| "Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore në zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare", **Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024.** **Faza II** | 1.Koleksionimi i mostrave të materialit faror dhe atij shumëzues (copa, rrënjë, etj, për së paku 32 aksesione), për pasurimin me aksesione të Bankës Gjenetike Kombëtare.<br>Përgatitja e raportit perfundimtar me speciet dhe varietetet, ku të pasqyrohen të gjitha gjetjet në kuadër të programit të zbatuar. | 1.Koleksionimi i mostrave të identifikuara dhe dokumentimi i tyre<br>2. Përpilimi i një raporti të hollësishëm dhe publikimi i rezultateve nëpërmjet artikujve/posterave | Numri i specieve të kultivarevë tradicional të koleksionuar nga rajoni Gramsh – Mokërr për shtim në fondin e Bankës Gjenetike<br>**22 specie dhe 110 varietete** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Eksplorimi & Koleksionimi i Resurseve Gjenetike të Bimëve | 1. Gjetjet nga kontakte në terren dhe bashkëpunim me fermer në rrethinat e Tiranës (aktivitet institucional).<br><br>2. Eksporime dhe 3 koleksionime ekotipesh ulliri & agrume në Tiranë; | 1. Drufrutore (ulli & agrume)<br>2 Popullata të vjetra ulliri eksploruar në rrethinat e Tiranes;<br>cv. Ulli shekullor Dajti (Tujan, komuna Dajt)<br>cv. Ulliri Ilir (Durisht, komuna Petrel)<br>2 cv. Ulli Vajsi Grublleshit (komuna Ndroq)<br>Olivaster e kuqe, (Grubllesh, komuna Ndroq)<br>2 klone portokalli vendi (zona Laprak, Tinanē) | -Dy Popullata të vjetra ulliri eksploruar në rrethinat e Tiranës<br><br>-Tre ekotipe ulli dhe agrume |
| Menaxhimi i koleksioneve ex situ: bazë fara, fushore dhe aktive (farë + fidanë) | 1. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i fuqisë mbirëse të farës si tregues kryesorë të cilësisë dhe stabilitetit të koleksioneve gjatë periudhës së ruajtjes në koleksionin bazë në B. Gj.<br>2. Përshtatja e BMA në Valias për tipare të rëndësishme si rezistenca ndaj thatësirës dhe lagështirës së fushës, koha e lulëzimit dhe frutifikimi duke qenë se këto lloje janë marrë nga zona me klimë të ndryshme. | 1. Monitorimi u krye në laboratorin e IRGJB në përputhje me protokollet e ISTA dhe udhëzimet standarde të Bankës Gjenetike<br><br>2. Shtimi me pjesë vegjetative në bazën eksperimentale në Valias | 1. Monitorimi testit fuqisë mbirëse:<br>-**16 acc**. të bamjes<br>-**11 acc**. të erëzave<br>-27 **acc.** të bimëve medicinale<br><br>2. Pasurimi koleksionit të bazës eksperimentale në Valias |
| | Monitorimi i ecurise së zhvillimit të 8 aksesioneve, të ndjeshëm ndaj stresit biotik dhe abiotik | 1. Monitorimin në terren të gjendjes së çdo aksesioni ulli.<br>2. Vëzhgim periodik për aspektin fitosanitar dhe për probleme të mundshme të ngadalësimit të ecurisë së zhvillimit vegjetativ nga faktorë të ndryshëm,<br>3. Planifikim zëvëndësimi i bimëve në koleksion që paraqesin degradim dhe prezencë infektimi.<br>4. Krasitje ripërtëritse | Koleksioni paraqet ecuri normale, megjithse duhet konsideruar fakti i disfavorshëm që një pjesë e mirë e aksesioneve nuk janë në vendorigjinën e vet të kultivimit |
| | U shumëzuan 28 aksesione të hardhisë të grumbulluara në rrethin e Përmetit për ruajtje në repozitor, të cilat paraqiten në gjendje të mirë shendetsore. | Mbjellja e tyre në vazo dhe ruajtja në serrë | Këto aksesione do të mbillen këtë vit në fushë |
| Rigjenerimi dhe shumëzimi i materialit gjenetik të gjermoplazmës së vendit | Rigjenerimi dhe shumëzimi i materialit gjenetik të B.GJ fasule dhe qiqër | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias e 4 acc.fasule dhe 5 acc.qiqra për shtimin e sasisë së farës për fermerin | U sigurua sasia e duhur për fermerin dhe B.Gj |
| | Rigjenerimi i 5 acc kamomil dhe 2 acc borzilok | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias e 5 acc. kamomil dhe 2 acc. Borzilok për | U sigurua sasi fare e mjaftueshme për fondin e B.GJ |
| | Rigjenerimi i për *12 acc të Elbit vjeshtor* 10 acc të thekrës, 1 tërshërë dhe 6 pazi | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias sipas deskriptorëve përkatës për 6 tipare | U sigurua sasi fare e mjaftueshme për fondin e B.GJ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Rigjenerimi/shumëzimi 17 acc të bamjes (Abelmoschus esculentus (L.) | Matja e treguesve sipas deskriptorit per rigjenerimin per 7 tregues | U sigurua një sasi fare e konsiderueshme për të gjithë aksesionet, si dhe një % mbirje më e lartë nga ajo që kemi marrë në laborator, gjë e cila vjen si rrjedhojë e vjetërsisë së farave. |
| | 2 ekotipe ulliri dhe agrume;<br>1) *Ulli Vajsi Grublleshi,*<br>*2) Olivaster e kuqe Ndroqi dhe*<br>2 forma portokalli vendi (klone shumë farësh). | 40 fidanë gjithsej ulliri dhe agrume, u vendosën në rrënjëzim me stimulim fitohormoni në serrë (Prezë). | Shtimi me copa të rrënëjzuara i 30 fidanëve ulli.<br>10 fidanë agrume për 2 forma portokalli vendi<br>Të gjithë këto fidanë siguruan një fond rezervë bimësh në koleksion |
| Karakterizimi dhe vlerësimi i aksesioneve të gjermoplazmës së vendit | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për 7 acc B.M për të dalluar tiparet e tyre morfologjike. | Ndjekja e proceseve të karakterizimit dhe vlerësimit sipas deskriptorëve përkatës për 27 tipare primare dhe sekondare morfologjike dhe vlerësimi u bë për 3 tipare kryesore të tyre | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për 5acc. kamomil dhe 2 acc. borzilok |
| | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për *12 acc të Elbit vjeshtor*<br>10 acc të thekrës,<br>1 tërshërë dhe 6 pazi | Ndjekja e proceseve të karakterizimit dhe vlerësimit sipas deskriptorëve *16 parametra/tipare:* ***Karakteristikat morfologjike (8 tipare); Karakteristikat agronomike (4 tipare); Cilësitë e kokrrës (4 tipare).*** | Acc treguan **variacion të gjerë fenotipik** |
| | Studimi i diversitetit morfologjik, nëpërmjet karakterizimit të tipareve për 17 acc autoktone të bamjes (Abelmoschus esculentus (L.) Moench. | Kryerja e matjeve për karakterizimin dhe vlerësimin per tiparet biomorfologjike dhe agronomike të bimëve u krye në bazë të 34 përshkruesve të vendosur nga (IPGRI, 1991), me 18 përshkrues cilësorë dhe 16 përshkrues sasiorë. | Nga karakterizimi dhe vlerësimi i 17 acc të bamjes veçuam acc AGB3690 (Oblike) për prodhimtari të lartë, uniformitet dhe rezistencë ndaj dëmtuesve, si dhe AGB5094 (Bamje trup e lartë) për fruta të mëdhenj dhe kërcell të fortë me shumë degëzime |
| | Karakterizimi dhe vlerësimi i 8 varieteteve (acc) nga koleksioni fushor (IRGJB) Valias, që kanë hyrë në prodhim.<br>Ulliri i bardhi Krujës, Mixan, Frang, Kushan, Kryps Berati, Ullaster vendi, Bahut | Nëpërmjet karakterizimit u bë identifikimi i diversitetit te acc, që rezultoi në nje shkallë dukshmërie mesatare | Një pjesë e mirë e varieteteve nuk janë në arealin e ngjashëm me vend origjinën, ndaj sjellja e moderuar e përshtatshmërisë së tyre në zonë, mbetet e justifikuar.<br>Evidentim i cv. Ulliri i bardh i Krujës, rezultoi me një përshtatshmeri disi më ndryshe në aspektin pozitiv, në raport me 7 acc. e tjerë në studim, kjo nëpërmjet evidentimit të treguesve nga performanca e zhvillimit vegjetativ dhe karakteristikave biologjike individuale. |
| | U karakterizuan 10 aksesionet e hardhisë | Gjatë vegjetacionit u vlerësuan 4 tregues të majës së rritjes dhe 7 tregues të gjethes. | U paraqitën me ndryshueshmëri për 2 karakteristika të lastarit dhe 4 karakterisika të gjethes. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | U karakterizuan 3 aksesioneve të kumbullës | U vlerësuan 5 tregues per tipare morfologjike dhe 7 tregues per tipare te kokrres të gjethes. | U paraqesiten ndryshueshmëri morfologjike midis tyre dhe si të tillë ata janë të ndryshëm dhe unik mbi bazën e karakteristikave morfologjike të tyre. |
| Projekti "Farat autoktone" GIZ<br>Sustainable Development of Rural Areas (SRD)<br>PN (number) 21.2315.6-006.00 | 1. Ruajtja e burimeve gjenetike bimore për ushqim dhe bujqësi<br>2. Kthimi i sasisë së farës në Bankën Gjenetike së dhënë për shumëzim te fermeri<br>3. Çertifikimi i 7 specieve të shumëzuara, gati për tregëtim<br>4. Promovimi dhe Integrimi i varieteteve vendase në bizneset agroturistike | Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së projektit nëpërmjet ekspertizës te fermeri<br><br>2. Trajnime të ndryshme te agroturizmet;<br>3. Ndërgjegjësimi i aktorëve të ndryshëm i vlerave të farave autoktone<br>4. Promovimi i kultivimit dhe ruajtjes së tyre | Kthimi i sasisë së farës për **48** nr. perime të ndryshme të shumëzuara nga fermeri Alban Çakalli duke pasuruar fondin e B.GJ |

**Tabela 1.7:** Numri i mostrave të rigjeneruara, karakterizuara, vlerësuara, koleksionuara dhe analizuara në laboratorin e B.GJ (Janar 2024-Nëntor, 2025);

| **Procesi i realizuar/speciet** | **Njësia** | **Mostra/acc. analizuara** | **Kërkuesi/koleksionuesi /donatori** |
|---|---|---|---|
| **I. Monitorimi_aftësisë mbirëse** | **Nr.** | | |
| Aksesione të bamjes | acc. | **17** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të erëzave | acc | **11** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të bimëve medicinale | acc | **27** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të perimeve (sjellë nga fermeri A.Ç) | acc | **44** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| **Shuma I** | **Totali** | **99** | |
| **II. Rigjenerime/analiza pas rigjenerimeve** | | | |
| Aksesione të bamjes | acc | **17** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme drithëra (thekër, okër, tërshërë) | acc | **10+3+1=13** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione leguminoze (fasule, qiqër, bathë,bizele) | acc | **4+6+24+23=57** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të pazisë | acc | **5** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të bimëve medicinale (kamomil dhe borzilok) | acc | **5+2=7** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| **TOTALI/RIGJENERIME** | **Totali** | **99** | |
| **III. Koleksionime** | | | |
| 90 specie dhe 435 varietete të ndryshme | acc | **90** | Stafi IRGJB |
| 22 specie dhe 110 varietete të ndryshme | acc | **22** | Stafi IRGJB |
| Mostra perime të ndryshme | acc | **22** | Alban Çakalli |
| Mostra të specieve dhe kultivarëve të koleksionuara gjatë vitit 2025(zona juglindore ), | acc | **54** | Prof. Robert Damo<br>Univesiteti Korcë |
| mostra të specieve të egra | acc | **125** | Alban Ibraliu |
| **Shuma III** | **Totali** | **313** | |
| **TOTALI (I+II+III) (99+99+313) =511** | TOTALI | **511** | |

**Konkluzion:** "Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit", evidentojmë se përgjatë vitit 2024-2025 fushat prioritare të kërkimit shkencor janë të mbuluar me aktivitetet përkatëse nga stafi akademik.

# 2. TË DHËNA MBI PROJEKTET E KËRKIMIT SHKENCOR

## 2.1 FAKULTETI I BUJQËSISE DHE MJEDISIT (FBM)

Departamentet e FBM kane ne zhvillim një numër të konsiderueshëm projektesh të fituara në kuadër të programeve kombëtare si **AKKSHI, COST, READ, BIODIVERSITY INTERNATIONAL, ERASMUS** + dhe **HORIZON.** Sipas departamenteve **te dhenat jepen ne tablen 2.2, 2.3, 2.4 te dejauara në pasqyrën anekse.**

Tabela 2.1: Pasqyra e projekteve aktive në FBM;

| Nr | Departamenti | AKKSHI | COST | READ | Biodiv. Intern | Erasmus + | Interreg | Horizon | Me donator te huaj | Te tjera | Tot |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | DSHA | 6 | 1 | 1 | 2 | 3 | - | 1 | - | - | 14 |
| 2 | DSHZ | 1 | 3 | - | - | 2 | - | - | 1 | 1 | 8 |
| 3 | DHAP | 3 | - | - | - | - | - | - | - | - | 3 |
| 4. | DMB | 1 | - | - | - | - | 2 | - | - | - | 3 |
| 5. | DAP | 1 | - | - | - | - | - | - | - | - | 1 |
| 6 | DMBN | 5 | 6 | 2 | - | 1 | - | 2 | | 8 | 24 |
| | **Totali** | **17** | **10** | **3** | **2** | **6** | **2** | **3** | **1** | **9** | **53** |

- Analiza e shpërndarjes së projekteve kërkimore në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit tregon një aktivitet të pabarabartë ndërmjet departamenteve. Dy departamente—DMBN dhe DSHA—rezultojnë më të angazhuarit, me numrin më të lartë dhe diversitet më të madh projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare, duke reflektuar kapacitete të konsoliduara kërkimore dhe rrjetëzim efektiv.
- Në disa departamente të tjera, si DAP dhe DMB, niveli i angazhimit është më i ulët, çka tregon nevojën për ndërhyrje të strukturuar në zhvillimin e kapaciteteve.
- Këto diferenca evidentojnë nevojën për forcim të mbështetjes institucionale ndaj stafit, veçanërisht atij të ri, përmes trajnimeve periodike, mentorimit nga akademikët me përvojë, dhe rritjes së aksesit në infrastrukturë laboratorike. Gjithashtu, krijimi i një mekanizmi të brendshëm ndihmues për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve, si dhe stimulimi i aplikimeve përmes vlerësimit dhe incentivave, do të nxisë rritjen e kulturës së aplikimit dhe konkurueshmërisë kërkimore në të gjitha departamentet.
- Zbatimi i këtyre masave pritet të rrisë ndjeshëm përfshirjen e të rinjve në projekte dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve shkencore të fakultetit.
- Ajo që të bie në sy është se projektet në përgjithësi aplikohen nga individë, dhe nuk k abashkëpunim të mirë midis anëtarëvë të grupeve mësimore kërkimore.
- Grupet mësimore kërkimore shkencore akoma nuk funksionojnë në paraqitjen e propozimeve të përbashkëta që shpesh con dhe në konkurencën midis anëtarëve të cdo grupi për të fituar projekte. Bahkëpunimi midis anëtarëve të një grupi kërkimor shkencor duhet të fillojë që në aplikim dhe më pas në realizimin e projekteve të fituara.

**Konkluzion:** Pabarazia në fitim e projekteve pasqyrohet dhe në shpërndrjene tyre në stafet brënda departamenteve. Nuk pretendohet që të ketë barazi ideale por është detyrë e cdo personeli akademik dhe kërkimor të rrisi nivelin e përfshirjes në projekte për të realizuar një këkrimin më cilësor.

## 2.1 FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)

Gjatë periudhës Dhjetor 2024 – Nëntor 2025 vërejmë një angazhim më të lartë të stafit në projekte në krahasim me vitin një vit më parë. Gjashtëdhjetë e katër anëtarë të stafit janë të përfshirë në 20 projekte kërkimore të fituara (Tabela 2.2). Megjithatë ajo që vihet re dhe që shfaqet si një problematikë e viteve në vazhdim, angazhimi i stafit të FEA-s në kërkim shkencor është më i ulët se sa pritshmëritë. Duke qenë se nevojat për zhvillim në UBT dhe idetë që lindin prej tyre nuk mungojnë, vështirësia qëndron në faktin që pedagogët nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në këtë drejtim. Këtë vit ka patur përpjekje të shtuara për të konkuruar në fonde kërkimi në projekte kombëtare të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), nga të cilat 8 projekte rezultojnë fitues në këtë program ndërsa një akoma pa përgjigje. Janë 8 projekte janë të financuara me fonde të BE, 3 projekte janë Erasmus+, një projekt i financuar me fondet e Western Balkan Fund. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural eshtë angazhuar në 7 (shtatë) projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si koordinator, ndërkohë si anëtar në projekte janë perfshirë 15 anëtarë të stafit akademik (nga 18 gjithsej) duke dëshmuar një angazhim të fortë në projekte me ndikim të lartë shkencor dhe praktik. Suksesi i këtyre projekteve pasqyron aftësitë e stafit akademik dhe fokusin e departamentit në zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe bujqësor. Për të maksimizuar rezultatet, duhet të theksohet rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përshtatja e kërkimeve me nevojat kombëtare dhe globale. Departamenti i Matematikë Informatikës është koordinator në 4 (katër) projekte, Departamenti Drejtimit të Agrobiznesit është koordinator në 5 (pesë) projekte dhe stafi i departamentit të Menaxhimit të Turizmit Rural është koordinator në 3 (tre) projekte. Këtë vit janë fitues edhe tre projekte me mbështetjen e READ.

Jo gjithmonë ecuria e projekteve është pa probleme, kryesisht për shkak të financimit. Për ta përmirësuar këtë situatë mendojmë se do të ishte e domosdoshme që vetë departamenti të hartonte një numër projektesh dhe t'i prezantonte ato në institucione ose organizata financuese potenciale. Dedikimi i fondeve dhe miratimi i tyre në buxhetin e Fakultetit do të mundësonte nxitjen dhe mbështetjen e aktivitetit kërkimor me qëllim përmbushjen e një dimensioni të rëndesishëm të aktivitetit të stafit të departamentit.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, stafi i Fakultetit ka përfituar 73 mobilitete ne kuadër të programeve (Erasmus+,Horizon, Cost, CEEPUS, dhe programe te tjera)

Dhjetë kolegë personel të stafit akademik të Departamentit Turizmit Rural janë përfshirë në projekte të ndryshme kërkimi, në 7 prej të cilave në rolin e anëtarit të projektit. Gjithashtu, ka edhe përfshirje të tjera që i shërbejnë edukimit dhe përhapjes së njohurive në punonjësit e ekonomisë bujqësore dhe turistike rurale. Stafi akademik i Departamentit të Matematikë Informatikës ka marrë pjesë në 9 programe mobiliteti të BE, si dhe në 13 projekte kërkimore ku në 9 prej të cilave në rolin e anëtarit të projektit. Shtatë prej projekteve jane të financuara me fonde të BE.

Në Departamentin Financë Kontabilitet, stafi është angazhuar në 12 projekte, ku në tre prej tyre në rolin e koordinatorit dhe në nëntë si anëtar. Në programe mobiliteti të BE janë përfshirë katër anatarë të stafit akademik. Stafi akademik i Departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit është angazuar në 18 projekte kërkimore, në 8 prejtë cilave në rolin e anëtarit të projektit.

Në total stafi i Fakultetit ka qene i aktivizuar si koordinator në 19 projekte kërkimore dhe ne 45 të tjera si anëtar. Roli i grupeve mësimore dhe kërkimore ka nevojë të forcohet edhe pse propozimi i projekteve zakonisht buron nga diskutimet në grupin kërkimor. Gjithashtu vërehet një bashkëpunim i mirë mes grupeve

mësimore të të njëjtit departament një apo dhe grupeve kërkimore të departamenteve të tjera gjë që dëshmon për nevojën e ndërthurjes së ekspertizave të ndryshme.

Transferimi i teknologjive është një hap i rëndësishëm që plotëson kornizën e një fakulteti bashkëkohor i cili jo vetëm studion dhe aplikon kapacitete shkencore, por edhe i trasferon ato tek të tretë. Në këtë aspekt mbetet ende shumë për të bërë .

**Konkluzion:**

Vërehet një përmirësim i situatës së pjesëmarrjes në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në krahasim me një vit më parë. Po ashtu edhe aplikimet në programet Erasmus kan qenë më të larta. Për sa i përket aplikimeve në programet Horizon, Interreg, Mary Curie, Cost etj ato pothuajse mungojnë. Në drejtim të transferimit të teknologjive mbetet ende shumë për të bërë.

Për të maksimizuar rezultatet, rekomandohet zgjerimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare, diversifikimi i burimeve të financimit dhe integrimi i rezultateve në politikat praktike.

## 2.3 FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU);

FBU ka një rol të spikatur në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe në pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Fakulteti ndjek një qasje të koordinuar në përgatitjen e propozimeve të projekteve, duke integruar punën e grupeve kërkimore dhe mësimore. Ai identifikon mundësi financimi, drejton aplikimet dhe monitoron zbatimin e projekteve, duke siguruar përputhshmëri me objektivat strategjike të kërkimit shkencor dhe kërkesat e institucioneve apo agjencive financuese.

Analiza e të dhënave tregon një angazhim të fuqishëm të stafit të FBU-së/UBT-së në përthithjen e fondeve nga programet Horizon Europe (ERC StG, MSCA, SE, Cluster 6, COST Action), EU FutureFoodS, ADA (APPEAR), Interreg Euro-MED, ICT, si dhe nga agjenci kombëtare financimi si AKKSHI (PIKSH, PKKZH), AADF (READ) dhe ASHSH. Stafi merr pjesë aktivisht edhe në shkëmbime akademike dhe trajnimet e financuara nga programet Erasmus+, CEEPUS, WBF Move, READ, si dhe në projekte bilaterale.

Departamentet DTAU, DSHUB, DK dhe QKU kontribuojnë në mënyrë aktive në shkrimin dhe aplikimin për grante, koordinimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga agjenci dhe programe të ndryshme, sipas të dhënave të përmbledhura në tabelat 2.2, 2.3 dhe 2.4 të raportit.

*Tabela 2.1: Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor (FBU);*

| Nr | Fakulteti/ Departamenti | Emër Mbiemër (Koordinator) | Titulli i Projektit | Intitucioni Financues/Bashkëpunues |
|---|---|---|---|---|
| 1. | FBU / DTAU | Prof. Dr. Renata Kongoli | Mediterranean Network for the Promotion of Sustainability & Authenticity in Olive Oil Sector (OliveOilMedNet) | BE, ERDF (Interreg Euro-MED) |
| 2. | FBU / DTAU | Prof. Asoc. Anila Kopali | Enhancing the Quality and Export Readiness of Albanian Olive Oil SMEs | International Trade Center, Gjeneve |
| 3. | FBU / DTAU | Prof. Asoc. Anila Kopali | Mainstreaming water reuse into circular economy | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | (Water4Reuse) (Prof. Jerome Harmand koordinator) | |
| 4. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | OLIVISION – READ Albania | AADF & AKKSHI (READ) |
| 5. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | VERITAS – HORIZON-MSCA-2025-PF (në fazë vlerësimi) | BE, REA (Horizon Europe, MSCA PF) |
| 6. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | FoodSTEP – HORIZON-TMA-MSCA-SE (në fazë vlerësimi) | BE, REA (Horizon Europe, MSCA SE) |
| 7. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | BICAFoS – HORIZON-TMA-MSCA-SE (nuk ka përfituar financim) | BE, REA (Horizon Europe, MSCA SE( |
| 8. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | FaRMeCoP – HORIZON-CL6-2025-01 (në fazë vlerësimi) | BE, REA (Horizon Europe, Cluster 6) |
| 9. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | HOMES – HORIZON-CL6-2025-02-two-stage (në fazë vlerësimi) | BE, REA (Horizon Europe, Cluster 6) |
| 10. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | SAFEROOTS – HORIZON-CL6-2025-02-two-stage (në fazë vlerësimi) | BE, REA (Horizon Europe, Cluster 6) |
| 11. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | VEATA – ERASMUS-EDU-2025-PEX-COVE (në fazë vlerësimi) | BE, DG EAC (Erasmus+) |
| 12. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | VINNOVATE – ERASMUS-EDU-2025-PI-ALL-INNO (nuk ka përfituar financim) | BE, DG EAC (Erasmus+) |
| 13. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | Building Resilient Agri-Food Systems Through Sustainable Supply Chain Innovation – Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 14. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | Furan Understanding and Safety Evaluation – Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 15. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | One Health: A pan-European network for safe, sustainable, climate-resilient natural products – Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 16. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | Pan-European Network for Occupational Safety, Well-Being and Risk Governance – Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 17. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | Sustainable Aquaculture in a Changing Climate – Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 18. | FBU / DTAU | Dr. Fatjon Hoxha | Transforming Protein-Rich Co-Products into Functional, Health-Promoting Ingredients for Future Food Systems – | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Horizon Europe – COST (në fazë vlerësimi) | |
| 19. | FBU/DSHUB | Prof.Dr. Kapllan Sulaj | Ngritja e Laboratorit të Vajit të Ullirit dhe Vajrave Vegjetale | AKKSHI (PIKSH) |
| 20. | FBU/DSHUB | Prof. Asoc. Dr. Erjon Mamoci | Përdorimi i vajrave esenciale nga bimët mjekësore dhe aromatike shqiptare si antimikrobikë natyrorë në ruajtjen e ushqimeve | AKKSHI, PKKZH |
| 21. | FBU/DSHUB | Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Berberi | Determination of fining agents in autochthonous wines that may induce allergic reactions in the population. | AKKSHI (PKKZH) |
| 22. | FBU/DSHUB & DTAU | Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu | Izolimi i mikroorganizmave sëmundje shkaktuese në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri për arritjen e standardeve të BE në sigurinë ushqimore | AKKSHI (PKKZH) |
| 23. | FBU/DSHUB & DTAU | Prof.As.Rozeta Hasalliu | Identification and characterization of biofilm hotspots in the Albanian dairy producing environments. | AKKSHI (Projekt Bilateral Shqiperi-Austri) |
| 24. | FBU/DSHUB | Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu | Feed hygiene and safety as a tool to improve cow health and safety of dairy products in Albania | AADF & AKKSHI (READ) |
| 25. | FBU/DSHUB | Prof. Dr. Spase Shumka | Environmental assessment of the Vjosa riverscape as the basis for an integrated water management and sustainable catchment development | ADA, APPEAR |
| 26. | FBU / DK & DTAU | Dr. Mariola Kodra | PROspeti PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 - “PROFIT 0” | Rajoni i Puglias, Itali |
| 27. | FBU / DK & DTAU | Dr. Edlira Shahinasi | The Importance of Implementation of Time Temperature Indicators (TTIs) as Quality Monitors in Cold Chain of Food Packaging Products | AKKSHI (PKKZH) |
| 28. | FBU / DK | Prof. Asoc. Dr. Ariola Devolli | Enhancing the infrastructure of the Chemistry Laboratory with a primary focus on the recovery of bioactive compounds from waste and by-products of the agro-food industry, and their utilization as functional ingredients | AKKSHI (PIKSH) |
| 29. | FBU / DK | Dr. Edlira Shahinasi | The Importance of Implementation of Time Temperature Indictors (TTIs) | AKKSHI (PKKZH) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | as Quality Monitors in Cold Chain of Food Packaging Products | |
| 30. | FBU / DK | Dr. Eralda Dano | Development of Low-Cost Adsorbents from Fruits and Vegetables for organic and inorganic removal pollutants | WBF (MOVE) |
| 31. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Onejda Kyçyk | RESOLIVE – HORIZON-MSCA-2025-SE-01-01 (ne faze vleresimi) | BE, REA (Horizon Europe, MSCA SE) |
| 32. | FBU / QKU | Dr. Rozarta Nezaj | Vlerësimi i Përdorimit të Pijeve Energjike nga të rinjtë dhe Analiza e Rrezikut në Shëndetin e tyre (nuk ka perfituar financim) | AKKSHI (PKKZH) |
| 33. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | RS-1607 - Resilient management of bioactive compounds from plants and organic wastes (koordinator lokal, aplikim 26/27) | Zyrat Kombëtare CEEPUS, shtetet pjesëmarrëse |
| 34. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | SI-1312 – Water, a common but anomalous substance that has to be taught and studied (koordinator lokal, aplikim 26/27) | Zyrat Kombëtare CEEPUS, shtetet pjesëmarrëse |
| 35. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | SK-1516 - BioScience, Food and Health (koordinator lokal, aplikim 26/27) | Zyrat Kombëtare CEEPUS, shtetet pjesëmarrëse |
| 36. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | PL-1606 - Sustainable Development of the Bioeconomy – Management of Sustainable Agricultural Production (koordinator lokal, aplikim 26/27) | Zyrat Kombëtare CEEPUS, shtetet pjesëmarrëse |
| 37. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | CA24132 - Accelerating Innovation and Development of European Microbial Foods (Mic2Food, 2025-2029) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 38. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-29638 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 39. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-29150 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 40. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-29149 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 41. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-29090 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 42. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-28947 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 43. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | OC-2025-1-28768 (propozues sekondar, në fazë vlerësimi) | BE, COST Association, vendet anëtare të COST |
| 44. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | FooD-AI, Proposal ID: 542 (nuk ka përfituar financim) | BE, FutureFoodS |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 45. | FBU / QKU | Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha | Waste2Wellness, Proposal ID: 101219567 (nuk ka përfituar financim) | BE, REA (Horizon Europe, ERC StG) |

## 2.3 FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV)

Gjatë viteve të fundit, FMV ka demonstruar një angazhim të qëndrueshëm në aplikimin dhe zbatimin e projekteve shkencore. Në vitin akademik 2024–2025 është vërejtur: rritje e ndjeshme e aplikimeve në projektet e financuara nga AKKSHI; rritje e bashkëpunimeve ndër-departamentor në hartimin e projekteve; përgatitja e aplikimeve për thirrje të reja financimi nga: AKKSHI; Bashkimi Europian; programe të tjera ndërkombëtare. Këto përpjekje synojnë: rritjen e burimeve financiare për kërkim; forcimin e kapaciteteve kërkimore; përmirësimin e cilësisë së kërkimit dhe kontributit shkencor të fakultetit.

Hartimi dhe zhvillimi i projekteve kërkimore në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare realizohet në nivel të Grupeve Mësimore–Kërkimore (GMK), duke përfshirë në mënyrë të strukturuar personelin akademik të secilit departament. Kjo qasje synon koordinimin efektiv të burimeve njerëzore dhe shmangien e aplikimeve të tepërta ose të ngjashme, të cilat reduktojnë shanset për përzgjedhje në skemat e financimit nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes kësaj metode të organizimit, synohet: rritja e mundësisë së përzgjedhjes së projekteve; shmangia e mbivendosjeve tematike; përfshirja e një numri sa më të madh të studentëve të programeve master dhe doktoraturë në projektet fituese, duke ndikuar drejtpërdrejt në fuqizimin e kërkimit shkencor në nivel doktorature. Duke qenë se fushat e kërkimit në FMV janë të përafërta dhe ndërvepruese, bashkëpunimi ndërdisiplinor ndërmjet GMK-ve është i domosdoshëm. Ky bashkëpunim duhet të orientohet sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Dekanatit të FMV-së, duke siguruar koherencë tematike dhe efikasitet në përgatitjen e projekteve.

Një vlerësim i rëndësishëm i kësaj periudhe është edhe rritja e interesit dhe potencialit për aplikime në programin READ Albania, i cili ka shtuar buxhetin e financimit dhe ka krijuar mundësi të reja për blerjen e kiteve laboratorike dhe pajisjeve të nevojshme për kërkim. Kjo rrit ndjeshëm kapacitetet eksperimentale të laboratorëve të fakultetit. Një aset i rëndësishëm për FMV-në është gjithashtu prania e disa ish-studentëve dhe ish-pedagogëve të cilët aktualisht punojnë si kërkues apo pedagogë në institucione të shteteve të Bashkimit Europian dhe në SHBA. Këta profesionistë përbëjnë një potencial të çmuar për krijimin e lidhjeve të reja bashkëpunuese, për shkëmbimin e ekspertizës dhe për forcimin e komponentit ndërkombëtar të projekteve kërkimore të FMV-së. Këto projekte shkencore, të ndërtuara mbi metodika bashkëkohore, do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e kërkimit të studentëve të doktoratës, duke garantuar aplikimin e standardeve ndërkombëtare dhe integrimin e tyre në rrjetet e kërkimit global

**Tabela 2.4:** Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor (FMV);

| Nr | Emër Mbiemër (Koordinator) | Fakulteti/ Departamenti | Titulli i Projektit | Intitucioni Financues/Bashkëpunues |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Rezart Postoli | FMV | Development of an innovative postgraduate education programme in veterinary public health and food safety in Western balkan area – PEVULOS | BE, Capacity Building, Erasmus + |
| 2. | Rezart Postoli | FMV | Aplikimi i sistemit Biocheck për vlerësimin e nivelit të biosigurisë në | Projekti Bilateral me Turqinë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | fermat e gjedhit për qumësht në Shqipëri dhe Turqi. | |
| 3. | Sokol Duro | FMV/DMMF | Development of expertise on animal health and welfare assessment of goats and sheep in Albania and Austria. | AKKSHI & Agjensia për kërkim e Austrise |
| 4. | Bejo Bizhga | FMV/DLPK | Hartëzimi dhe vlerësimi i habitatit dhe të llojeve të rriqërave që gjenden në Shqipëri dhe përcaktimi me PCR i patogjenëve që mbartin. | AKKSHI |
| 5. | Bejo Bizhga | FMV/DLPK | Kthimi i ish FDE në Qendrën Didaktike Kërkimore dhe Diagnostike (Shumë specialitete) Projekt infrastrukture. | AKKSHI |
| 6. | Erinda Lika | FMV/DLPK | Creation of novel approaches and techniques for antimicrobial resistance surveillance and diagnosis | READ/AADF |
| 7. | Xhelil Koleci | FMV/DSHPV | Roli i dhenve si portator i *Escherichia coli* ekskretuese të toksina Shiga, bazuar në strategjinë "Një Shëndet | AKKSHI/Akademia e Shkencave |
| 8. | Tana Kika | FMV/DSHPV | Antibiotiko-rezistenca në zinxhirin e prodhimit të Shpendëve për vezë: Risqet dhe implikimi në qasjen nje Shendet | AKKSHI |
| 9. | Kastriot Korro | FMV/DSHPV | Study of mortality of arnoviruses in amphibians of Albania | Global Amphibian Alliance and RAF |
| 10. | Dhimiter Rapti | FMV/DLK | Mbrojtja e Shëndetit Publik nëpërmjet diagnostikimit të shpejtë, trajtimit dhe parandalimit të sëmundjes zoonotike të Leishmaniozës | AKKSHI |
| 11. | Kastriot Korro | FMV/DSHPV | "Qasje Nanoteknologjike me Nanopartikula (NPs) me Propolis (Pro) për Bletari Higjienike dhe Bletë të Shëndetshme (Nick Name: ProNPs)" | AKKSHI |
| 12. | Kastriot Korro | FMV/DSHPV | Monitoring Pesticide Residues in Beekeeping Products to Safeguard Bee Health and Food Safety in Albania". | AKKSHI dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan per Zhvillim Programit READ |
| 13. | Fatmira Shehu | FMV/DSHPV | "HEALTH CONNECT" Dipartimento di Medicina Veterinaria UNIBA- Departamenti i Shendetit Publik Veterinar-FMV | BE |
| 14. | Albana Munga | FMV/ DMMF | Ndikimi i suplementeve natyral ushqimor në prodhim dhe parametrat riprodhues në kafshë | AKKSHI |




***Grafiku 1 –*** *Shpërndarja e projekteve sipas programit. Grafiku tregon se programet COST, AKKSHI dhe Erasmus përbëjnë pjesën më të madhe të projekteve kërkimore në FMV. Dominimi i programeve COST dhe Erasmus+ tregon një nivel të lartë të internacionalizimit dhe integrimit në rrjete evropiane të kërkimit, ndërsa projektet e AKKSHI dëshmojnë mbështetje të fortë kombëtare për kërkimin shkencor.*




***Grafiku 2 –*** *Shpërndarja e projekteve sipas departamentit. Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar (DSHPV) reflekton fokusin e tij kërkimor në fushat prioritare të BE-së si siguria ushqimore, antibiotiko-rezistenca dhe shëndeti publik. Departamentet DLPK, DLK dhe DMMF kanë gjithashtu angazhim të qëndrueshëm, por me intensitet më të ulët në krahasim me DSHPV.*




***Grafiku 3 –*** *Shpërndarja e projekteve sipas rolit. Shpërndarja e roleve është e balancuar ndërmjet Koordinatorëve dhe Anëtarëve, çka tregon se FMV ka staf akademik me kapacitete të larta për të udhëhequr projekte, por edhe një pjesëmarrje të gjerë në bashkëpunime multidisiplinore. Kjo balancë është tregues i një strukture të shëndoshë kërkimore dhe rrit potencialin për projekte të reja kombëtare dhe ndërkombëtare.*

**KONKLUZION:**

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme procesin e internacionalizimit, duke krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me universitete dhe institucione kërkimore të Bashkimit Europian. Pjesëmarrja aktive në programet Erasmus+, COST, READ Albania dhe projektet e financuara nga BE ka mundësuar integrimin e stafit akademik në rrjetet evropiane të kërkimit, shkëmbimin e ekspertizës dhe realizimin e projekteve të përbashkëta me universitete prestigjioze si Milano, Porto, BOKU, Torino, Dublin, Camerino, Thessaly, Cordova dhe Stamboll. Këto bashkëpunime kanë kontribuar në modernizimin e metodave kërkimore, rritjen e mobilitetit akademik dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe laboratorëve kërkimorë. Ky intensifikim i marrëdhënieve ndërkombëtare ka rritur dukshmërinë e FMV-së në arenën evropiane dhe ka forcuar kapacitetet kërkimore të fakultetit. Përfshirja e stafit si koordinatorë dhe anëtarë në projekte shumëvjeçare me financim të konsiderueshëm ka sjellë një rritje të qartë të numrit të projekteve dhe të bashkëpunimeve ndërdisiplinore. Për më tepër, rrjetëzimi me ish-studentë dhe kërkues shqiptarë që punojnë në BE dhe SHBA ka krijuar një urë të re bashkëpunimi që ndihmon FMV-në në përfshirjen në projekte me standarde ndërkombëtare dhe në rritjen e kapaciteteve të stafit dhe doktorantëve.

## 2.5 FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP);

**Tabela 2.4:** Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor (FSHP);

| Nr | Emer mbiemer | Fakulteti | Departamenti | Pozicioni | Grada shkencore | Titulli i projektit | Programi | Vlera e projektit | Periudha e implementit (muaj\vit-muaj\vit) | Financuar nga: | Kordinator |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Elvin Toromani | FSHP | DP | Dekan | Prof. | Përdorimi i teknikave inovative të pyllëzimit me dronë (UAV) dhe fizibiliteti i tyre në kushtet e Shqipërisë | PTI | 2.230.000 Lek | 10.2023 – 03.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 2 | Vath Tabaku | FSHP | DP | Lektor | Prof. | Studimi i ripërtëritjes natyrore në grumbujt pyjorë të përshkruar me prerje ripërtëritëse gjatë periudhës 2010÷2020 dhe përcaktimi i masave silvikulturore përmes qasjes "Forest Landscape Restoration" | PKKZH | 1.800.000 Lek | 10.2023 - 03.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 3 | Vasillaq Mine | FSHP | DP | Lektor | Prof. | Ndikimi i rrallimeve të grumbujve pyjor të ahut dhe të pishës së zezë mbi mjedisin pyjor dhe cilësinë e materialit drusor | PKKZH | 1.388.760 Lek | 10.2023 - 12.2024 | AKKSHI | Kordinator |
| 4 | Leonidha Peri | FSHP | DP | Lektor | Prof.asoc. | Percaktimi i shkalles se prekjes dhe perhapjes se demit te shkaktuar nga Brumbujt e levores (Skolitet) ne pyjet me pishe te zeze te Shqiperise, duke perdorur metoden Remote Sensing | Marreveshje bilaterale Shqiperi Turqi | 10000 Euro | 04.2023 – 06.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| | | | | | | Setting-up a management model for combatting the processionaria disease | IPA | 3.960.000/ 2.700.000 Leke | 11.2023 – 12.2025 | IADSA II/ Min. Mjedisit | Kordinator (per FSHP) |
| 5 | Dritan Ajdinaj | FSHP | DID | Zv. Dekan | Prof. | Përmirësimi i performancës së materialeve me bazë druri nëpërmjet aplikimit të teknikave të modifikimit termik | PKKZH | 1.150.500 Lek | 09.2024 - 05.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 6 | Hektor Thoma | FSHP | DID | Shef Dep. | Prof. | Vetitë teknologjike të drurit të trajtuar termikisht dhe ndikimi në r | PTI | 1.159.768 Lek | 09.2024 - 03.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 7 | Holta Çota | FSHP | DID | Lektor | Prof.asoc. | Procese dhe teknika të trajtimit të qëndrueshëm për përmirësimin e vetive të drurit. Modifikimi termik në kushte vakumi: teste dy palëshe në terren të qëndrueshmërisë natyrale të drurit (EN 252) | Bilateral (Itali) | 540.950 Lek | 07.2023 - 07.2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 8 | Armond Halebi | FSHP | DID | Lektor | Dr. | Impakti i aplikimit të metodave të modifikimit termik mbi vetitë teknologjike të drurit dhe materialeve me bazë druri | PIKSH | 12.469.600 Lek | 07.2024 - 03.2025 | AKKSHI | Kordinator |

**Konkluzion:**

- Numri total i projekteve, është relativisht jo i vogël.
- Bashkëpunimi midis departamenteve të Fakultetit në projekte të përbashkëta kërkimi dhe zhvilimi, nuk është në nivelin e dëshiruar.
- Nuk ka asnjë projekt që t'i përkasë DFSHA-së.
- Iniciativa për aplikime në projekte është e kufizuar vetëm në një numër të vogël të stafit.
- Pjesmarrja në projekte ndërkombëtare është minimale.
- Angazhim i pakët i stafit në aplikimin për projekte bashkëpunimi me sektorin prodhues.
- Aplikimet realizohen më shumë bazuar në përpjekjet dhe angazhimin individual të stafit akademik dhe jo si produkt i planifikimit, referuar fushave të kërkimit.

Pjesmarrja e studentëve të doktoraturës, anëtarë të stafit akademik të Fakultetit, ndonëse edhe pse vazhdojnë studimet në fakultete të tjera, është në nivelin minimal.

## 2.6 Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve

**Tabela 2.5:** Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor (IRGJ);

| FAKULTETET | AKKSHI | AKKSHI Bilateral | HORIZON | INTERREG /IPA/EUROMED | READ | AADF | COST | Program Koleksionimi/UBT | GIZ,Albania | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| IRGJB | | | | | | | | 1 | 1 | 2 |
| TOTAL | | | | | | | | | | 2 |

## 3. TË DHËNA MBI LIDHJEN E KËRKIMIT SHKENCOR MBI MËSIMDHËNIEN

| | Erasmus | | | | CEEPUS | | | | Mobilitete te tjera | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2024 | | 2025 | | 2024 | | 2025 | | | | | | | |
| | Trajnim | Mesimdhenie | Trajnim | Mesimdhenie | Trajnim | Mesimdhenie | Trajnim | Mesimdhenie | 2024 | 2025 | COST | FAO | Horizon | Total |
| FBM | 10 | 2 | 9 | 1 | | | | | - | 54 | 14 | 3 | 1 | 82 |
| FEA | 21 | 8 | 20 | 13 | - | - | 3 | - | 3 | 28 | 7 | 1 | 1 | 73 |
| FBU | 4 | 4 | 6 | - | 2 | 5 | 8 | - | 5 | 13 | 8 | - | - | 35 |
| FMV | 1 | 1 | 22 | 11 | - | - | 1 | - | 5 | 25 | 2 | - | - | 61 |
| FSHP | 4 | - | 11 | - | - | - | - | - | 20 | 10 | 3 | - | 1 | 25 |
| Total | 40 | 15 | 68 | 25 | 2 | 5 | 12 | 0 | 33 | 130 | 34 | 4 | 3 | 276 |

| TOTAL MOBILITETE 2025: | 276 |
|---|---|
| TOTAL MOBILITETE ERASMUS+: | 93 |
| TOTAL MOBILITETE CEEPUS: | 12 |
| TOTAL MOBILITY COST: | 34 |
| TOTAL MOBILITY FAO: | 4 |
| TOTAL MOBILITY HORIZON : | 3 |
| TOTAL MOBILITETE TE TJERA | 130 |

### 3.1 FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT (FBM)

Kërkimi shkencor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit të UBT është ngushtësisht i integruar me procesin e mësimdhënies, duke krijuar një cikël të vazhdueshëm dijesh që buron nga laboratori, ferma eksperimentale dhe terreni, dhe kthehet sërish në auditor. Aktivitetet kërkimore mbulojnë një gamë të gjerë fushash — nga zooteknia, prodhimi bimor, mbrojtja e bimëve, hortikultura, mjedisi, peshkimi dhe akuakultura — duke u fokusuar në sfida reale si konservimi gjenetik i racave vendase, teknologjitë e prodhimit të qëndrueshëm, menaxhimi integruar i dëmtuesve, zhvillimi i varieteteve rezistente, rritja e produktivitetit hortikulturor, ruajtja e ekosistemeve ujore dhe përmirësimi i praktikave të akuakulturës. Këto projekte kërkimore pasurojnë drejtpërdrejt mësimdhënien, sepse studentët përfshihen në eksperimente, analiza laboratorike, studime në terren dhe iniciativa inovative që u japin aftësi praktike dhe një perspektivë bashkëkohore. Kështu, fakulteti siguron që çdo modul mësimor të bazohet në evidenca shkencore të përditësuara dhe të përgatisë profesionistë të aftë të adresojnë nevojat emergjente të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri.

Te gjitha departamentet realizojne procesin mësimor me vido projektor duke prezantuar jo vetem pjesën terike por edhe rezultatet praktike të përfituara nga kërkimi shkencor.P.sh DMBN praktikon
aplikacione dhe softëare interaktivë: në fushën e mjedisit dhe burimeve natyrore

Platforma e-edukimit: Platforma të dedikuara për e-edukim që ofrojnë materiale në fushën e mjedisit dhe burimeve natyrore.Artikuj dhe burime shkencore në revista të specializuara në internet ju rekomandohen studentëve (MSc.) në fushën e mjedisit dhe burimeve natyrore, prodhimit bimor dhe shtazor, hortikulturës dhe mbrojtjes së bimëve Grafikë dhe ilustrime: Përdorimi i grafikëve, ilustrime dhe diagrame për të paraqitur informacionin në një mënyrë vizuale që të ndihmojmë studentët të kuptojnë më mirë konceptet mjedisit dhe burimeve natyrore.

Gjatë procesit të mësim dhënies organizohen forume dhe grupe e diskutimi, për të lejuar studentët të ndajnë pyetje, diskutojnë përvojat e tyre, dhe ndajnë informacion dhe burime me njëri-tjetrin.

Projekte të bazuar në teknologji: Studentët janë angazhuar të zhvillojnë projekte që përdorin teknologjinë, si aplikacione për monitorimin e ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës e ujit, monitorimin e biodiversitetit, etj, Në DSHZ studentët organizohen në grupe duke zgjidhur realitete te ndryshme të menxhimit të kafshëve të fermës dhe dhënien e rekomandimeve për metodat që sigurojnë prodhimtari ta lartë, shfrytëzim të burimeve ushqimore, efektivitet dhe ndikim sa më të ulët në mjedis. Mobilitetet e studentëve në vëndet e BE si të nivelit Bachelor dhe MSC, kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë akademike, në harmonizimin e programeve me standardet europiane të arsimit të lartë dhe në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës dhe kërkimin shkencor.

Tabela 3.1: Të dhëna për trajnim dhe mësimdhënie në mobilitet të stafit akademik (FBM);

| Nr | Emer Mbiemer | Fakulteti | Departmenti | Pozicioni | Grada shkencore | Erasmus Trajnim (pershkrimi) | Universiteti Prites | Periudha (muaj/viti) | Fonde |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Jonida Biturku | FBM | DSHA | Asistent lektore | MSc | KA171 | Universiteti I Zagrebit | 14/04/25-18/04/25 | 1,255 € |
| 2 | Najada Kadiasi | FBM | DSHA | Lektore | Dr | KA171-HED-EC7D1945 | University of Catania | 05.05 deri me 23.05.2025 | 2,200 € |
| **Nr** | **Emer Mbiemer** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **EU- Mobility Program (te tjera)** | **Universiteti Prites** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |
| 1 | Jonida Biturku | FBM | DSHA | Asistent lektore | MSc | COST ACTION CA21142 | Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimore Shkup | **29/09/25-01/10/25** | **1,017 €** |
| 2 | Moltine Prebibaj | FBM | DSHA | Asistent lektore | MSc | UBT-BOKU Project | BOKU University | **01.02.2025-31.03.2025** | **2,300 €** |

Tabela 3.2 : Kordinatoret në projektet në implementim në FBM gjatë vitit 2025

| Nr | Emer mbiemer | Fakulteti | Departamenti | Pozicioni | Grada shkencore | Titulli I projektit | Programi | Vlera e projektit | Periudha e implementit (muaj\vit-muaj\vit) | Financuar nga: |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Lirika Kupe | FBM | DSHA | Pergj. Departamenti | Prof. Dr. | "Statusi ekologjik i liqenit të Shkodrës bazuar në Direktivën Europiane të Ujrave", | PKKZH | 1,191,782 | 2023-2024 | AKKSHI |
| **2** | Marsela Alikaj | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. As. | "Vlerësimi i integruar i ndotjes së ujit të Lagunës së Butrintit" | PKKZH | 1,001,858 | 2023-2024 | AKKSHI |
| 3 | Evan Rroco | FBM | DSHA | Pergj. GMK | Prof. Dr. | Bioeconomy excellence alliance for stimulating innovative and inclusive green transition | BE Programi Horizon Europe | 145 000 Euro | 2023-2027 | BE |
| **4** | Evan Rroco | FBM | DSHA | Pergj. GMK | Prof. Dr. | UBT-BOKU | | | 2023-2026 | Qeveria Shiptare |
| 5 | Alban Ibraliu | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. Dr. | Erasmus+ Programme KA103 for the academic years 2019/2020; and 2020/2021; Erasmus+ KA107" Nr. 2020-1-PL01-KA107-078889 for the academic year 26-27 | Erasmus + | | 2026-2027 | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **6** | Alban Ibraliu | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. Dr. | Erasmus+ 2022-KA171-HED-EC7D1945 project for the academic years 2022/2023 to 2027/2028 | Erasmus + | | 2027-2028 | |
| 7 | Alban Ibraliu | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. Dr. | Permiresimi i sistemi te menaxhimit te cilesise nepermjet transferimit te integruar te njohurive ne sektorin e bimeve aromatike dhe mjekesore ne Shqiperi. | READ | | 2024-2024 | |
| **7** | Alban Ibraliu | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. Dr. | Studimi i bimëve qe permbajne Alkaloidet Pirolizidine (PA), bashke shoqëruese të Bimeve Aromatike dhe Mjekesore (BAM) të kultivuara, mundësitë e kontrollit në funksion të ruajtjes dhe rritjes se cilësisë të BAM. | PKKZH | 3,546,115 | 2024-2026 | AKKSHI |
| 8 | Alban Ibraliu | FBM | DSHA | Pedagog | Prof. Dr. | Extension of EURISCO for Crop Wild Relatives (CWR) in situ data and preparation of pilot countries' | Biodiversity International | | 2023-2024 | |
| 9 | Moltine Prebibaj | FBM | DSHA | Pedagog | MSc | Global Quality and standart Programme (GQSP) | Platforma Online UBT_KASH_MBZHR | 1.8 milion euro | 2023-2025 | SECO |
| **10** | Moltine Prebibaj | FBM | DSHA | Pedagog | MSc | Global Quality and standart Programme (GQSP) | Hapja e programit master | 1.8 milion euro | 2023-2025 | SECO |
| 11 | Doriana Bode | FBM | DSHA | Zv. Dekane | Prof. As. | "Exploiting Plant-Microbiomes Networks and Synthetic Communities to improve Crops Fitness (MiCropBiomes)". | CA22158 | | 2023-2027 | |

**Konkluzion:**

Pjesëmarrja e stafit akademik në projekte kërkimore, programe mobiliteti dhe trajnime ndërkombëtare, si Erasmus+ KA171 dhe programe të tjera të BE-së, ka sjellë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, sidomos në ecurinë e kërkimit nga doktorantët. Eksperiencat e fituara nga bashkëpunimet ndërkombëtare, shkëmbimet akademike dhe trajnimet profesionale janë integruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në leksione, ushtrime laboratorike dhe në metodikat e reja të mësimdhënies.

Këto përvoja kanë mundësuar:

- aplikimin e metodave aktive dhe praktike të mësimdhënies,
- përfshirjen e shembujve realë nga projektet kërkimore në auditore,

- forcimin e kompetencave profesional të stafit në fushat e tyre të kërkimit,
- zgjerimin e bashkëpunimit ndëruniversitar duke krijuar mundësi të reja për studentët dhe pedagogët.

Në këtë mënyrë, mobilitetet dhe projektet ndërkombëtare kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë akademike, në harmonizimin e programeve me standardet europiane të arsimit të lartë dhe në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës dhe kërkimin shkencor.

## 3.2 FAKULTETI I EKONOMISE DHE AGROBIZNESIT (FEA)

Kërkimi shkencor në Fakultet shihet lidhur ngushtë edhe me mësimdhënien. Aspektet në të cilat zbatohet kjo lidhje janë: udhëheqjet e studentëve në punimet e diplomave dhe kërkimi shkencor dedikuar përmirësimit të kurikulave dhe programeve mësimore të secilit modul.

Personeli akademik i departamentit jep kontributin e tij në përcjelljen e eksperiencës së tij në fushën e kërkimit shkencor tek studentët nëpërmjet punimeve të diplomës së tyre. Ky transmetim përfshin të gjitha elementët e kërkimit si: përcaktimin e fushës së studimit, të tematikës, përcaktimit të objektivave të kërkimit, ngritjes së hipotezave, hartimin e metodikës së kërkimit, planifikimit të aktiviteteve të kërkimit, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, interpretimit të rezultateve dhe në mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit. Bazuar në sa më sipër në vitin akademik 2024-2025 personeli ka udhëhequr punime diplome në nivelin Master dhe Bachelor.

Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore, personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe karrierës akademike. Kufizimi i fondeve të financimit me planifikimin financiar të kryer gjithë vitit akademik 2024-2025, ka patur ndikimin jo motivues në kryerjen dhe rezultatet e aktivitetit kërkimor dhe shkencor.

Pjesëmarrja në projekte konsiderohet si faktor i rendësishëm i zhvillimit të kërkimit. Gjithsesi, krahasuar me vitin akademik 2023 – 2024, gjatë vitit akademik 2024 – 2025, pjesëmarrja në projekte e stafit akademik dhe sidomos e studentëve ka qenë mjaft e kënaqshme. Për të siguriar mbështetjen e studentëve në veprimtari kërkimore dekanati ka përgatitur një draft masash për rritjen e përfshirjes së studentëve në kërkim e cila duhet të shoqërohet me rritjen e financimit. Një draft kuadër për hapjen e granteve me financime të buxhetit të FEA-s është përgatitur ku studentët duhet të jenë përfituesit kryesor i pagesave për kosto kërkimore në terren. Këto do shërbejnë edhe për të lehtësuar përgatitjen e diplomave të tyre në nivelin Master.

Më e kënaqshme duket situata për përfshirjen e studentëve të ciklit të tretë. Në nivel fakulteti tashmë janë duke kryer kërkimin shkencor në kuadrin e punimit të doktoraturës 82 studentë të doktoratës me tematika që i përkasin fushave të kërkimit të departamentit. Sidomos kërkimi në kuadrin e doktoraturave është një kontribut i rëndësishëm jo vetëm për ngritjen e kapacitetit shkencor të studentëve të doktoratës por edhe si një burim i rëndësishëm për pasurimin e mësimdhënies dhe përmirësimin e programeve të studimit duke sjellë edhe raste dhe shembuj interpretimi.

### 3.2.1 PJESËMARRJA NË PROGRAME TË SHKËMBIMIT

Mbështetja e stafit akademik dhe ndihmës akademik në zhvillimin arsimor profesional dhe personal si një objektiv afatgjatë i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit është aritur nëpërmjet angazhimit në programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar si Erasmus + dhe jo vetëm. Aktualisht në periudhën kohore të analizuar, janë realizuar gjithsej 73 mobilitete nga të cilët 33 mobilitete janë ne kuader te projekte Erasmus+ ,3 (tre) CEPUS për trajnimin e stafit akademik. Projekte Erasmus për mësimdhënie kanë qenë

13 (trembedhjete) dhe 20 (njezet) ne trajnim. Gjithashtu ka patur 37 mobilitete në kuadër të programeve të tjera EU- Mobility Program.

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025 janë angazhuar në mobilitete 73 anëtarë të stafit akademik. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë nga departamenti i Matematikë Informatikes me 32 % të mobiliteteve. Nga departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural 12 %, nga departamenti i Drejtim Agrobiznesit janë realizuar 8% e mobiliteteve. Nga departamenti i Financë Kontabilitet 24 % dhe nga departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural janë realizuar 8% e mobiliteteve, ndërsa nga departamenti i Gjuhëve të Huaja 12% e mobiliteteve në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

**Tabela 3.3**: Të dhëna për trajnim dhe mësimdhënie (FEA);

| Nr. | Emer Mbiemer | Fakulteti | Departmenti | Pozicioni | Grada shkencore | Erasmus Trajnim (pershkrimi) | Universiteti Prites | Periudha (muaj/viti) | Fonde |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zenepe Dafku | FEA | EPZHR | Asistent Lektor | M.Sc. | Të përmirësoj aftësitë mësimore dhe kërkimore në bioekonomi dhe menaxhim mjedisor, si dhe të zhvilloj bashkëpunime akademike dhe profesionale. | University of Life Sciences in Lublin, Poland - PL LUBLIN04 | 05/05/2025-09/05/2025 | 980 € |
| 2 | Etleva Muca | FEA | EPZHR | Lektor | Prof.Dr | Permiresim i literatures | CIHEAM, Montpellier | Tetor 2024 | 980 € |
| 3 | Alban Jaupi | FEA | EPZHR | Lektor | Dr | Trajnim | Lublin | Prill 2025 | 1,390 € |
| 4 | Mariana Nikolla | FEA | DMI | Pergjegje se _ DMI | Prof.Asoc. Dr. | Zbatime të Modeleve Matematikorë dhe Statistikorë | University of life Sciencie, Lublin, Poloni | 10.03.2025 deri 14.03.2025 | 1,250 € |
| 5 | Ambra kraja | FEA | DMI | Lektore | MSc | Zbatime të Modeleve Matematikorë dhe Statistikorë | University of life Sciencie, Lublin, Poloni | 10.03.2025 deri 14.03.2026 | 1,250 € |
| 6 | Ina Pagria | FEA | DMI | Pergjegje se GMK - Statistike | Prof.Asoc. Dr | Building Stronger International Collaboration | University of Economics in Katowice | 19-23 Maj 2025 | 1,255 € |
| 7 | Alerta Basha | FEA | DMI | Lektor i I-re | Prof.Asoc. Dr | Training Mars 2025 | University of life science Lublin,Poland | 10-14 Mars, 2025 | 1,250 € |
| 8 | Anjeza Bekolli | FEA | DMI | Asistente Lektore | Msc. | Exploring Computational and applied aspects of CGTH through interdisciplinary collaboration | Universiteti i Letonise | 26 Maj-7 Qershor | 1,575 € |
| 9 | Klea Nikolla | FEA | DDA | Asistent Lektor | MSc. | Erasmus Trajnim | University of Latvia | 26.05.2025-07.06.2025 | |
| 10 | Klea Nikolla | FEA | DDA | Asistent Lektor | MSc. | Erasmus Trajnim | University of Novi Sad | 21.07-25.07.2025 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Jonida Avdulaj | FEA | DDA | Lektore | Prof.Asoc.Dr | Erasmus Trajnim | Universita degli Studi della Tuscia | 16.12-20.12.2024 | |
| **Nr.** | **Emer Mbiemer** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **Erasmus Mesimdhenie (pershkrimi)** | **Universiteti Prites** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |
| **1** | Arjan Shumeli | FEA | DGJH | Pedagog | Prof Asoc | Erasmus International Staff Week | University of Life Sciences, Lublin, Poland | 31 March-4 prill 2025 | 1,255.00 € |
| **2** | Elsa Zela | FEA | DGJH | Pedagoge | Dr | Erasmus Mesimdhenie | Akademia Profesionale e Serbisë së Jugut, Serbi | 22.06.2025-28.06.2025 | 1,255.00 € |
| **3** | Esmeralda Sherko | FEA | DGJH | Pedagoge | Dr | 1. Erasmus International Staff Week | Kastamonu University, Turqi | 13-17.10.2025 | 1,255.00 € |
| **4** | Blerina Zanaj | FEA | DMI | | Prof.Asoc.Dr. | Mesimdhenie | University of Economics, Katowice, Poland | Prille 2025 | € 1,300 |
| **5** | Drini Salko | FEA | FK | Pedagoge | Prof. Dr | Staff Mobility for Teaching | Zaragoze Univ. | 22/4/2025 | 1,250 EUR |
| **6** | Dori Risilia | FEA | FK | Pedagoge | Prof. Dr | Staff Mobility for Teaching | Zaragoze Univ. | Apr-25 | 1,250 EUR |
| **7** | Dori Risilia | FEA | FK | Pedagoge | Prof. Dr | Staff Mobility for Teaching | Katovic.Univ | | 1,255 EUR |
| **8** | Gerta Gogo | FEA | FK | Pedagoge | Prof. Asoc. Dr | Staff Mobility for Teaching | Vytaus Magnus University | May-25 | |
| **9** | Emiljan Mustaqe | FEA | FK | Pedagoge | Dr | Staff Mobility for Teaching | University of Peloponesse | May-25 | 1250 EUR |
| **10** | Elton Guberaj | FEA | FK | Pedagoge | Prof. As.Dr | Staff Mobility for Teaching | Lublin.Univ | Prill 2025 | 1,255 EUR |
| **11** | Ilir Tomorri | FEA | DDA | Pedagog/ P.GMK | Prof.Asoc.Dr | Menaxhimi i Projekteve në Agrobiznes | University of Peloponnese, Greece | 09.06 - 13.06.2025 | |
| **Nr** | **Emer Mbiemer** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **CEEPUS Program Trajnim (pershkrimi)** | **Universiteti Prites** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |
| 1 | Blerina Zanaj | FEA | DMI | Lektor | Prof. Asoc. Dr. | PL-1606-03-2324-M-178739 | University of Ruse "Angel Kanchev" | Qershor 2024 | € 500 |
| **Nr** | **Emer Mbiemer** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **EU- Mobility Program (te tjera)** | **Universiteti Prites** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Erion Shehu | FEA | DGJH | Pedagog | Msc | Ernst Mach Worldwide PhD Mobility | University of Klagenfurt, Institute of Marketing, Klagenfurt, Austria | 01.06.2024 – 31.08.2024 | 3,450 € |
| 2 | Anila Sulaj | FEA | MTR | Lektore | Prof. Asoc. | Cost Action | Universidade Aberta, Lisbonë, Portugali | Shtator 2024 | 900 euro |
| 3 | Anila Sulaj | FEA | MTR | Lektore | Prof. Asoc. | Visiting Professor | George Mason University, Virxhinia, SHBA | Janar-Qershor 2025 | N/A |
| 4 | Merita Gecaj | FEA | MTR | Pedagoge | Dr | Cost | Harper Adams ,UK | Prill 2025 | Cost-EU |
| 5 | Albana Gjoni | **FEA** | Financë - Kontabilitet | **Lektore** | **Prof. Asoc** | Teaching | Warsaw University of Life Sciences | **11/10-19/10** | NA |
| **Nr** | **Emer Mbiemer** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **Trajnime ne kuadet Projekti** | **Universiteti Prites** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |
| 1 | Jona Mulliri | FEA | DMI | Pergjegjese e GMK | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 3 – Managing your GIS project | Agricultural University of Tirana, Albania | 11 - 15 Nentor 2024 | |
| 2 | Jona Mulliri | FEA | DMI | Pergjegjese e GMK | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 4 – Visualizing and Analyzing Spatial Data in R | Agricultural University of Tirana, Albania | 3 - 7 Shkurt 2025 | |
| 3 | Jona Mulliri | FEA | DMI | Pergjegjese e GMK | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 5 – Spatial Analysis of Climate Data in R | Agricultural University of Tirana, Albania | 4 - 7 Mars 2025 | |
| 4 | Jona Mulliri | FEA | DMI | Pergjegjese e GMK | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 6 – Online Maps - Design, Implementation and More | Agricultural University of Tirana, Albania | 7-11 Prill 2025 | |
| 5 | Edmira Shahu | FEA | DMI | Zv Dekane | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 3 – Managing your GIS project | Agricultural University of Tirana, Albania | 11 - 15 Nentor 2024 | |
| 6 | Edmira Shahu | FEA | DMI | Zv Dekane | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 4 – Visualizing and Analyzing Spatial Data in R | Agricultural University of Tirana, Albania | 3 - 7 Shkurt 2025 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Edmira Shahu | FEA | DMI | Zv Dekane | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 5 – Spatial Analysis of Climate Data in R | Agricultural University of Tirana, Albania | 4 - 7 Mars 2025 | |
| 8 | Blerina Zanaj | FEA | DMI | Lektor | Prof. Asoc. Dr. | Training Course 3 – Managing your GIS project | Agricultural University of Tirana, Albania | 11 - 15 Nentor 2024 | |
| 9 | Anjeza Bekolli | FEA | DMI | Asistente Lektore | Msc | Cooperative Game Theory | University Miguel Hernández de Elche (UMH), Spanjë | 9 - 30 Qershor | € 600 |

**Tabela 3.4**. Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor (FEA)

| Nr | Titulli i Projektit | Lloji i projektit | Numri i personave të përfshirë | Workpackage/ Aktivitetet kryesore | Nr i studentëve të përfshirë |
|---|---|---|---|---|---|
| Departamenti Ekonomi dhe Politika të Zhvillimit Rural | Corruption, informality and elections - The case of Albania | READ AADF | 2 | Rishikim literature Vrojtim Eksperimente | 100 |
| | An empirical analysis of poverty, inequality and budgetary impacts of Albanian Social protection scheme, Economic Aid (Ndihma Ekonomike) in Albania | READ AADF | 2 | Analize te dhenash e intervista | - |
| | CultiVETing (Cultivating Entrepreneurship in the Agrifood Sector through VET 101129202381) | Erasmus Capacity Building | 7 | Ndërtim Metodologjie shkencore, Hartim pyetësorë, intervista, best practice, roundtables, hartim raportesh studimi tregu në rang vendi, raport zhvillimi strategjik për sektorin. | 100 |
| | Laghi D'Albania "Liqenet e Shqipërisë"/Laghi D'Albania, AID 012590/02/1 | Kooperimi Italian | 3 | Zhvillim grupe të agjentëve të zhvillimit lokal, trajnime | 18 |
| | NET4GREEN/No. SA-0300351, Projekt IPA | IPA Interreg/EU | 6 | Studim Tregu, Vlerësim kapacitete dhe aktivizim i aktorëve | 20 |
| **Total** | | | **20** | | **238** |

**KONKLUZION:**

Gjatë vitit akademik 2024 – 2024 janë angazhuar në mobilitete 25 anëtarë të stafit akademik. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë nga departamenti i Matematikë Informatikes me 32 përqind të mobiliteteve. Nga departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zvillimit Rural 12 përqind, nga departamenti i Drejtim Agrobiznesit janë realizuar 8% e mobiliteteve. Nga departamenti i Financë Kontabilitet 24 përqind dhe nga departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural janë realizuar 8% e mobiliteteve, ndërsa nga departamenti i Gjuhëve të Huaja 12% e mobiliteteve në kuadër të projekteve ndërkombëtare. Në projekte kërkimore shkencore në vitin 2024 – 2025 janë përfshirë 238 studentë.

Kufizimi i fondeve të financimit me planifikimin financiar të kryer gjithë vitit akademik 2024-2025, ka patur ndikimin jo motivues në kryerjen dhe rezultatet e aktivitetit kërkimor dhe shkencor.

## 3.3 FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU);

FBU demonstron një angazhim të qëndrueshëm dhe të lartë të stafit akademik në projekte dhe programe kërkimore, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve akademike, bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe forcimin e reputacionit të fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky angazhim siguron një balancë të fortë midis kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe projekteve të financuara, duke rritur ndikimin akademik dhe shkencor të fakultetit.

Pjesëmarrja e stafit në projekte kërkimore dhe programe lëvizshmërie në FBU për vitin akademik 2024–2025 tregon një nivel të lartë angazhimi, me një shpërndarje të balancuar midis roleve të ndryshme. Stafi kontribuon si anëtarë projektesh, koordinatorë aktivitetesh, investigues kryesorë, lektorë dhe trajnerë, duke garantuar implementimin e suksesshëm të aktiviteteve kërkimore dhe mësimore. Në përgjithësi, pjesëmarrja në programet e lëvizshmërisë si Erasmus (training/teaching) dhe CEEPUS mbetet e kufizuar, me vetëm disa anëtarë që kanë realizuar mobilitete, kryesisht në formën e trajnimeve ose mësimdhënies. Një pjesë e stafit shfaq një angazhim më të lartë në projekte, duke marrë pjesë në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe disa individë dallohen për përfshirje relative të lartë, deri në tetë angazhime në projekte të ndryshme. Stafi është aktiv në projekte ndërkombëtare si Horizon Europe, MSCA, Interreg Euro-MED, COST, CEEPUS, ICT, APPEAR dhe WBF, si dhe në projekte kombëtare të financuara nga fonde si AADF, AKKSHI, projekte bilaterale dhe ASHSH, duke kontribuar në zhvillimin kërkimor dhe aktivitetet mësimore.

Pjesëmarrja e stafit në programet e financuara nga Bashkimi Evropian është e pranishme por e kufizuar. Në programin Horizon, stafi përfshihet kryesisht si anëtar, ndërsa mungojnë rolet udhëheqëse; pjesëmarrja në Interreg është kryesisht në rolin e anëtarëve, pa angazhime koordinuese. Megjithatë, një arritje e rëndësishme është fakti që FBU ka në staf një përfitues të programit Marie Skłodowska-Curie Postdoctoral Fellowship, një sukses për herë të parë në Shqipëri.

**Tabela 3.5:** Të dhëna për përfshirjen e stafit akademik në projekte (FBU);

| Nr. | Emer Mbiemer | Fakulteti | Departamenti | Pozicioni | Grada shkencore | Mosha | nr. I viteve te punes ne UBT | Erasmus Program (Trajnim) | Erasmus Program (mesimdhenie) | CEEPUS Program (Trajnim) | CEEPUS Program (mesimdhenie) | EU- Mobility Program (te tjera) | EU- Mobility Programe | Projekt Kordinator | Projekt (Anetar) | Projekt Aktiviteti | Non EU-Funding Projekte | Pjesemarrje ne projekte nderkombetare | pjesemarrje ne projekte kombetare | Projekte me fonde te EU | Horizon Program (Anetar) | Horizont program (Lider) | Pjesemarrje ne programin Horizon | Kordinator Lider IPA/Interreg Program | pjesemarres Kordinator IPA/Interreg Program | Pjesemarrje ne IPA/Interreg Program | Pjesemarrje ne Mary Curie Program | Pjesemarrje ne Cost Program Lead/MC | Read Program/Project Kordinator ADF | Bilateral Program/ Tubitak/NASRI | Programe te tjera nderkombetare | Non Eu Funding Program Activity | Eu Funding Program Activity | International Funding Program Activity |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 (1+2+3+4+5) | 7 | 8 | 9 (7+8) | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 (14+15) | 17 | 18 | 19 (17+18) | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 1 | Nertil Xhaferaj | FBU | DTAU | Përgjegjës Dep. | Prof. Asoc. | 38 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Alketa Shehaj | FBU | DTAU | K/GMK | Prof. Asoc. | 43 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Renata Kongoli | FBU | DTAU | Profesor | Prof. Dr | 60 | 31 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 3 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 4 | Klodi Marku | FBU | DTAU | Lektore | Dr | 45 | 22 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Ariola Morina | FBU | DTAU | Profesor | Prof. Asoc. | 50 | 16 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Elton Basha | FBU | DTAU | As. Lektor | MSc. | 36 | 12 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 1 | 4 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| 7 | Aida Shkurti | FBU | DTAU | K/GMK | Prof. Asoc. | 63 | 21 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 8 | Anila Kopali | FBU | DTAU | Profesor | Prof. Asoc. | 61 | 25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 | 5 | 4 | 4 | 5 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | Anisa Peculi | FBU | DTAU | Profesor | Prof. Asoc. | 38 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Fatjon Hoxha | FBU | DTAU | Lektor | Dr. | 36 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 2 | 4 | 2 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 11 | Manjola Kuliçi | FBU | DSHUB | Profesor | Prof. Asoc. | 43 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Enkeleda Berberi | FBU | DSHUB | K/GMK | Prof. Asoc. | 42 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 13 | Vilma Gurazi | FBU | DSHUB | Lektore | Dr. | 36 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | Sanije Zejnelhoxha | FBU | DSHUB | Lektore | Dr | 40 | 10 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 15 | Merita Stafasani | FBU | DK | Përgjegjës Dep. | Dr. | 50 | 20 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| 16 | Ariola Devolli | FBU | DK | K/GMK | Prof. Asoc. | 48 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 1 | 5 | 6 | 5 | 2 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 | 1 | 1 |
| 17 | Mariola Kodra | FBU | DK | Lektore | Dr. | 46 | 23 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 18 | Edlira Shahinasi | FBU | DK | Lektore | Dr. | 46 | 21 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 1 | 2 | 3 | 3 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 |
| 19 | Artiona Laze | FBU | DK | Profesor | Prof. Asoc. | 38 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 20 | Eralda Dano | FBU | DK | Lektore | Dr. | 37 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 21 | Onejda Kycyk | FBU | QKU | Përgjegjës Dep. | Prof. Asoc. | 46 | 13 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 4 | 5 | 3 | 1 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 22 | Fatbardha Lamçe | FBU | QKU | K/GMK | Dr. | 43 | 17 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 23 | Luziana Hoxha | FBU | QKU | Zv. Dekan | Prof. Asoc. | 41 | 11 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 4 | 5 | 3 | 8 | 0 | 8 | 0 | 8 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 5 | 0 | 8 | 8 |
| 24 | Rozarta Nezaj | FBU | QKU | Kërkuese | Dr. | 44 | 2 | 0 | 0 | 2 | 2 | 2 | 6 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 25 | Julian Karaulli | FBU | QKU | As. Kërkues | Msc | 38 | 5.5 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 4 | 4 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 26 | Mamica Ruci | FBU | QKU | As. Kërkuese | Msc | 39 | 8 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

## 3.3.1 ROLI I STAFIT AKADEMIK NË PROJEKTE

**Stafi akademik i DTAU** ka demonstruar një angazhim të gjerë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë periudhës 2024-2025, duke kontribuar në iniciativa të financuara nga AKKSHI, AADF, Interreg Euro-MED, COST, CEEPUS, ICT. DTAU ka marrë pjesë në 8 projekte kombëtare të financuara nga AKKSHI dhe AADF, 1 projekt ndërkombëtar Interreg Euro-MED, 3 projekte CEEPUS, 7 projekte COST dhe 1 projekt ICT, duke forcuar profilin kërkimor dhe zgjeruar rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Prof. Asoc. Dr. Nertil Xahferaj – i përfshirë në 1 projekt PIKSH,AKKSHI si anëtar.
- Prof. Asoc. Dr. Alketa Shehaj – 1 projekt Interreg Euro-MED si anëtare dhe 1 projekt COST (ACRYRED) si anëtare MC dhe WG;
- Prof. Dr. Renata Kongoli – 1 projekt Interreg Euro-MED (OliveOilMedNet) si partner dhe 1 projekt COST (FoodWaStop) si anëtare MC dhe WGs;
- Dr. Klotilda Marku – 1 projekt Interreg Euro-MED (OliveOilMedNet) dhe 1 projekt PKKZH, AKKSHI si anëtare;
- MSc. Elton Basha – 1 projekt PKKZH, AKKSHI mbi përdorimin e vajrave esenciale si antimikrobikë natyrorë si anëtar;
- Prof. Asoc. Dr. Ariola Morina – 1 projekt COST (ACRYRED) si anëtare WG;
- Prof. Asoc. Dr. Anila Kopali – 1 projekt COST (Water4Reuse), 1 projekt PKKZH, AKKSHI (biofilmat në industrine e qumështit), 1 projekt ICT (enhancing olive oil SMEs), 1 projekt PKKZH, AKKSHI (TTIs), 1 projekt READ (OLIVISION) si anëtare;
- Prof. Asoc. Dr. Aida Shkurti – 1 projekt nderkombetar dhe 1 projekt financuar nga AKKSHI;
- Prof. Asoc. Dr. Anisa Peculi – 3 projekte CEEPUS si koordinatore lokale;
- Dr. Fatjon Hoxha – 1 projekt Interreg Euro-MED, 1 projekt AKKSHI (PIKSH) dhe 1 READ, AADF, 6 projekte COST (BeSafeBeeHoney, ENFiber, FLAVOURsome, ACRYRED, SensAIfood, FoodWaStop) si anëtar MC dhe WG;

**Stafi akademik i DSHUB** ka demonstruar një angazhim të gjerë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë periudhës 2024-2025. DSHUB koordinon pjesë 5 projekte kombëtare të financuara nga AKKSHI dhe AADF (PIKSH, PKKZH dhe READ), 1 projekt bilateral me UP, 1 projekt MOVE, WBF, dhe 1 APPEAR, ADA, duke forcuar profilin kërkimor dhe zgjeruar rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Prof. Dr. Kapllan Sulaj – koordinator i projektit PIKSH "Ngritja e Laboratorit tw Vajit të Ullirit dhe Vajrave Vegjetale", i financuar nga AKKSHI, me përfshirjen e anëtarëve nga departamente të tjera të FBU. Gjithashtu Prof. Sulaj është anëtar në disa projekte COST ACTION dhe ka kryer një kualifikim ne kuadër të një projekti individual në një periudhë 6 mujor në SHBA si Fulbright Scholar në Universitetin "George Mason", Fairfax Virxhinia.
- Prof. Dr. Spase Shumka – koordinator i projektit "Environmental Assessment of the Vjosa Riverscape as the Basis for an Integrated Water Management and Sustainable Catchment Development", i financuar nga APPEAR, ADA, me përfshirjen e doktorantëve dhe bashkëpunim me universitete evropiane.
- Prof. Asoc. Dr. Erjon Mamoci – koordinator i projektit PKKZH "Përdorimi i vajrave esenciale nga bimët mjekësore dhe aromatike shqiptare si antimikrobikë natyrorë në ruajtjen e ushqimeve", i financuar nga AKKSHI, me përfshirjen e anëtarëve të tjerë të FBU dhe një doktorant.
- Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu – koordinator i projektit "Izolimi i mikroorganizmave sëmundje-shkaktues në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri për arritjen e standardeve të BE në sigurinë ushqimore", i financuar nga AKKSHI, me bashkëpunim ndërkombëtar.
- Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu – koordinator i projektit READ "Feed hygiene and safety as a tool to improve cow health and safety of dairy products in Albania", i financuar nga AADF, duke përfshirë bashkëpunimin mes institucioneve akademike shqiptare dhe studiuesve të diasporës.
- Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Berberi – koordinator i projektit PKKZH "Determination of fining agents in autochthonous wines that may induce allergic reactions in the population", i financuar nga AKKSHI, me përfshirjen e anëtarëve nga departamente të tjera të Fakultetit.

Gjatë vitit akademik 2024–2025, stafi i DK ka rritur ndjeshëm angazhimin kërkimor dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, me pjesëmarrje të shtrirë në projekte kombëtare (PIKSH, PKKZH) dhe ndërkombëtare. Disa anëtarë veprojnë si koordinues, të tjerë si anëtarë, dhe dy prej tyre kanë përfituar nga programet trajnimi CEEPUS. Projektet përfshijnë partneritete me institucione evropiane, laboratorë dhe universitete rajonale, duke përfshirë projektin PIKSH për përmirësimin e infrastrukturës së laboratorit të kimisë dhe valorizimin e mbetjeve ushqimore, një hap të rëndësishëm për avancimin e kapaciteteve shkencore të DK/FBU dhe UBT.

- Prof. Asoc. Dr. Ariola Devolli – e përfshirë në 6 projekte: 1 si koordinatore (PIKSH) dhe 5 si anëtare (1 READ, 1 ICT, 1 ASHSH, 2 PKKZH).
- Dr. Edlira Shahinasi – merr pjesë në 3 projekte: 1 si koordinatore (PKKZH) dhe 2 si anëtare (1 PIKSH, 1 ASHSH).
- Dr. Mariola Kodra – e angazhuar në 3 projekte: 2 si koordinatore lokale (1 CEEPUS, 1 projekt i financuar nga Rajoni i Puglias) dhe 1 si anëtare (PIKSH).
- Dr. Merita Stafasani – pjesë e 2 projekteve: të dyja si anëtare (1 PIKSH dhe 1 projekt i financuar nga Rajoni i Puglias).

- Prof. Asoc. Dr. Artiona Laze – e përfshirë në 3 projekte: të gjitha si anëtare (1 PIKSH dhe 2 projekte COST).

Gjatë periudhes 2024-2025, stafi akademik i QKU-së ka demonstruar një angazhim të gjerë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. QKU ka kontribuar në 5 projekte kombëtare të financuara nga AKKSHI, AADF dhe ASHSH, 1 projekt ndërkombëtar MSCA PF, 1 projekt Interreg Euro-MED, 5 projekte CEEPUS dhe 5 projekte COST, duke treguar një angazhim të lartë kërkimor dhe bashkëpunues.

- Prof. Asoc. Dr. Onejda Kyçyk e angazhuar në 6 projekte: 2 si koordinatore dhe 4 si anëtare. Nga këto, 4 janë projekte kombëtare të financuara nga AKKSHI dhe nga AADF, dhe 1 projekt Interreg Euro-MED dhe 1 projekt CEEPUS.
- Dr. Fatbardha Lamçe ka marrë pjesë si anëtare në 1 projekt kombëtar të financuar nga AKKSHI.
- Prof. Asoc. Dr. Luziana Hoxha është përfshirë në 8 projekte ndërkombëtare: investiguese kryesore e 1 projekt HorizonEU Marie Skłodowska-Curie Actions PF, 4 rrjete CEEPUS si koordinatore lokale, 1 projekt COST Action si Grant Awarding Coordinator dhe 2 projekte COST si anëtar MC dhe WG.
- Dr. Rozarta Nezaj është përfshirë në 3 projekte: koordinatore e 1 projekt kombëtar i financuar nga ASHSH dhe anëtare në 2 projekte COST si anëtare MC ose WG.
- MSc. Julian Karaulli ka marrë pjesë në 4 projekte si anëtar: 1 projekt PKKZH të financuar nga AKKSHI, 1 projekt ndërkombëtar të financuar nga Interreg Euro-MED, dhe 2 projekte COST.
- MSc. Mamica Ruci ka qenë e angazhuar në 2 projekte si anëtare: 1 projekt PKKZH të financuar nga AKKSHI dhe 1 projekt ndërkombëtar të financuar nga Interreg Euro-MED.

| Nr | Emër Mbiemër | Fakulteti | Departamenti | Pozicioni | Titulli/Grada shkencore | Titulli i projektit | Programi | Vlera e projektit | Periudha e implementit (muaj\vit-muaj\vit) | Financuar nga: | Kordinator |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Anila Kopali | FBU | DTAU | Profesor | Prof.Asoc.Dr. | Enhancing the Quality and Export Readiness of Albanian Olive Oil SMEs | ICT | – | 05 – 06/ 2025 | International Trade Center Geneva | Kordinator |
| 2 | Anisa Peculi | FBU | DTAU | Profesor | Prof.Asoc.Dr. | Improving Food Quality with Novel Food Processing Technologies | CEEPUS | – | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| | | | | | | For Safe and Healthy Food in Middle-Europe | CEEPUS | – | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| | | | | | | Food Safety for Healthy Living | CEEPUS | – | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| 3 | Fatjon Hoxha | FBU | DTAU | Lektor | Dr. | OLIVISION: Upgrading olive sector and oil quality in Albania through research, education, and collaboration | READ | 1,450,000 ALL | 09. 2025 – 09/ 2026 | AADF dhe AKKSHI | Kordinator |
| 4 | Kapllan Sulaj | FBU | DSHUB | Dekan | Prof. Dr. | Ngritja e Laboratorit të Analizimit të Vajit të Ullirit dhe Vajrave Vegjetal | PIKSH | 14,000,000 ALL | 08/2023-12/2024 | AKKSHI | Kordinator |
| 5 | Erjon Mamoci | FBU | DSHUB | Përgjegjës Dep. | Prof. Asoc. Dr. | Përdorimi i vajrave esenciale nga bimët mjekësore dhe aromatike shqiptare si antimikrobikë natyrorë në ruajtjen e ushqimeve | KKSHI | 1,618,725 ALL | 09/ 2023 - 09/ 2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 6 | Enkeleda Berberi | FBU | DSHUB | Kryetare GMK | Prof. Asoc. Dr. | “Determination of fining agents in autochthonous wines that may induce allergic reactions in the population. | AKKSHI | 1,368,464.00 ALL | 11/ 2023-05/ 2025 | AKKSHI | Kordinator |
| 7 | Rozeta Hasalliu | FBU | DSHUB | Kryetare GMK | Prof. Asoc. Dr. | Izolimi i mikroorganizmave sëmundje shkaktuese në pikat kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore në Shqipëri për arritjen e standardeve të BE në sigurinë | PKKZH | 2,365,430 ALL | 07/2025-07/2027 | AKKSHI | Kordinator |
| 8 | Vilma Gurazi | FBU | DSHUB | Kryetare GMK | Dr. | Nutrition research Synergies; Advancing collaborative efforts, for enhanced nutrition and health in Albania | READ | 7000$ | 10/ 2024-03/2025 | AADF | Kordinator |
| 9 | Manjola Kuliçi | FBU | DSHUB | Profesor | Prof. Asoc. Dr. | The safety of beekeeping products in Albania and in Kosovo | WBF | 937.5 | 02/2025- 07/2025 | Westerns Balkan Fund | Kordinator |
| 10 | Ariola Devolli | FBU | DK | K/GMK | Prof.Asoc.Dr. | Enhancing the infrastructure of the Chemistry Laboratory with a primary focus on the recovery of bioactive compounds from waste and by-products of the agro-food industry, and their utilization as functional ingredients | PIKSH | 12,463,000 ALL | 2025-2026 | AKKSHI | Koordinator |
| 11 | Edlira Shahinasi | FBU | DK | Lektore | Dr. | The Importance of Implementation of Time Temperature Indictors (TTIs) as Quality Monitors in Cold Chain of Food Packaging Products | PKKZH | 1,420,000 ALL | 2023-2025 | AKKSHI | Koordinatore |
| 12 | Mariola Kodra | FBU | DK | Lektore | Dr. | PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 "PROFIT 0" | L.R. 20/2003 del 25/08/2003 “Partenariato per la Cooperazione” art. 3 “Partenariato fra comunità locali” | 7,000 EUR | 02/ 2025-02/ 2026 | Rajoni i Puglias | Koordinator lokal |
| | | | | | | Colloids and Nanomaterials in Education and Research | CEEPUS | | 2025-2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| 13 | Onejda Kyçyk | FBU | QKU | Përgjegjës Dep | Prof. Asoc. Dr. | Vlerësimi i cilësisë së ujërave të burimeve natyrore të Shqipërisë për përdorimin në Industrinë Ushqimore | PKKZH | 2,225,514 ALL | 09/ 2024 – 02/ 2026 | AKKSHI | Kordinatore |
| | | | | | | SK-0405-17-2526 (Umbrella) Renewable energy sources | CEEPUS | - | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| 14 | Luziana Hoxha | FBU | QKU | Zv. Dekan KShP | Prof. Asoc. Dr. | BionovFOOD – Green processing and valorization of organic by-products of distilleries as novel approaches for climate-smart protein applications for alternative food and circular bioeconomy Grant Agreement ID: 101105437 | Marie Skłodowska-Curie Actions PF | €188 590,08 | 09/2023 – 08/2025 | HorizonEU, MSCA PF | Investigues Kryesor |
| | | | | | | RS-1607-05-2526 “Resilient management of bioactive compounds from plants and organic wastes in Middle-Europe” | CEEPUS | - | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| | | | | | | SI-1312-08-2526 “Water – a common but anomalous substance that has to be taught and studied” | CEEPUS | - | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| | | | | | | SK-1516-06-2526 “BioScience, Food and Health” | CEEPUS | - | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| | | | | | | PL-1606-05-2526 “Sustainable Development of the Bioeconomy – Management of Sustainable Agricultural Production” | CEEPUS | - | 09/2025–09/2026 | Zyrat Nacionale të CEEPUS të Shteteve pjesëmarrëse | Koordinator lokal |
| 15 | Rozarta Nezaj | FBU | QKU | Kërkues Shkencor | Dr. | Menaxhimi i qëndrueshëm i ciklit të ujit në Industrinë ushqimore, minimizimi i rrymave të shkarkimeve dhe ndikimit të tyre në sistemin e ujërave pritës. Rast | ASHSH | 269,995 Lek | 10/2025 - 11/2026 | ASHSH | Koordinator |

**KONKLUZIONE:**

Në tërësi, mund të konkludohet se FBU, gjatë vitit akademik 2024–2025, ka rritur më tej angazhimin në kërkimin shkencor, duke u bërë pjesë aktive e një numri në rritje projektesh multidisiplinare dhe shumëpalëshe. FBU ka zgjeruar bashkëpunimet me institucione brenda dhe jashtë vendit, duke kontribuar në zbatimin e projekteve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe duke forcuar vizibilitetin e tij në shkencë dhe arsim brenda dhe jashtë vendit.

Stafi i FBU-së ka arritur të përthithë për herë të parë në Shqipëri fonde nga Bashkimi Evropian përmes programit Horizon Europe për Kërkim dhe Inovacion, konkretisht përmes bursës më të rëndësishme postdoktorale Marie Skłodowska-Curie. Projekti BionovFOOD, i mbështetur nga kjo bursë evropiane, është implementuar (2023-2025) me sukses në bashkëpunim me dy institucione të prestigjioze evropiane: Universitetin e Padovës (Itali) dhe Universitetin Borås (Suedi). Ky shembull suksesi përbën një model të rëndësishëm dhe një dëshmi të qartë të kapaciteteve kërkimore në rritje të stafit akademik të FBU/UBT.

Rritja e pjesëmarrjes në projekte shkencore ka sjellë përfitime të shumta, si zgjerimi i fushave kërkimore, modernizimi i kurrikulave mësimore dhe i seancave laboratorike me studentët, rritja e cilësisë së temave të diplomave dhe forcimi i bashkëpunimeve. Forcimi i kapaciteteve akademike dhe shkencore, si dhe integrimi në rrjete ndërkombëtare në fushën e shkencave të ushqimit, kimisë ushqimore, nutricionit, teknologjisë ushqimore, bioteknologjisë, cilësisë dhe sigurisë ushqimore, dëshmon një vizion të qartë të FBU-së në drejtim të kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Megjithëse numri i projekteve të koordinuara nga FBU mbetet relativisht i ulët, duhet theksuar se veçanërisht gjatë vitit të fundit, vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve nga stafi akademik, përfshirë aplikime drejt programeve prestigjioze të Bashkimit Evropian, si Horizon Europe. Për të rritur më tej suksesin në fitimin dhe koordinimin e projekteve, rekomandohet forcimi i strukturave mbështetëse për kërkimin shkencor, me theks të veçantë te përgatitja dhe menaxhimi profesional i projekteve.

Projektet e BE-së janë kryesisht të fragmentuara, por ekziston potencial i madh për rritje të mëtejshme të pjesëmarrjes, duke kërkuar një strategji të qëndrueshme për të forcuar përfshirjen dhe rolet udhëheqëse të stafit në projekte ndërkombëtare. Gjatë implementimit të projekteve, është konstatuar se disa procedura të brendshme administrative kanë krijuar vështirësi dhe vonesa në zbatimin e aktiviteteve, raportimeve dhe kryerjen e pagesave. Për këtë arsye, rekomandohet rishikimi dhe thjeshtimi i proceseve administrative, si dhe rritja e koordinimit ndërmjet njësive përkatëse. Këto përmirësime do të mundësojnë një zbatim më efikas të projekteve, shmangien e vonesave dhe rritjen e performancës institucionale në tërësi.

## 3.4 FAKULTETI I MJEKSËSISË VETERINARE (FMV);

### a) Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor;

Gjatë vitit akademik 2024–2025, studentët PICD (Programi i Integruar i Ciklit të Dytë) dhe studentët e programit të doktoraturës pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare janë përfshirë në mënyrë të strukturuar në veprimtarinë kërkimore të fakultetit, nën udhëheqjen e stafit akademik dhe në bashkëpunim me njësi të ndryshme departamentale. Kontributi i tyre është shtrirë në disa

fusha, duke përfshirë pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, prezantimin e rezultateve të kërkimit dhe bashkautorësinë në artikuj të botuar në revista të indeksuara në SCOPUS, krahas stafit akademik. Përfshirja e studentëve PICD në projektet e koordinuara nga pedagogët e departamenteve ka ndikuar gjithashtu në realizimin me sukses të udhëheqjeve të diplomave në programet e masterit shkencor, të cilat u mbrojtën me rezultate të kënaqshme në përfundim të vitit akademik. Në projektet shkencore të mbështetura nga AKKSHI, studentët PICD dhe doktorantët kanë marrë një rol aktiv në kryerjen e detyrave kërkimore, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të tyre akademike dhe profesionale dhe duke u përgatitur për karrierë të mëtejshme kërkimore dhe akademike.

**b) Ndikimi i kërkimit shkencor në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit e kurrikulave mësimore;**

Deri në këtë fazë, kërkimi shkencor nuk ka arritur ende të ushtrojë një ndikim të plotë dhe të qëndrueshëm në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe kurrikulave në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Ndikimi i tij vlerësohet kryesisht si i pjesshëm dhe i fragmentuar, duke u reflektuar më shumë në nivel modulesh të veçanta, veçanërisht në programin e integruar në Mjekësi Veterinare. Në disa prej këtyre moduleve, tematikat mësimore janë pasuruar dhe përditësuar duke u mbështetur në gjetjet e fundit shkencore të dala nga aktiviteti kërkimor i personelit akademik, çka përbën një hap pozitiv, por ende jo të mjaftueshëm.

Megjithatë, mbetet ende një potencial i konsiderueshëm i pashfrytëzuar në drejtim të integrimit më sistematik të kërkimit në kurrikula. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e procesit të reformimit që UBT ka ndërmarrë në kuadër të projektit BOKU–AUT 2023, i cili synon transformimin e universitetit drejt një modeli ku kërkimi shkencor shërben si bosht për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Ky tranzicion nënkupton jo vetëm ndërhyrje strukturore në plane mësimore dhe programe studimi, por edhe një ndryshim paradigme në nivel individual, duke kaluar nga një model ku kërkimi dhe mësimdhënia trajtohen si procese paralelë e të ndarë, në një model të integruar ku kërkimi konceptohet si instrument thelbësor për rritjen e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional.

Mobilitetet akademike të stafit për qëllime mësimdhënieje dhe trajnimi në universitete partnere jashtë vendit kontribuojnë potencialisht në pasurimin e programeve të studimit, por këto përvoja ende rrallë përkthehen në ndryshime konkrete dhe të matshme në nivel kurrikular. Raportet që hartohen nga pedagogët pas pjesëmarrjes në programe mobiliteti shpesh mbeten në nivel informues dhe nuk shoqërohen me një analizë të strukturuar në nivel departamenti, si formë llogaridhënieje mbi atë se si përvojat e fituara mund të materializohen në rishikimin e tematikave, metodologjive të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit. Përforcimi i këtij halli lidhës midis kërkimit, mobilitetit dhe reformimit të kurrikulës paraqet një nga sfidat dhe njëkohësisht një nga mundësitë kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të FMV-së.

**KONKLUZION:**

Përfshirja dhe pjesëmarrja aktive e studentëve të programit PICD dhe të doktoraturës në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, në konferenca shkencore, si dhe bashkautorësia në publikime, kanë nxitur në mënyrë të dukshme zhvillimin e kapaciteteve të tyre analitike, metodologjike dhe profesionale. Këto përvoja kanë gjeneruar një ndikim të prekshëm dhe transformues në procesin e formimit të tyre akademik, duke kontribuar në rritjen e kulturës kërkimore brenda fakultetit, forcimin e dimensionit ndërkombëtar të studimeve dhe krijimin e një gjenerate studentësh më të përgatitur për sfidat e kërkimit bashkëkohor dhe të

tregut të punës. Studentët PICD, përmes angazhimit të drejtpërdrejtë në kërkim, po përqafojnë një qasje kritike dhe inovative që e lidh në mënyrë organike formimin teorik me praktikat e avancuara shkencore.

Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, integrimi i plotë dhe i strukturuar i këtyre përvojave kërkimore në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe kurrikulave mësimore mbetet një sfidë strategjike për FMV-në. Përditësimi kurrikular i mbështetur në gjetjet shkencore vazhdon të jetë i fragmentuar dhe sporadik, pa një mekanizëm të konsoliduar që ta kanalizojë në mënyrë të qëndrueshme këtë potencial në përmbajtjen mësimore. Në kontekstin e reformës së thellë që UBT ka ndërmarrë përmes projektit BOKU–AUT 2030, bëhet imperative kalimi drejt një modeli akademik në të cilin kërkimi shkencor është jo vetëm komponent shoqërues, por motor udhëheqës i zhvillimit të kurrikulës dhe i përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Ky transformim kërkon një rikonceptim të rolit të pedagogut, nga transmetues tradicional dijesh, në aktor inovacioni që e rifreskon dhe e pasuron në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen akademike mbi bazën e rezultateve të kërkimit. Vetëm përmes këtij modeli të integruar kërkim–mësimdhënie, FMV mund të sigurojë një ofertë akademike konkurruese dhe plotësisht të përputhur me standardet bashkëkohore europiane.

## 1.7 FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE

Tabela 3.6: Mobiliteti I stafit akademik sipas programeve (FSHP);

| Nr. | Emër Mbiemër | Fakulteti | Departmenti | Pozicioni | Grada shkencore | Erasmus Trajnim (përshkrimi) | Universiteti Pritës | Periudha (muaj/viti) | Fonde |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Marsela Luarasi | FSHP | DP | Zv.Dekan | Dr. | Po | Universiteti i Riges Letoni | Qershor 2025 | 1400 Euro |
| 2 | Enea Malaj | FSHP | DP | Lektor | MsC. | Po | University of Agricultural Sciences and Veterinary Medicine of Cluj-Napoca, Romania | 15.06.2025 - 01.07.2025 | 1455 Euro |
| 3 | Doklea Quku | FSHP | DID | Lektor | Prof.asoc. | Po | USAMV Cluj-Napoca, Faculty of Forestry and Cadastre | Prill 2025 | 2160 Euro |
| 4 | Alketa Grepcka | FSHP | DID | Lektor | Dr. | Po | Vytautas Magnus University | 5-9 Maj 2025 | 1030 Euro |
| 5 | Erald Kola | FSHP | DID | Lektor | Dr. | Po | USAMV Cluj-Napoca, Faculty of Forestry and Cadastre | Prill 2025 | 2160 Euro |
| 6 | Besar Shehu | FSHP | DID | Lektor | MsC. | Po | USAMV Cluj-Napoca, Faculty of Forestry and Cadastre | Prill 2025 | 2160 Euro |
| 7 | Ina Vejsiu | FSHP | DFSHA | Lektor | Dr. | Po | USAMV Cluj-Napoca, Faculty of Forestry and Cadastre | Prill 2025 | 2160 Euro |
| 8 | Teuta Halilaj | FSHP | DFSHA | Lektor | MsC. | Po | University Novi -Sad , Serbi | Korrik 2025 | 630 Euro |
| **Nr** | **Emër Mbiemër** | **Fakulteti** | **Departmenti** | **Pozicioni** | **Grada shkencore** | **EU- Mobility Program (të tjera)** | **Universiteti Pritës** | **Periudha (muaj/viti)** | **Fonde** |
| 1 | Enea Malaj | FSHP | DP | Lektor | MsC. | Po | CIHEAM Zaragoza | 09-11 Prill 2025 | Të paguara nga CIHEAM |
| 2 | Dritan Ajdinaj | FSHP | DID | Zv.Dekan | Prof. | Po | Univ.Ljubljanës | Tetor/2025 | SUSFUR |
| 3 | Alketa Grepcka | FSHP | DID | Lektor | Dr. | Po | Ciheam Montpellier | Janar/2025 | INSI-VAT |
| 4 | Erald Kola | FSHP | DID | Lektor | Dr. | Po | Univ.Ljubljanës | Tetor/2025 | SUSFUR |
| 5 | Gladiola Malollari | FSHP | DFSHA | Lektor | Msc. | Vertically Characterization of Natural And Polluted Aerosol Over Tirana And The Greater Albania Region | Leibniz Institute for Tropospheric Research, Leipzig | Gusht 2024-Shkurt 2025 | 1350 EUR |
| | | | | | | Izaña School on Atmospheric Optics | Izaña Observatory, Tenerife, Canary Islands, Spain | Maj 2025 | 800 EUR |

# IV. INFRASTRUKTURA NË MBËSHTETJE TË KËRKIMIT SHKENCOR

## 4.1 Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM)

Në FBM operojnë si struktura në funksion të mësimit dhe kërkimit laboratorët mësimor kërkimor .

**DSHA** 13 Laboratorë Mësimore Kërkimore (didaktik&eksperimental
**DMBN** 1 Laboratorë Mësimore Kërkimore (didaktik,eksp. shërbime)
**DSHZ** 2 Laboratorë Mësimorë Kërkimorë (didaktik eks. shërbime)
**DHAP** 3 Laboratorë Mësimore Kërkimore (didak. eksp. 1 shërb)
+Studio e Arkitekturës së Peizazhit
**DMB** 1 Laboratorë Mësimore Kërkimore (didak. eksp. Shërbime)
**DAP** 2 Laboratorë Mësimore Kërkimorë (didak. eksp. Shërbime)

Informacioni për këtë çështje të paraqitet në **mënyre përshkruese dhe tabelare (Tabela 5.1)**, duke mbajtur në konsideratë: a) të dhëna në lidhje me pajisjen e sallave/laboratorëve/bibliotekave me mjete teknike të nevojshme për realizimin e kërkimit shkencor; b) të dhëna mbi infrastrukturën për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit shkencor.

**Tabela 5.1 :** Të dhëna mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.

| **Njësia Kryesore** | **Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…)** | **Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor** | **Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)** |
|---|---|---|---|
| | Laboratori fushor tek FDE | Laborator ekpserimental per kerkim tema diplomash dhe per t'ju ardhur ne ndihme bizneseve | Fusha eksperimentale eshte ne sherbim te kerkimit shkencor elite ne fushen e BAM, per krijimin e varieteteve te reja |
| | Laboratori fushor tek FDE | Laborator ekpserimental per kerkim tema diplomash dhe per t'ju ardhur ne ndihme bizneseve | Fusha eksperimentale ofron mundësinë bizneseve, kompanive të BAM, për të testuar në mënyrë shkencore çdo varietet apo kulturë të re e cila potencialisht mund të vlerësohet mundësia e kutivimit në Shqipëri. |
| | Laboratori fushor tek FDE | Laborator ekpserimental per kerkim tema diplomash dhe per t'ju ardhur ne ndihme bizneseve | Ofrojme për fermerët, kompanitë e BAM, të gjitha, trajnimet e duhura, protokollet e duhura agronomike për kultivimin e të gjithë BAM të kultivuara në Shqipëri. |
| | Laboratori i Fiziologjise | **Didaktik/ Shkencor:** Mbeshtet modulet e Fiziologjise se Bimeve (BSc.) si dhe Fiziologjia e bimeve te kultivuara MSc.) Ku studentet e Masterit Shkecor realizojne punet praktike te modulit si dhe zhvillojne temat e diploma. Ky laborator eshte I alternuar me fushen eksperimenatale. | Jo |

| Njësia Kryesore | Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…) | Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor | Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet) |
|---|---|---|---|
| | Laboratori I Biokimi Fiziologjise | **Didaktik** (Mbeshtet modulet e Biokimise dhe Fiziologjise se Bimeve ne BSc. Si dhe Modulet ne MSc: Kimia dhe Biokimia e pesticideve, Fitohormonet Bimore. | Jo |
| | Laboratori Biokimi-Fiziologji bimesh, | **Didaktik dhe shkencor:** Mbeshtet zhvillimin e temave te diplomave Master | Jo |
| | Laboratori I Botanikes | **Didaktik/Kerkimor:** Mbeshtet **t**e gjithe procesin mesimor ne modulet Botanike dhe Sistematika e bimeve. Gjithashtu, stafi kete vit u pais me nje mikroskop dhe nje stereomikroskop per punet kerkimore. | Jo |
| | Laborator i Elektroforezes | **Didaktik**: Mbulon procesin mesimor ne Modulet e Gjenetikes, permiresimit gjenetik | Jo |
| | Laborator i kulturave Invitro | **Didaktik**: Mbulon procesin mesimor ne Modulet permiresimit gjenetik, Prodhimi I farave | Jo |
| | Laboratori i bioteknologjise | **Didaktik**: Mbulon procesin mesimor ne Modulet e Bioteknologjise se Bimeve | Jo |
| | Laborator i energjetikes | **Didaktik**: Mbulon modulet e bioenergjise dhe energjive alternative | Jo |
| | Laboratori I makinave bujqesore | **Didaktik**: Mbulon modulet e makinave bujqesore dhe Mekanizimit ne Bujqesi | Jo |
| | Laborator i Energjive te Rinovueshme | **Didaktik**: Mbulon modulet e Energjise alternative dhe Sistemet e Energjive te Rinovueshme si dhe realizimin e temave te diplomave te studenteve | Jo |
| | Laboratori Prodhimit te bimeve te arave | **Shkencor:** Ky laborator u krijua ne vitin 2024, me financim nga AKKSHI, I cilii do te jete ne funksion te studneteve te temave te Doktoratures por edhe te Masterit Shkencor. | Jo |
| | Laboratori i Prodhimit Bimor | **Didaktik**: Ky laborator eshte ne funksion te mesimit per modulet e Prodhimit te bimeve te arave (Foragjere, BAM, Industriale) | Jo |
| | Laboratori Shkencor i Mbrojtjes së Bimëve | Mbështetës i kërkimit shkencor dhe mësimdhënies | Ofron shërbim me të tretët: Diagnostikimin e dëmtuesve të bimëve bujqësore |
| | . Laboratorit Shkencor i Agromjedisit dhe Ekologjise | Laborator ne mbeshtetje te mesimdhenises, kerkimit shkencor dhe sherbimit per te tretet | Analiza toke, uji, bime, sedimente dhe mbetjeve te ndryshme; treguesit jane elementet ushqyes, cilesite fizioko kimike te tokave, treguesit kimik te ujrave, permbajtja e metaleve te renda ne toke, uje, bime, sedimente, etj. |
| | . Laboratori i Mikrobiologjise | Laborator ne mbeshtetje te mesimdhenises, kerkimit shkencor dhe sherbimit per te tretet | Analiza mikrobiologjike dhe molekulare ne uje, ujerat e zeza, sedimente, toke. |

| Njësia Kryesore | Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…) | Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor | Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet) |
|---|---|---|---|
| | Mjedisore dhe Molekulare | | |
| | Laboratori I Cilësisë dhe Analitikës së ushqimeve për kafshët | Mësimdhënie si dhe Kërkim shkencor | Analiza të ushqimeve për blegtorinë.<br>. Shërbim për të tretët **për** analizat e ushqimeve për fermat dhe industrinë si dhe ekspertizë ne fushën e të ushqyerit të kafshëve në ferma ( *miratuar nme vendim senati 2024)* |
| | Laboratori I Bioteknologjise se Kafsheve | Mësimdhënie si dhe Kërkim shkencor | |
| | Laboratori I Iktiologjise ne Durres | | |
| | Laboratori I Hidrokimise ne Durres | | |
| | Laboratori shkencor hortikulturës | Mësimdhënie si dhe Kërkim shkencor | Nuk ofron shërbime për të tretët |
| | Laboratori i cilësisë dhe Teknologjisë Smart në Fruta dhe Perime | Mbështet kërkimin shkencor dhe mësimdhënien në disa module të ciklit të parë dhe të dytë | Mund të ofojë dhe Shërbim për të tretët. |
| | Laboratori i Mikroshumimit | Laboratori është i amortizuar dhe është jashtështë cdo lloj funksioni funksion për të mbështetur kërkimin dhe | Nuk ofron shërbime për të tretët |
| | Studio e Arkitekturës së Peizazhit | Mbështet mësimdhënien dhe pjesërisht kërkimin shkencor | Nuk ofron shërbime për të tretët |

**KONKLUZION:**

Infrastruktura laboratorike e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit paraqet një gamë të gjerë njësish didaktike dhe kërkimore që mbështesin si procesin mësimor, ashtu edhe veprimtarinë shkencore të fakultetit. Një pjesë e laboratorëve, kryesisht në fushën e mbrotjtjes së bimëvee, agromjedisit, fiziologjisë, bioteknologjisë dhe biokimisë, ofrojnë kushte të mira për realizimin e temave të diplomave, të projekteve kërkimore dhe të punimeve praktike në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë. Këta laboratorë luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e kompetencave praktike të studentëve dhe në rritjen e cilësisë së botimeve dhe kërkimit shkencor.

Në disa njësi, si Laboratori Shkencor i Mbrojtjes së Bimëve, Laboratori i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Mikrobiologjia Mjedisore, si dhe Laboratori i Analitikës së Ushqimeve për Kafshët, infrastruktura është e orientuar edhe drejt ofrimit të shërbimeve për të tretët. Këto laboratorë kontribuojnë në lidhjen e universitetit me sektorin bujqësor, industrinë ushqimore, bizneset e BAM, dhe fermerët, duke ofruar

diagnostikime, analiza kimike, mikrobiologjike, molekulare dhe ushqimore. Kjo rrit jo vetëm impaktin shkencor, por edhe rolin social dhe ekonomik të fakultetit.

Nga ana tjetër, disa nga laboratorët e listuar – si laboratori i mikroshumimit, disa laboratorë didaktikë të vjetër dhe një pjesë e pajisjeve të amortizuara – nuk i plotësojnë kushtet për kërkim bashkëkohor dhe nuk kontribuojnë në shërbime apo zhvillimin e projekteve. Kjo krijon një pabarazi të ndjeshme ndërmjet njësive kërkimore, duke kufizuar kapacitetet shkencore të disa departamenteve. Gjithashtu vihet re se pjesa më e madhe e laboratorëve funksionon në rol didaktik, ndërsa aftësia për të ofruar shërbime të specializuara dhe për të gjeneruar të ardhura mbetet e përqendruar në pak njësi.

Situata tregon qartë se fakulteti zotëron potencial të konsiderueshëm kërkimor, por ka nevojë për investime të synuara në modernizimin e pajisjeve, rehabilitimin e laboratorëve jo funksionalë dhe rritjen e kapaciteteve për shërbime profesionale. Forcimi i laboratorëve me rol kërkimor dhe orientimi i tyre drejt bashkëpunimit me industrinë dhe projektet ndërkombëtare do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së kërkimit, përmirësimin e imazhit institucional dhe rritjen e impaktit të fakultetit në komunitetin shkencor dhe profesional.

Energjitë e rinovueshme dhe Makineritë bujqësore, duke garantuar që studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe eksperimentale të domosdoshme për formimin profesional. Laboratorët kërkimorë, përfshirë laboratorin e prodhimit të bimëve të arave dhe laboratorët fushorë, përforcojnë kapacitetin kërkimor të departamentit, duke mundësuar zhvillimin e temave të diplomës, projekteve shkencore dhe kërkimeve të avancuara.
Ndërkohë, pjesa më e madhe e laboratorëve është e orientuar drejt funksionit didaktik dhe kërkimor të brendshëm, me përjashtim të fushës eksperimentale tek FDE, e cila mund të ofrojë shërbime konkrete për palët e treta, përfshirë testimin shkencor të varieteteve të reja, mbështetjen e bizneseve të sektorit të BAM, ofrimin e protokolleve agronomike dhe trajnimeve për fermerët. Kjo i jep departamentit një rol të rëndësishëm në transferimin e njohurive drejt industrisë dhe komunitetit bujqësor.

Në përgjithësi mund të themi se Infrastruktura e FM së është e mirëstrukturuar dhe në zhvillim të vazhdueshëm, duke siguruar një ekuilibër të shkëlqyer midis mësimdhënies akademike, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj palëve të treta, me potencial të qartë për zgjerim të mëtejshëm të kapaciteteve kërkimore dhe bashkëpunimeve me sektorin bujqësor dhe agro-industrial.

## VI. STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

### VI.1 Perfshirja e studentëve në aktivitete shkencore

Në këtë sesion duhet të bëhet një analizë e përfshirjes së studentëve në mobilitet, në konferenca dhe në kërkim shkencor. Analiza duhet të bëhet e veçantë për studentët në doktoraturë.

**Tabela 6.1**: Pjesëmarrje e studentëvë në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mbeshtetja për lëvizshmërinë e tyre

| Nr | Fakulteti | Emërtimi i Programit të Studimit | Nr Student. Përfitues | Universiteti dhe Vendi Pritës | Semestri | Cikli i Studimit | Fushat e Studimit | Mbështetja financiare për lëvizshmërinë e tyre |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FBM | MSH_Shkencat Agronomike | Naxhisa Cuci | Faculty of Agriculture, Zagreb University | II | I | Bujqesi | 850 Euro/muaj |
| 2 | FBM | MSH_Shkencat Agronomike | Kevin Shehu | Warsaw University of Life Sciences | II | I | Bujqesi | 850 Euro/muaj |
| 3 | FBM | MSH_Shkencat Agronomike | Aroma Novi | Warsaw University of Life Sciences | II | I | Bujqesi | 850 Euro/muaj |
| 4 | FBM | MSH_Energjite e Rinovueshme | Fjorida Panxhi | Università Politecnica delle Marche | | | Inxhinieri | 850 Euro/muaj |
| 5 | FBM | Menaxhimi i Burimeve Natyrore | 2 | Universiteti i Sofia, Bullgari | II | II | Mjedis | Projekti Erasmus |
| 6 | FBM | Menaxhimi i Burimeve Natyrore | 1 | Training school at Cluj-Napoca, Romani from | June 2024 | PhD | Mjedis | Cost action PLANTMETALS, CA19116 |
| 7 | FBM | Menaxhimi i Burimeve Natyrore | 1 | Plantmetals trace metal metabolism in plants Conference, Ljubljana, Slovenia, | September 17th - 20th, 2024 | PhD | Mjedis | Cost action PLANTMETALS, CA19116 - Trace metal metabolism in plants |
| 8 | DMBN | Menaxhimi i Burimeve Natyrore | 2 | Universiteti i Sofia, Bullgari | Semestri dyte | MSc. | Mjedis | Projekti Erasmus. |
| 9 | DMBN | Mjedis | 1 | Training school at Cluj-Napoca, Romani from | June 2024 | PhD | Mjedis | Cost action PLANTMETALS, CA19116 - Trace metal metabolism in plants |
| 10 | DMBN | Mjedis | 1 | PLANTMETALS TRACE METAL METABOLISM IN PLANTS Conference, Ljubljana, Slovenia, | September 17th - 20th, 2024 | PhD | Mjedis | Cost action PLANTMETALS, CA19116 - Trace metal metabolism in plants |

**Tabela 6.2**: Pjesëmarrja e studentëvë në konferenca brenda dhe jashtë vendit

| Nr | Departament i/Fakulteti | Emërtimi i temës | Emër Mbiemër i studentit | Konferenca | | Periudha kohore | Programi i studimit | Studenti pjesemarres perfitues i burses per kategori te vecanta (Po/Jo) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Brenda vendit | Jashtë vendit | | | |
| 1 | DSHA/FBM | Is the acclimatization that wheat plants underwent during the life cycle, transferred to their seeds? Poster presentation | Rexhina Muca | Po | | 3-5 October 2025 | MSH_Shkenc. Agronomike | Jo |
| **2** | DMBN/FBM | | Teuta Bushi, Halilaj | 2 | 5 | 2024-2025 | Mjedis | Jo |
| **3** | DMBN/FBM | | Selma Myslihaka | 1 | 3 | 2024-2025 | Mjedis | Po |

## VI.2 Të dhëna mbi aktivitetin kërkimor të doktorantëve

**Tabela 6.3:** Të dhëna të përgjithshme mbi doktorantët

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në "Shkencat Bujqësore" …… | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Doktorantë me projekt kërkimor të financuar* | Doktorantë që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit | Doktorantë me bashkëudhëheqës të huaj | Përqindja e zbatimit të planit të referimeve* |
| **DSHA** | | | | | | |
| 1. | 2021-2022 | 5 | 5 | 1 | 1 | 80% |
| 2. | 2022-2023 | - | - | - | - | |
| 3. | 2024-2025 | 6 | | | | n/a. |
| **Totali** | | **11** | **5** | **1** | **1** | **80%** |
| **DMB** | | | | | | |
| 1 | 2021-2022 | 2 | 2 | | | 50% |
| 2 | 2022-2023 | 2 | | | | |
| 3 | 2024-2025 | 1 | | | | |
| **Totali** | | **5** | **2** | | | **50%** |
| **DSHZ** | | | | | | |
| 1 | 2021-2022 | 1 | 1 | | | 100 |
| 2 | 2022-2023 | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 2024-2025 | 1 | 1 | | | n/a |
| **Totali** | | **2** | **2** | | | |
| **DAP** | | | | | | |
| 1 | 2021-2022 | 3 | | | | 75 |
| 2 | 2022-2023 | 1 | | | | 100 |
| 3 | 2024-2025 | | | | | |
| **Totali** | | **4** | | | | |
| **DHAP** | | | | | | |
| 1 | 2021-2022 | 2 | 2 | 2 | | 45 |
| 2 | 2022-2023 | 1 | | | | |
| 3 | 2024-2025 | 1 | | | | |
| **Totali** | | **4** | | | | |
| **Programi "Shkencat Bujqësore "** | | | | | | |
| 1 | 2021-2022 | 13 | 11 | 3 | 1 | |
| 2 | 2022-2023 | 4 | | | | |
| 3 | 2024-2025 | 9 | 9 | | | |
| **Totali** | | **26** | **20** | | | |
| **Nr** | **Doktorantë të regjistruar në vitin akademik** | **Programi i Doktoraturës në "Shkencat Mjedisore"** | | | | |
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Doktorantë me projekt kërkimor të financuar*** | **Doktorantë që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit** | **Doktorantë me bashkëudhëheqës të huaj** | **Përqindja e zbatimit të planit të referimeve*** |
| **DMBN** | | | | | | |
| 1. | 2021-2022 | 10 | 6 | 7 | 5 | 73 |
| 2. | 2022-2023 | 7 | | 2 | - | 86 |
| 3. | 2024-2025 | 8 | 4 | - | - | n/a. |
| **Totali** | | **25** | **6** | **9** | **5** | |
| FBM | | | | | | |
| | 2021-2022- | 23 | 17 | 10 | 6 | |
| | 2022-2023 | 11 | | 2 | | |
| | 2024-2025 | 17 | 13 | | | |
| | **Totali** | **51** | **30** | **12** | **6** | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

* këtu nuk përfshihet vetëfinancimi

* nr. doktorantëve x nr. e referimeve sipas planit kundrejt nr. të referimeve faktike

**Tabela :** Aktiviteti botues i doktorantëve

| **Nr.** | **Doktorantë të regjistruar në vitin akademik:** | **Programi i Doktoraturës në Shkencat Bujqesore** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Artikuj shkencorë gjithsej** | **Artikuj shkencorë në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science** | **Referime/postera në aktivitete shkencore gjithsej** | **Referime/postera në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD, G20.** |
| | 2021-2022 | 13 | 31 | 14 | 42 | 12 |
| | 2022-2023 | 4 | | | 2 | |
| | 2024-2025 | 9 | | | | |
| **Totali Sh.Bujqesore** | | **26** | **31** | **14** | **42** | **12** |
| . | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në “Shkencat Mjedisore” | | | | |
| | | Doktorantë gjithsej | Artikuj shkencorë gjithsej | Artikuj shkencorë në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science | Referime/postera në aktivitete shkencore gjithsej | Referime/postera në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD, G20. |
| 1. | 2021-2022 | 10 | 21 | 14 | 41 | 15 |
| 2. | 2022-2023 | 7 | 4 | 2 | 14 | 7 |
| 3. | 2024-2025 | 8 | - | - | | |
| | **Totali** | **25** | **25** | **16** | **55** | ***22*** |
| **Totali FBM** | | **51** | **56** | **30** | **97** | ***34*** |

Të dhënat e paraqitura në tabelën 21, tregojnë një aktivitet të konsiderueshëm kërkimor e botues ndër doktorantët e programit, megjithëse me nivele të ndryshme të angazhimit ndërmjet tyre.
Në përgjithësi, shumica e doktorantëve kanë publikuar artikuj shkencorë gjatë periudhës së studimeve. Numri i artikujve të botuar varion nga 1 deri në 6, duke dëshmuar një përfshirje të mirë në procesin e publikimit, veçanërisht për ata që janë regjistruar më herët (viti 2022). Një pjesë e doktorantëve kanë arritur të publikojnë artikuj edhe në revista të indeksuara në Scopus ose Ëeb of Science, çka tregon për cilësi dhe standard ndërkombëtar të kërkimit.
Sa i përket referimeve dhe posterave shkencorë, pjesa më e madhe e doktorantëve kanë marrë pjesë në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke prezantuar rezultatet e kërkimeve të tyre. Në disa raste, është vënë re një përfshirje e drejtpërdrejtë në konferenca ndërkombëtare dhe rrjete kërkimore si COST, gjë që kontribuon në zgjerimin e bashkëpunimeve akademike dhe në rritjen e vizibilitetit shkencor të institucionit.
Ndër doktorantët e përfshirë, dallohen ata që kanë realizuar një numër më të madh publikimesh dhe prezantimesh, çka lidhet shpesh me vitin më të hershëm të regjistrimit dhe përvojën e akumuluar kërkimore. Nga ana tjetër, doktorantët e regjistruar më vone (viti 2024) ndodhen ende në fazat fillestare të zhvillimit të aktiviteteve botuese.
Në përgjithësi, mund të thuhet se aktiviteti shkencor i doktorantëve është dinamik dhe në rritje, duke reflektuar një përkushtim të vazhdueshëm ndaj kërkimit dhe publikimit në nivele kombëtare dhe

ndërkombëtare. Megjithatë, ekziston ende hapësirë për përmirësim në drejtim të rritjes së numrit të publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes më të gjerë në aktivitete kërkimore jashtë vendit.

**Tabela:** Pjesëmarrja në projekte e doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Shkencat Bujqeosre | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Numri doktorantë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare** | **Numri i doktorantëve të përfshirë në projekte kërkimore ndërkombëtare** | **Numri i doktorantëve që kanë realizuar mobilitete** | **Numri i doktorantëve që kanë realizuar kualifikime të tjera** |
| 1. | 2021-2022 | 13 | 7 | 1 | 2 | 1 |
| 2. | 2022-2023 | 4 | | | | |
| 3 | 2024-2025 | 9 | | | | |
| | **Totali** | **26** | **7** | **1** | **2** | ***1*** |
| **Nr.** | **Doktorantë të regjistruar në vitin akademik:** | **Programi i Doktoraturës në "Shkencat Mjedisore"** | | | | |
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Numri doktorantë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare** | **Numri i doktorantëve të përfshirë në projekte kërkimore ndërkombëtare** | **Numri i doktorantëve të që kanë realizuar mobilitete** | **Numri i doktorantëve që kanë realizuar kualifikime të tjera** |
| 1. | 2021-2022 | 10 | 3 | 6 | 8 | 7 |
| 2. | 2022-2023 | 7 | 2 | 2 | 1 | 2 |
| 3. | 2024-2025 | 8 | 4 | - | - | - |
| | **Totali** | **25** | **9** | **8** | **9** | ***9*** |
| | **Totali FBM** | **51** | **16** | **9** | **11** | **10** |

Të dhënat e paraqitura në tabelën 6.5 tregojnë se pjesëmarrja e doktorantëve në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare është ende në zhvillim dhe përqendrohet kryesisht tek disa individë që janë përfshirë në programe të financuara apo bashkëpunime ndërinstitucionale.

Në aspektin e projekteve kombëtare, vetëm një numër i kufizuar doktorantësh janë të përfshirë drejtpërdrejt, ndërsa shumica nuk kanë pasur ende mundësi pjesëmarrjeje në projekte të tilla. Kjo tregon për nevojën e rritjes së mbështetjes institucionale dhe përfshirjes aktive të studentëve të doktoraturës në kërkimet e brendshme kombëtare.

Në të kundërt, në fushën e projekteve ndërkombëtare, vërehet një nivel më i lartë angazhimi. Disa doktorantë janë përfshirë në projekte të rëndësishme bashkëpunimi ndërkombëtar, si programi APPEAR, projekti COST CA22158, si dhe iniciativa të tjera në bashkëpunim me Boston University dhe projekti READ AMR. Kjo pasqyron një tendencë pozitive drejt ndërkombëtarizimit të kërkimit dhe përfshirjes së universitetit në rrjete akademike globale.

Sa i përket mobiliteteve akademike, disa doktorantë kanë realizuar lëvizje kërkimore jashtë vendit, duke zhvilluar përvoja të vlefshme profesionale dhe shkencore. Megjithatë, një pjesë e tyre ende nuk ka marrë pjesë në mobilitete, çka sugjeron nevojën për zgjerimin e programeve të shkëmbimit dhe bashkëpunimeve ndëruniversitare.

Në lidhje me kualifikimet shtesë, një pjesë e doktorantëve kanë ndjekur trajnime apo programe plotësuese, ndërsa të tjerët nuk kanë raportuar përfshirje të tillë deri më tani.
Në përfundim, mund të thuhet se programi i doktoraturës ka bërë hapa të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit kërkimor, por mbetet e rëndësishme që të forcohet pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe të inkurajohet mobiliteti më i gjerë i doktorantëve, në mënyrë që të rritet cilësia dhe ndikimi i kërkimit shkencor.

**KONKLUZION:**

Nga të dhënat e analizuara rezulton se doktorantët e të dy programet e Doktoraturës “Shkencat Bujqësore “dhe Programit “ Shkencat Mjedisore” tregojnë një angazhim të qëndrueshëm në aktivitetin kërkimor dhe shkencor, me prirje në rritje drejt ndërkombëtarizimit dhe publikimit shkencor me cilësi. Megjithëse pjesëmarrja në projekte të financuara dhe bashkëudhëheqje me institucione të huaja mbetet ende e kufizuar, janë evidentuar shembuj të mirë të përfshirjes në programe ndërkombëtare dhe mobilitete kërkimore, që kontribuojnë në ngritjen e nivelit profesional të doktorantëve.

Në përgjithësi, programet po ecin drejt konsolidimit të cilësisë së kërkimit, por kërkon forcim të mbështetjes institucionale, rritje të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nxitje të mëtejshme të publikimeve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjeve shkencore jashtë vendit.

## 4.2 TË DHËNA MBI INFRASTRUKTURËN NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR, FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT (FEA)

FEA ka një kapacitet të kënaqshëm mjedisesh, salla, zyra, studio, laboratorë, të nevojshëm për realizimin e programit të studimit si edhe kryerjen e punës kërkimore. Stafi ka në përdorim 9 laboratorë dhe një hapësirë fizike në bibliotokën e fakultetit. Gjendja e fakultetit me infrastrukturë të përgjithshme si edhe atë laboratorike paraqitet në **mënyre përshkruese dhe tabelare.**

**Tabela:** Të dhëna mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.

| Njësia Kryesore | Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…) | Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor* | Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)** |
|---|---|---|---|
| Fakulteti FEA | 1. Laboratori I Kontabilitetit (227A) | Mësimdhënie | |
| | 2. Laboratori i Shkencave të Aplikuara (228A) | Mësimdhënie/ dhe Kërkimin Shkencor | |
| | 3. Laboratori i Informatikës (201 A) | Mësimdhënie/ dhe Kërkimin Shkencor | |
| | 4. Laboratori i Informatikës (206A) | Mësimdhënie | |
| | 5. Laboratori i Informatikes së Biznesit (207°) | Mësimdhënie | |
| | 6. Laboratori i Informatikës (110B) | Mësimdhënie | |
| | 7. Laboratori i Informatikës së Biznesit (111B) | Mësimdhënie | |
| | 8. Lab.Gjuhës Gjermane | Mësimdhënie | Trajnime dhe takime informuese |
| | 9. Laboratori Master Ekzekutiv (112 B) | Mësimdhënie/ dhe Kërkimin Shkencor | Po (Provimet APTIS) |
| | 10. Biblioteka Fizike-FEA (500 libra shqip, 2000 libra në gjuhë të huaj, 1700 materiale jo libra, periodikë të ndryshëm) | Kërkimi Shkencor | |

Theksojmë se të gjithë laboratorët janë të pajisura me facilitetet dhe logjistikën e përshtatshme për studentët e të gjitha kurseve dhe janë të përditësuara nga pikëpamja teknike dhe teknologjike. Të gjitha modulet aplikative janë të alokuara sipas cikleve të studimit/ programeve të studimit/ fakulteteve në mënyrë të harmonizuar përmes orarit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

# 6. STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

## VI.1 Perfshirja e studentëve në aktivitete shkencore

Në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare të cilat mbështesin mobilitetin e studentëve mund të themi se në krahasim me vitin 2023 – 2024 vit në të cilin ishin përfshirë 23 studentë në mobilitete ndërkombëtare në vitin 2024 – 2025 u përfshinë 1.7 herë më shumë student. Këtë vit u aktivizuan 40 studentë me një mbështetje financiare prej 155534 Euro, e gjitha e mbuluar nga programi Erasmus, (tabela më poshtë).

Problematika në lidhje me moblitetet mbeten cilësia dhe kapacitetet e studentëve për të marrë pjesë në këto projekte. Në aspektin organizativ ka një ndarje të procesit të përzgjedhjes së studentëve dhe këshillimit në lidhje me konsultimin e dokumentit të Learning Agreement e cila shpesh duhet të konsultohet për të patur një përputhje sa më të mirë midis moduleve.

**Tabela**: Pjesëmarrje e studentëvë në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mbeshtetja për lëvizshmërinë e tyre

| Nr | Fakulteti | Emërtimi i Programit të Studimit | Nr Studentëve Përfitues | Universiteti dhe Vendi Pritës | Semestri | Cikli i Studimit | Fushat e Studimit | Mbështetja financiare për lëvizshmërinë e tyre |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FEA | Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural | 1 | WSB University | 2 | Bachelor | Ekonomi | 4275 |
| 2 | FEA | Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural | 1 | Vytautas Magnus University | 2 | Bachelor | Ekonomi | 4035 |
| 3 | FEA | Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare) | 2 | University of National and World Economy | 2 | Msc | Ekonomi | 7430 |
| 4 | FEA | Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare) | 1 | University of Economics in Katowice | 2 | Msc | Ekonomi | 3955 |
| 5 | FEA | Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare) | 3 | University of Latvia | 2 | Msc | Ekonomi | 12825 |
| 6 | FEA | Ekonomiks i Aplikuar | 2 | University of Latvia | 1 | Bachelor | Ekonomi | 8550 |
| 7 | FEA | Finance Kontabilitet | 2 | Universita Politecnica delle Marche | 1 | Msc | Ekonomi | 8936 |
| 8 | FEA | Finance Kontabilitet | 1 | Warsaw University of Life Sciences | 1 | Msc | Ekonomi | 3075 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | FEA | Finance Kontabilitet | 3 | Universita degli Studi di Urbino Carlo Bo | 2 | Bachelor | Ekonomi | 13404 |
| 10 | FEA | Finance Kontabilitet | 1 | University of Latvia | 2 | Msc | Ekonomi | 4275 |
| 11 | FEA | Inormatike Biznesi | 1 | Instituto Politecnico de Viana do Castelo | 1 | Bachelor | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 5027 |
| 12 | FEA | Inormatike Biznesi | 1 | Universita di Milano Biocca | 1 | Bachelor | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 4468 |
| 13 | FEA | Inormatike Biznesi | 3 | Warsaw University of Life Sciences | 1 | Msc | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 9225 |
| 14 | FEA | Inormatike Biznesi | 1 | Universita di Milano Biocca | 1 | Bachelor | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 4468 |
| 15 | FEA | Inormatike Biznesi | 1 | Universita di Milano Biocca | 2 | Msc | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 4468 |
| 16 | FEA | Inormatike Biznesi | 1 | Universita Politecnica delle Marche | 2 | Bachelor | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 4468 |
| 17 | FEA | Marketingu I Ushqimit dhe Biznesi Digjital | 1 | Warsaw University of Life Sciences | 2 | Msc | Ekonomi | 3475 |
| 18 | FEA | Marketingu I Ushqimit dhe Biznesi Digjital | 6 | Universita Degli Studi di Viterbo | 1 | Msc | Ekonomi | 27150 |
| 19 | FEA | Menaxhim Abrobiznesi | 2 | University of Latvia | 1 | Bachelor | Ekonomi | 8550 |
| 20 | FEA | Menaxhim Abrobiznesi | 1 | Warsaw University of Life Sciences | 1 | Bachelor | Ekonomi | 3075 |
| 21 | FEA | Menaxhim Abrobiznesi | 1 | Warsaw University of Life Sciences | 2 | Bachelor | Ekonomi | 3475 |
| 22 | FEA | Menaxhimi i Turizmit Rural | 1 | Alanya Alaaddin Keykubat Universitesi | 2 | Bachelor | Ekonomi | 3475 |
| 23 | FEA | Ekonomi dhe Agrobiznes | 2 | University of Latvia | 2 | Phd | Ekonomi dhe Teknologji Informacioni | 3150 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | FEA | Ekonomi dhe Agrobiznes | 1 | University of Novi Sad | 2 | Phd | Ekonomi | 300 |
| Total | | | **40** | | | | | **155534** |

Në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve të cikleve bachelor apo master në konferenca qoftë brenda apo jashtë mund të themi se egziston përsëri një numër shumë i ulët i tyre. Këtë vit janë angazhuar vetëm 5 studentë nga departamenti Menaxhim i Turizmit Rural, Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural dhe departamenti Menaxhim Agrobiznesi. Problematika në lidhje me pjesëmarrjen në konferenca të studentëve përsëri mbetet cilësia dhe kapacitetet e studentëve për të marrë pjesë në këto aktivitete shkencore por edhe mungesa e financimit për të mbuluar tarifën e pjesëmarrjes në konferenca.

**Tabela**: Pjesëmarrja e studentëvë në konferenca brenda dhe jashtë vendit

| Nr | Departamenti/ Fakulteti | Emertimi I temes | Emer Mbiemer I studentit | Konferenca | | Periudha kohore | Programi I studimit | Studenti pjesemarres eshte perfitues I burses per kategori te vecanta (Po/Jo) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Brenda Vendit (qyteti)** | **Jashte vendit (qyteti/shteti)** | | | |
| 1 | FEA - DMTR | Agriculture in Albania: The social inclusion challenges of youth in rural and sustainable development” | Rubens Zelka | Tiranë | | 3-5 Nentor 2025 | Bachelor | JO |
| 2 | FEA - DMTR | Agriculture in Albania: The social inclusion challenges of youth in rural and sustainable development” | Bamir Koçiu | Tiranë | | 3-5 Nentor 2025 | Bachelor | JO |
| 3 | FEA - EPZHR | The figure of women in Albanian society | Emanulea Marku | | Turqi | 7-8 Mars 2025 | Bachelor | JO |
| 4 | FEA - EPZHR | The figure of women in Albanian society | Erviola Kastrati | | Turqi | 7-8 Mars 2025 | Bachelor | JO |
| 5 | FEA/DDA | Adoption of Online Food Platforms and Consumer Perceptions in Albania. | Klevisa Biraci | Tiranë | | Nentor 2025 | MSc Administrim Ndermarrje | JO |

**KONKLUZION:**

Gjatë vitit 2024 – 2025 në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare, të cilat mbështesin mobilitetin e studentëve mund të themi se u përfshinë pothuajse i njëjti numër studentësh si edhe një vit më parë. Në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve të cikleve bachelor apo master në konferenca qoftë brenda apo jashtë mund të themi se egziston një numër shumë i ulët i tyre.

## TË DHËNA MBI AKTIVITETIN KËRKIMOR TË DOKTORANTËVE

Programi i studimeve të doktoratës në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) ka për qëllim formimin e kërkuesve shkencorë të nivelit të lartë në fushën e Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Programi fokusohet në fushat Menaxhim Agrobiznesi, Politika të Zhvillimit Rural, Financë–Kontabilitet, Menaxhim i Turizmit Rural dhe Menaxhim i Informacionit, duke synuar zhvillimin e kompetencave të avancuara kërkimore, analitike dhe metodologjike të kandidatëve.

Aktualisht, në këtë cikël studimi janë të regjistruar në total 82 doktorantë. Prej tyre, 20 doktorantë të pranuar në vitin akademik 2021–2022, të pranuar në vitin akademik 2022–2023 janë 28 doktorantë ndërsa doktorantë të pranuar në vitin akademik 2024–2025 janë 34. Dekanati i FEA-së ka ndërmarrë një sërë hapash për unifikimin, monitorimin dhe ndjekjen e detyrave akademike dhe kërkimore të doktorantëve, duke siguruar përmbushjen e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës.

Departamentet përkatëse, në zbatim të kësaj rregulloreje, organizojnë në mënyrë periodike prezantimet vjetore të progresit të doktorantëve, të cilat zhvillohen në një format të hapur për komunitetin akademik dhe palët e interesuara. Në dhjetor 2024, 90 përqind e doktorantëve të regjistruar në vitin akademik 2021–2022 realizuan prezantimet, në lidhje me paraqitjen e rezultateve fillestare dhe diskutimin e tyre. Deri në Prill të 2025 rreth 70 % e doktoranteve kanë perfunduar edhe prezantimin e fundit në departamnt me rrezultatet dhe diskutimet përfundimtare.

Gjithashtu, ata dorëzuan Raportin e Progresit për vitin e tretë dhe plotësuan dosjet individuale me dokumentacionin e veprimtarisë botuese deri në atë fazë.

Aktualisht të gjithë doktorantët e regjistruar në vitin akademik 2022–2023 kanë kryer prezantimet e Metodologjisë, zonës së studimit, kampionimit etj, Ndërkohë, 68% e doktorantëve kanë përfunduar edhe prezantimin e tyre të parë, i cili përfshinte rishikimin sistematik të literaturës, kuadrin konceptual të studimit, një draft fillestar të metodologjisë së propozuar dhe planin e zhvillimit të kërkimit. Së shpejti doktorantët e sapo regjistruar do të bëjnë prezantimin e Metodologjisë.

Në lidhje me mobilitetin akademik, vetëm 2 doktorantë kanë kryer stazhe kërkimore jashtë vendit, duke përfaqësuar 4% të numrit total të doktorantëve (shih Tabelën më poshtë).

**Tabela :** Të dhëna të përgjithshme mbi doktorantët

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Ekonomi dhe Agrobiznes | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Doktorantë me projekt kërkimor të financuar* | Doktorantë që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit | Doktorantë me bashkëudhëheqës të huaj | Përqindja e zbatimit të planit të referimeve |
| 1 | 2021-2022 | 20 | 0 | 1 | 0 | 73% |
| 2 | 2022-2023 | 28 | 0 | 1 | 0 | 71% |
| 3 | 2024-2025 | 34 | 33 | 0 | 0 | n/a. |
| **Totali** | | **82** | **33** | **2** | **0** | |

Përsa i përket aktivitetit botues (Tabela e mëposhtme) të doktorantëve mund të themi se: doktorantët kanë botuar gjithsej 46 artikuj shkencorë, 76 përqind e të cilëve janë botime të kryera nga doktorantët e regjistruar në vitin 2021 – 2022. Botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science përbëjnë 56 përqind të artikujve. Referime janë kryer 67 gjithsej, 54 përqind e të cilëve janë realizuar nga doktorantët e regjistruar në vitin 2022– 2023. Referime apo postera të realizuara në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD apo G20 janë kryer 30 gjithsej, 63 përqind e të cilëve të realizuar nga doktorantët e regjistruar në vitin 2021 – 2022.

**Tabela :** Aktiviteti botues i doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Ekonomi dhe Agrobiznes | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Artikuj shkencorë gjithsej | Artikuj shkencorë në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science | Referime/postera në aktivitete shkencore gjithsej | Referime/postera në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD, G20. |
| 1. | 2021-2022 | 20 | 35 | 19 | 31 | 19 |
| 2. | 2022-2023 | 28 | 11 | 7 | 36 | 11 |
| **Totali** | | **48** | **46** | **26** | **67** | ***30*** |

Pjesëmarrja e doktorantëve në projekte mbetet e vogël. Vetëm 12 nga 48 doktorantë janë përfshirë në projekte. Njëmbëdhjetë doktorantë janë përfshirë në projekte kombëtare dhe 1 në projekt ndërkombëtar. Përsa i përket mobiliteteve 23 përqind e doktorantëve i kanë realizuar ato. Ndërsa në kualifikime të tjera vetëm 2 përqind e doktorantëve janë angazhuar.

**Tabela :** Pjesëmarrja në projekte e doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Ekonomi dhe Agrobiznes | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Numri doktorantë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare | Numri i doktorantëve të përfshirë në projekte kërkimore ndërkombëtare | Numri i doktorantëve të që kanë realizuar mobilitete | Numri i doktorantëve që kanë realizuar kualifikime të tjera |
| 1. | 2021-2022 | 20 | 6 | 0 | 6 | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | 2022-2023 | 28 | 5 | 1 | 5 | 1 |
| | **Totali** | **48** | **11** | **1** | **11** | ***1*** |

**KONKLUZION:**

Doktorantët e vitit 2021-2022 në total kanë kryer 73 përqind të planit të referimeve, ndërsa doktorantët e vitit 2022-2023 kanë kryer 71 përqind të planit të referimeve. Doktorantët që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit janë 4 përqind të totalit të doktorantëve. Përsa i përket aktivitetit botues të doktorantëve, 56 përqind e artikujve janë botuar në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science. Vetëm 12 nga 48 doktorantë janë përfshirë në projekte. Ndërsa 97 % e doktorantëve të regjistruar në vititn 2024-2025 do ta zhvillojnë doktoratën me një projekt kërkimor. Përsa i përket mobiliteteve, 23 përqind e doktorantëve janë angazhuar në ato.

## TË DHËNA MBI INFRASTRUKTURËN NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR

### FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT (FBU)

Pas transferimit në godinën e re të FBU-së në maj 2025, DTAU, DSHUB, DK dhe QKU kanë punuar intensivisht për organizimin dhe funksionalizimin e të gjithë laboratorëve mësimorë dhe kërkimorë-shkencorë. Stafët akademikë dhe ndihmës akademikë janë angazhuar në vendosjen, instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve ekzistuese, si dhe në sistemimin e ambienteve të reja sipas standardeve bashkëkohore laboratorike, me qëllim garantimin e kushteve optimale për mësimdhënien praktike dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.

Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore (**DTAU**) përdor laboratorët e mëposhtëm për realizimin e praktikave mësimore, studimeve në kuadër të diplomave dhe aktiviteteve kërkimore. Laboratorët e DTAU kanë mbështetur procesin mësimor në 12 module dhe kanë kontribuar në realizimin e 8 artikujve shkencorë në bashkëpunim me laboratorët kërkimorë të FBU.

1. **Laboratori i Fruta-Perimeve** – mbështet kryesisht mësimdhënien, duke mundësuar zhvillimin e moduleve praktike mbi përpunimin dhe konservimin e produkteve me bazë frutat dhe perimet.
2. **Laboratori i Vajit** – mbështet mësimdhënien, duke siguruar praktika mbi nxjerrjen, përpunimin dhe analizën e vajrave ushqimorë (të ullirit dhe vajrat vegjetalë).
3. **Laboratori i Vlerësimit Sensorial** – mbështet mësimdhënien, duke mundësuar testime sensoriale dhe vlerësimin e cilësisë së produkteve ushqimore nga studentët.
4. **Laboratori i Enologjisë dhe Pijeve Alkoolike** – mbështet mësimdhënien, duke ofruar praktika mbi prodhimin dhe analizën e verërave dhe pijëve alkoolike.
5. **Laboratori i Drithërave dhe Produkteve Konditore** – mbështet mësimdhënien, duke mundësuar zhvillimin e praktikave mbi përpunimin e drithërave dhe prodhimin e produkteve konditore.
6. **Linja e Përpunimit të Qumështit** – mbështet mësimdhënien, duke ofruar praktika profesionale dhe trainime mbi përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të tij.

Rekomandohet sigurimi i një shërbimi të qëndrueshëm të mirëmbajtjes dhe trajnimit për pajisjet dhe linjat laboratorike në DTAU, përmes angazhimit të teknikëve të specializuar. Rritja e kapaciteteve teknike do të garantonte funksionim më efikas dhe optimal të aparaturave, duke mundësuar gjithashtu vënien në përdorim të pajisjeve që aktualisht janë jashtë funksioni për shkak të mungesës së mirëmbajtjes profesionale.

DSHUB disponon pesë laboratorë, secili me rol specifik në mbështetjen e aktiviteteve akademike. Laboratorët e DSHUB kanë mbështetur mësimin në 9 module, ndërsa laboratorët kërkimorë të këtij departamenti kanë kontribuar në realizimin e 29 artikujve shkencorë.

1. **Laboratori Mësimor i Shkencave të Ushqimit dhe Nutricionit** – mbështet mësimdhënien. Laboratori përdoret për zhvillimin e moduleve praktike në grup për lëndët që lidhen me shkencat e ushqimit dhe nutricionit, duke mundësuar formimin teknik të studentëve.
2. **Laboratori Mësimor i Mikrobiologjisë dhe Bioteknologjisë Ushqimore** – mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Ky laborator përfshin infrastrukturë për analiza mikrobiologjike dhe procedura bazë të bioteknologjisë ushqimore. Gjithashtu, përdoret për zhvillimin e moduleve praktike në mikrobiologjinë e përgjithshme dhe ushqimore.
3. **Laboratori Mësimor i Biologjisë** – mbështet mësimdhënien. Ky laborator shërben për praktikat bazë të biologjisë, biodiversitetit biologjik, anatomisë dhe fiziologjisë.

4. **Laboratori Mësimor, Seksioni i Biologjisë Molekulare** – mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor; përdoret për analiza molekulare, përfshirë ekstraktimin e ADN-së, PCR dhe analiza të tjera gjenetike.
5. **Laboratori i Kërkimit të Ushqimit** – mbështet kërkimin shkencor. Statusi aktual: Laboratori nuk është ende plotësisht operacional. Gjatë këtij viti akademik parashikohet sistemimi dhe funksionalizimi i tij, në mënyrë që të vihet në shërbim të stafit akademik, doktorantëve dhe studentëve të programeve të Masterit Shkencor.

Departamenti i Kimisë (**DK**) disponon 4 laboratorë, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës së FBU dhe mbështesin si procesin e mësimdhënies, ashtu edhe kërkimin shkencor. Laboratori i Kimisë Analitike, Laboratori i Kimisë së Përgjithshme dhe Laboratori i Kimisë Organike dhe Produkteve Natyrore janë të orientuar kryesisht drejt mësimdhënies, duke mbështetur mësimin për 8 module, mundësuar realizimin e praktikave laboratorike dhe studimeve në kuadër të programeve të diplomave.

Laboratori Shkencor i Kimisë ofron mbështetje për aktivitetet kërkimore dhe praktike, dhe stafi ka qenë i angazhuar në realizimin e 7 artikujve shkencorë në bashkëpunim me laboratorët e tjerë të FBU. Një pjesë e aktiviteteve të DK është zhvilluar gjithashtu në ambjentet e QKU/FBU. Stafi i Departamentit të Kimisë është fitues i një projekti PIKSH për përmirësimin e infrastrukturës, i financuar nga AKKSHI, dhe aktualisht pritet ardhja dhe vendosja në funksion e këtyre pajisjeve, çka do të rrisë kapacitetin kërkimor dhe mësimor të laboratorëve. Për realizimin e trajnimeve në kuadër të projektit "PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 'PROFIT 0'" është shfrytëzuar edhe Linja e Qumështit pranë DTAU/FBU, ku janë bërë investime për klorinimin dhe zbutjen e ujit, si dhe janë përftuar pajisje portabile për matjen e pH-it të qumështit dhe kripësisë së djathit.

Rekomandohet që, paralelisht me vendosjen e pajisjeve të reja, të sigurohet një program asistence teknike dhe trajnim i specializuar për stafin, në mënyrë që të garantohet funksionimi i plotë dhe optimal i laboratorëve dhe të mundësohet përdorimi i të gjitha pajisjeve për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

**Qendra e Kërkimeve të Ushqimit (QKU)** përbëhet nga pesë laboratorë kërkimorë-shkencorë, si dhe nga ambjentet nëntokësore për ruajtjen dhe vjetërimin e verërave. Laboratorët e QKU kanë mbështetur procesin mësimor në 10 module, duke kontribuar gjithashtu në realizimin e 20 artikujve shkencorë. Secili laborator ka një rol të veçantë në mbështetjen e mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor:

1. **Laboratori i Analizave të Cilësisë së Ushqimit** – mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, duke ofruar analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të një game të gjerë produktesh ushqimore, përfshirë fruta-perimet, vajin e ullirit, verën, distilatet, birrën, ujin, mishin, bimët medicinale dhe nënproduktet e industrisë agro-ushqimore.
2. **Laboratori Fruta-Perimeve dhe i Vajit** – mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, duke kryer analiza të përbërjes kimike dhe të cilësisë së frutave, perimeve, vajit të ullirit dhe produkteve të tjera ushqimore.
3. **Laboratori Eksperimental i Verës dhe Distilateve Alkoolike** – kryen analiza fiziko-kimike, monitoron fermentimin dhe metabolitët e verërave dhe pijëve alkoolike, duke mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.
4. **Salla e Degustimit** – përdoret për testime sensoriale dhe vlerësimin e cilësisë së produkteve ushqimore (fruta-perime, vaj ulliri, vera, distilatet, mishi etj.), duke mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.

5. **Ambjentet nëntokësore për ruajtjen dhe vjetërimin e verërave** – të dedikuara kryesisht kërkimit shkencor, ofrojnë shërbime për ruajtjen dhe vjetërimin e verërave për projekte kërkimore dhe komerciale.

Gjatë periudhës 2024 –2025 në laboratorët e QKU-së janë analizuar rreth 819 kampione. Numri total i analizave të kryera në këta laboratorë është 4200 përcaktime. Çdo produkt është analizuar për tregues të caktuar komponentësh kimikë në varësi të studimeve të ndjekura. Analizat e kryera kanë patur kryesisht fokus kërkimor-shkencor për realizimin e temave të diplomave të nivelit Master Shkencor dhe Doktoraturë, gjithashtu edhe për realizimin e projekteve nga anëtarët e GMK-së së QKU si dhe nga anëtarët e GMK-ve të tjera të FBU.

**Tabela :** Të dhëna mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor

| Fakulteti/ Departamenti | Infrastruktura (Laboratore mësimore/kërkimore/ Salla e Degustimi/ Linja Përpunimi Ushqimi/ …) | Mbështet Mësimdhënien dhe/ose Kërkimin Shkencor* | Ofrimi i shërbimeve për të tretët** |
|---|---|---|---|
| FBU/DTAU | 1. Laboratori i Fruta-Perimeve | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 2. Laboratori i Vajit | Mësimdhënie (mbështet 1 modul) | NA |
| | 3. Laboratori i Vlerësimit Sensorial | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 4. Laboratori i Enologjisë dhe Pijeve Alkoolike | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 5. Laboratori i Drithërave dhe Produkteve Konditore | Mësimdhënie (mbështet 3 module) | NA |
| | 6. Linja e Përpunimit të Qumështit | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| FBU/DSHUB | 1. Laboratori Mësimor i Shkencave të Ushqimit dhe Nutricionit | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 2.Laboratori Mësimor i Mikrobiologjisë dhe Bioteknologjisë Ushqimore | Mësimdhënie (mbështet 3 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 3.Laboratori Mësimor i Biologjisë | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 4.Laboratori Mësimor – Seksioni i Biologjisë Molekulare | Mësimdhënien (mbështet 2 module) Kërkimin Shkencor | NA |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 5.Laboratori i Kërkimit të Ushqimit | Kërkimin Shkencor | NA |
| FBU/DK | 1.Laboratori Shkencor i Kimisë | Mësimdhënien (mbështet 2 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 2.Laboratori i Kimisë Analitike | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 3.Laboratori i Kimisë së Përgjithshme | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| | 4.Laboratori i Kimisë Organike dhe Produkteve Natyrore | Mësimdhënie (mbështet 2 module) | NA |
| FBU/QKU | 1.Laboratori i Analizave të Cilësisë së Ushqimit | Mësimdhënien (mbështet 3 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 2.Laboratori Fruta-Perimeve dhe i Vajit | Mësimdhënien (mbështet 2 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 3.Laboratori Eksperimental i Verës dhe Distilateve Alkoolike | Mësimdhënien (mbështet 3 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 4.Salla e Degustimit | Mësimdhënien (mbështet 2 module) Kërkimin Shkencor | NA |
| | 5.Ambjentet nëntokësore për ruajtjen dhe vjetërimin e verërave | Kërkimin Shkencor | NA |

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka përfituar fonde nga AKKSHI për ngritjen dhe modernizimin e laboratorëve kërkimorë shkencorë, duke investuar në pajisje laboratorike të avancuara. Një nga projektet kryesore është projekti PIKSH "**Ngritja e Laboratorit të Vajit të Ullirit dhe Vajrave Vegjetale**", me një vlerë prej 14.000.000 ALL, të koordinuar nga Prof. Dr. Kapllan Sulaj. Ky laborator është ngritur dhe pajisjet e reja pritet të jenë funksionale shumë shpejt për kërkim shkencor dhe për ofrimin e shërbimeve ndaj palëve të treta.

Projekti tjetër PIKSH është "**Forcimi i Infrastrukturës së Laboratorit të Kimisë"**, me një vlerë prej 12.463.000 ALL, i koordinuar nga Prof. Asoc. Dr. Ariola Devolli, FBU/DK. Ky projekt synon rikuperimin e komponimeve bioaktive nga mbetjet dhe nënproduktet e industrisë agro-ushqimore dhe

përdorimin e tyre si përbërës funksionalë, duke rritur kapacitetin kërkimor dhe aplikimin praktik të rezultateve.

**KONKLUZIONE:**

Infrastruktura laboratorike e FBU-së, pas transferimit në godinën e re, ofron kushte të përmirësuara për mësimdhënie praktike dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Laboratorët mbështesin programet akademike dhe sigurojnë kapacitete të rëndësishme kërkimore, duke ofruar mbështetje për realizimin e moduleve, praktikave profesionale, trajnimeve, temave të diplomave të nivelit Master dhe Doktoraturë, si dhe për projekte të ndryshme. Kjo ka kontribuar në publikimin e artikujve shkencorë dhe në përmirësimin e aftësive praktike të studentëve.

Funksionalizimi i laboratorëve dhe integrimi i pajisjeve të avancuara do të rrisë potencialin kërkimor, do të lehtësojë bashkëpunimin ndërdepartamental dhe do të mbështesë zhvillimin e projekteve shkencore inovative. Investimi në mirëmbajtje profesionale, ekspertizë nga teknikë të specializuar dhe trajnimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik do të rrisë funksionalitetin e pajisjeve dhe do të zgjerojë mundësitë për ofrimin e shërbimeve edhe ndaj palëve të treta.

# 6. STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

## 6.1 PËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË AKTIVITETE SHKENCORE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi pjesëmarrjen e studentëve të FBU-së në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mobilitete akademike për periudhën e raportimit 2024-2025. Në mobilitet kanë marrë pjesë studentë nga programet Bachelor dhe Master Shkencor, ku 8 studentë rezultojnë përfitues. Universitetet pritëse dhe vendet ku janë zhvilluar mobilitetet përfshijnë Turqinë, Italinë, Poloninë dhe Hungarinë. Po ashtu, paraqiten fushat përkatëse të studimit, të cilat fokusohen kryesisht në teknologjinë ushqimore, shkencat e ushqimit dhe inxhinierinë ushqimore. Mbështetja financiare e ofruar për studentët përfshin kryesisht bursat Erasmus+, mbështetje shtetërore për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, si dhe rrjeti CEEPUS.

**Tabela :** Pjesëmarrje e studentëvë në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mbështetja për lëvizshmërinë e tyr.e

| Nr. | Fakulteti | Emërtimi i Programit të Studimit | Nr Studentëve Përfitues | Universiteti dhe Vendi Pritës | Semestri | Cikli i Studimit | Fushat e Studimit | Mbështetja financiare për lëvizshmërinë e tyre |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FBU | MSc. Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit | 2 | Alanya Alaaddin Keykubat University, Turqi | 2 | 2 | Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit | Bursë financuar nga Erasmus+ 800 EUR/muaj + 275 EUR rimbursim udhëtimi |
| 2 | FBU | Bachelor, Inxhinieri Agroushqimore, Profili: Teknologji Agroushqimore | 4 | Universiteti Tuscia, Viterbo, Itali | 1 & 2 | 1 | Teknologji Ushqimore | Bursë financuar nga Erasmus+ dhe bursë nga qeveria shqiptare lidhur me ndërkombëtarizimin e programeve të studimit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | FBU | MSc. Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve | 1 | Universiteti i Shkencave të Jetës, Lublin, Poloni | 2 | 2 | Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore | Bursë financuar nga Erasmus+ |
| 4 | FBU | MSc Inxhinieri Agroushqimore | 1 | Hungarian University of Agriculture and Life Sciences, Buda Campus | 2 | 2 | Teknologji Ushqimore | CEEPUS, aplikim CPMNr: M-SI-1312-2526-209424 (3 muaj Hungari) |

Tabela më poshtë paraqet të dhënat mbi pjesëmarrjen e studentëve të FBU-së në konferenca shkencore. Gjatë vitit akademik 2024–2025, 7 studentë të ciklit të dytë të studimeve kanë marrë pjesë, prej të cilëve 5 nën udhëheqjen e stafit akademik të DK dhe 2 të udhëhequr nga stafi i QKU, duke përfshirë 4 pjesëmarrje brenda vendit dhe 4 jashtë vendit (8 prezantime gjithsej). Pjesëmarrja e tyre ka kontribuar në zhvillimin akademik dhe profesional, duke mbështetur realizimin e temave të diplomave, praktikave dhe projekteve kërkimore, si dhe publikimin e disa artikujve shkencorë. Të gjithë studentët pjesëmarrës nuk kanë qenë përfitues të bursave për kategori të veçanta.

**Tabela : Pjesëmarrja e studentëvë në konferenca brenda dhe jashtë vendit**

| Nr | Fakulteti/Departamenti | Emërtimi i Temës | Emër Mbiemër i Studentit | Konferenca | | Periudha kohore | Programi i studimit | Studenti pjesëmarrës është përfitues i bursës për kategori të veçanta (Po/Jo) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Brenda Vendit (qyteti) | Jashte vendit (qyteti/shteti) | | | |
| 1. | FBU/DK | The Role of the Water Quality Index in Assessing and Categorizing Drinking Water Quality. | Bilbil Omuri | First International Congress on Health Sciences Tiranë, Shqipëri | - | 05/2025 | Master Profesional "Analizat e Ushqimit" | Jo |
| 2. | FBU/DK | Recycling Waste Cooking Oil a Successful Way to Sustainability-Transformation of Waste Cooking Oil into Eco-friendly Product | Klodeta Nuko | - | II Conference FoodWaStop (March 2025), Gordoba, Spain | 2025 | Master Profesional "Analizat e Ushqimit" | Jo |
| 3. | FBU/DK | The design of a smart indicator and its application in food packaging system for food quality control | Vita Beshiri | ICOALS V, Tiranë, Shqipëri | - | 2025 | Master Profesional "Analizat e Ushqimit" | Jo |
| 4. | FBU/DK | Determination of salt concentration in white and whole bread. | Selva Nurçe | ICOALS V, Tiranë, Shqipëri | | 3-5/11/2025 | Master Profesional "Analizat e Ushqimit" | Jo |
| 5. | FBU/DK | Determination of Antioxidant Activity and Vitamin Content in Four Types of Nuts | Brunilda Mema | - | Budapest /Hungari | 28-30/05/2025 | Master Profesional "Analizat e Ushqimit" | Jo |
| 6. | FBU/QKU | Grape marc as a source of natural antioxidants: Potential for clean-label food ingredients. | Anisa Lipe | ICOALS V, Tiranë, Shqipëri | - | 3-5/11/ 2025 | MSc Ing. Agro-Ushqimore | Jo |
| 7. | FBU/QKU | Evaluation of some indicators of bottled drinking water in Albania and their comparison | Ylli Gramatiku | ICOALS V, Tiranë, Shqipëri | | 3-5/11/ 2025 | MSc Ing. Agro-Ushqimore | Jo |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | with the European Drinking Water Directive | | | | | | |
| 8. | FBU/QKU | Fasting & its impact on microbiota, metabolism & wellbeing: a physiological&nutrition approach | Ylli Gramatiku | | VII. International Conference on Agricultural, Biological and Life Science Edirne, Turkey | 07-10/09/2025 | MSc Ing. Agro-Ushqimore | Jo |

## 6.2 TË DHËNA MBI AKTIVITETIN KËRKIMOR TË DOKTORANTËVE.

### 6.2.1 Të dhëna të përgjithshme mbi doktorantët

Tabela 6.3 paraqet të dhënat mbi doktorantët e regjistruar në Programin e Doktoraturës gjatë viteve akademike 2021–2022, 2022–2023 dhe 2024–2025. Në total, programi i doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" ka 13 doktorantë, prej të cilëve 6 janë regjistruar në vitin akademik 2021–2022 të përfshirë ose jo në projekte kërkimore ose me mbështeten nga institucionet partnere (përfshirë Institutin e Shëndetit Publik dhe kontratën e shërbimit me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit “Vlerësimi mikrobiologjik i ujërave larëse”). 6 doktorantë kanë kryer stazhe kërkimore jashtë vendit, ndërsa zbatimi i planit të referimeve ka qenë 100%. Gjatë vitit akademik 2022–2023 janë regjistruar 7 doktorantë, pa projekte të financuara apo mobilitete kërkimore, por me zbatim 100% të planit të referimeve.

Tabela : Të dhëna të përgjithshme mbi doktorantët

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Doktorantë me projekt kërkimor të financuar* | Doktorantë që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit | Doktorantë me bashkëudhëheqës të huaj | Përqindja e zbatimit të planit të referimeve* |
| 1. | 2021-2022 | 6 | 6 | 6 | 0 | 100% |
| 2. | 2022-2023 | 7 | 0 | 0 | 0 | 100% |
| **Totali** | | **13** | **6** | **6** | **0** | **100%** |

### 6.2.2 Aktiviteti botues i doktorantëve

Doktorantët e regjistruar në Programin e Doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" kanë pasur një aktivitet të dukshëm botues dhe pjesëmarrjeje në aktivitete shkencore. Në total, 13 doktorantë kanë kontribuar në publikimin e 26 artikujve shkencorë, prej të cilëve 8 në revista të indeksuara në Scopus ose Web of Science. Ata kanë marrë pjesë gjithashtu në 33 referime ose postera në aktivitete shkencore, përfshirë 14 në vende të Bashkimit Evropian, OECD dhe G20. Ky aktivitet tregon angazhimin aktiv të doktorantëve në kërkimin shkencor, publikimin e rezultateve dhe integrimin e tyre në rrjetet ndërkombëtare të shkencës.

**Tabela 6.4:** Aktiviteti botues i doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Artikuj shkencorë gjithsej | Artikuj shkencorë në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science | Referime/postera në aktivitete shkencore gjithsej | Referime/postera në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD, G20. |
| 1 | 2021-2022 | 6 | 18 | 6 | 15 | 7 |
| 2 | 2022-2023 | 7 | 8 | 2 | 18 | 7 |
| | **Totali** | **13** | **26** | **8** | **33** | **14** |

### 6.2.3 Pjesëmarrja në projekte e doktorantëve

Doktorantët e Programit të Doktoraturës në "*Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore*" kanë pasur angazhime të ndryshme në projekte kërkimore. Në total, 13 doktorantë janë regjistruar, prej të cilëve 5 kanë qenë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare dhe 3 në projekte ndërkombëtare, ndërsa 3 doktorantë kanë realizuar mobilitete kërkimore jashtë vendit. Nuk ka raportime për doktorantë që kanë kryer kualifikime të tjera gjatë këtyre viteve. Ky angazhim tregon pjesëmarrjen aktive të doktorantëve në aktivitetet kërkimore dhe bashkëpunimin me projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Tabela : Pjesëmarrja në projekte e doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Numri doktorantë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare | Numri i doktorantëve të përfshirë në projekte kërkimore ndërkombëtare | Numri i doktorantëve të që kanë realizuar mobilitete | Numri i doktorantëve që kanë realizuar kualifikime të tjera |
| 1 | 2021-2022 | 6 | 5 | 3 | 3 | 0 |
| 2 | 2022-2023 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali** | **13** | **5** | **3** | **3** | **0** |

**KONKLUZIONE:**
Doktorantët e Programit të Doktoraturës në "Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore" kanë pasur një aktivitet të dukshëm kërkimor dhe botues. Në total, 13 doktorantë janë regjistruar gjatë viteve akademike 2021–2022 dhe 2022–2023, duke kontribuar në 26 artikuj shkencorë, përfshirë 8 në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science, dhe në 33 referime ose postera në aktivitete shkencore, përfshirë 14 në vende të BE, OECD dhe G20. Angazhimi i doktorantëve përfshin gjithashtu pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mobilitete kërkimore jashtë vendit. Ky aktivitet tregon përfshirjen aktive të studentëve dhe doktorantëve në

kërkimin shkencor, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe akademike, si dhe integrimin e tyre në rrjetet ndërkombëtare të shkencës, duke kontribuar në publikime, projekte dhe zhvillimin e aftësive praktike.

Studentët dhe doktorantët e FBU-së përbëjnë një pjesë integrale të kërkimit shkencor dhe zhvillimit akademik në institucion. Pjesëmarrja e tyre në projekte kërkimore dhe aktivitete shkencore ka kontribuar në zhvillimin e aftësive analitike, kritike dhe praktike, duke krijuar një mjedis mbështetës për shpërndarjen e njohurive dhe përgatitjen e tyre për sfidat e shoqërisë dhe tregut të punës.

Megjithatë, pjesëmarrja e doktorantëve në projekte kërkimore kombëtare ka qenë e kufizuar, nuk ka pasur përfshirje në projekte ndërkombëtare, si dhe nuk janë realizuar mobilitete ose kualifikime shtesë. Kjo evidenton nevojën për të forcuar mundësitë e angazhimit të doktorantëve në projekte të financuara, shkëmbime akademike dhe programe ndërkombëtare të formimit shkencor. Rekomandohet që në vitet e ardhshme të intensifikohet mbështetja dhe përfshirja e doktorantëve në projekte kërkimore, mobilitete ndërkombëtare dhe mundësi të avancuara formimi, duke maksimizuar potencialin e tyre akademik dhe kërkimor.

## TË DHËNA MBI INFRASTRUKTURËN NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR.

## FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (FMV).

Infrastruktura laboratorike dhe klinike e Fakultetit përbën një aset të rëndësishëm që mbështet mësimdhënien, praktikën profesionale dhe kërkimin shkencor, por analiza e përgjithshme tregon se, për të garantuar rritje të qëndrueshme dhe për të përmbushur standardet bashkëkohore të arsimit dhe kërkimit, nevojiten investime të synuara në përmirësimin e saj.

Informacioni mbi infrastrukturën paraqitet në mënyre përshkruese dhe tabelare (Tabela 5.1) mbi llojet e laboratorëve, rolin e tyre dhe funksioni apo shërbimin që ato ofrojnë.

**Tabela 5.1:** Të dhëna mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.

| Fakulteti | Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…) | Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor* | Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)** |
|---|---|---|---|
| DLMF | Laboratori i anatomisë | 4/7 | - |
| | Laboratori i histologjisë | 2 | - |
| | Laboratori i biokimisë | 2/2 | - |
| | Laboratori i fiziologjisë | 2/2 | - |
| DLPK | Laboratori i Diagnozës | 6 | Pronarët e kafshëve, klinika veterinare |
| | Laboratori i Imazherisë | 1 | Pronarët e kafshëve, klinika veterinare |
| | Laboratori i Patologjisë | 2 | Pronarët e kafshëve, klinika veterinare |
| | Laboratori i Farmakologjisë | 2/2 | - |
| | Laboratori i Sigurisë Publike | 10 | Pronarët e kafshëve, klinikat veterinare, operator të përpunimit të produkteve ushqimore, fermerë, NGO |
| DSHPV | Laboratori i sëmundjeve infektive të kafshëve | 2/1 | Pronarët e kafshëve, klinikat veterinare, operator të përpunimit të produkteve ushqimore, fermerë, NGO |
| | Laboratori i Kontrollit të Ushqimeve me Origjinë Shtazore | 3/2 | Operator të përpunimit të produkteve ushqimore, fermerë, NGO |
| | Laboratori i Higjienës Veterinare | 2 | - |
| | Laboratori i Mikrobiologjisë Veterinare | 2 | Klientët e kafshëve, fermerë, NGO |
| | Laboratori i Sëmundjeve të Kafshëve të Egra dhe Bletës | 2/2 | Bletërritës, NGO |
| DLK | Klinika e Kafsheve të shoqërimit | 2/2 | Pronarët e kafshëve të shoqërimit |

Edhe pse shumë nga laboratorët aktualë funksionojnë mirë për nevojat bazë akademike, hapësirat e specializuara dhe teknologjitë moderne kërkojnë një vëmendje të veçantë. Praktikat ndërkombëtare sugjerojnë që institucionet e profilit veterinar dhe të shëndetit publik duhet të posedojnë ambiente të certifikuara sipas standardeve të biosigurisë, sidomos për punën me patogjenë me risk të lartë, ku

ndërtimi i një laboratori BSL-3 do t'i mundësonte Fakultetit të operojë në një nivel më të avancuar diagnostik, kërkimor dhe shërbimi ndaj institucioneve publike e private.

Në të njëjtën linjë, aparatura kërkimore dhe diagnostike ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm me instrumente të gjeneratës së fundit. Shumë prej pajisjeve aktuale, ndonëse funksionale, nuk përputhen më plotësisht me ritmin e zhvillimit teknologjik dhe kërkesat e tregut shkencor. Investimet në pajisje moderne, si spektrometri masiv të kategorisë së lartë, sekuencues genomik të gjeneratës së re, aparatura të avancuara për analizë kimike dhe biologjike, si dhe sisteme automatizimi, do të rrisnin shumë kapacitetin konkurrues të Fakultetit, duke i mundësuar zhvillimin e analizave të sakta, të shpejta dhe me ndjeshmëri të lartë. Kjo do të ulte varësinë nga laboratorë të jashtëm dhe do të forconte rolin e institucionit si qendër referente shkencore dhe profesionale në vend.

Një tjetër element thelbësor është sigurimi i kontratave të qëndrueshme të mirëmbajtjes për aparaturat ekzistuese dhe ato që do të blihen. Pa mirëmbajtje të rregullt dhe kalibrim teknik, edhe pajisjet më të shtrenjta humbin efikasitetin, çka jo vetëm rrezikon cilësinë e analizave, por edhe dëmton besueshmërinë e shërbimeve të ofruara ndaj palëve të treta. Kontratat e mirëmbajtjes garanton që laboratorët të funksionojnë sipas standardeve ndërkombëtare dhe të përmbushin kërkesat e akreditimit, duke siguruar që analizat e avancuara, si ato mikrobiologjike, toksikologjike, molekulare dhe të sigurisë ushqimore, të jenë të replikueshme, të verifikueshme dhe të vlefshme në arenën profesionale dhe shkencore.

Investimet në infrastrukturë, pajisje dhe mirëmbajtje do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë edhe në marrëdhënien e Fakultetit me biznesin dhe komunitetin. Duke zotëruar laboratorë të standardit të lartë dhe aparaturë moderne, institucioni do të mund të ofrojë një gamë të zgjeruar shërbimesh diagnostike, analitike dhe konsulence, duke adresuar problematika reale të sektorëve të prodhimit ushqimor, fermave, industrisë veterinare dhe shëndetit publik. Kjo jo vetëm do të rriste të ardhurat e Fakultetit përmes shërbimeve për të tretët, por edhe do të forconte ndikimin e tij në zhvillimin e politikave dhe praktikave të qëndrueshme në vend. Në përfundim, për të përqendruar kapacitetet dhe për të maksimizuar impaktin akademik, kërkimor dhe profesional të Fakultetit, rekomandohet që investimet e ardhshme të orientohen drejt përmirësimit të infrastrukturës fizike, ndërtimit të ambienteve me standarde të larta biosigurie, pajisjes me instrumente moderne të viteve të fundit dhe sigurimit të kontratave profesionale të mirëmbajtjes. Vetëm përmes këtyre hapave, Fakulteti do të mund të kryejë analiza të nivelit të avancuar, të zgjidhë problematika të biznesit dhe industrisë dhe të ofrojë shërbime e konsulenca që korrespondojnë me standardet europiane dhe ndërkombëtare.

**KONKLUZION:**

Gjatë katër viteve të fundit, infrastruktura mësimdhënëse dhe kërkimore në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare ka njohur një zhvillim të qëndrueshëm, i cili është reflektuar në ndërtimin e godinës së re të Anatomisë, ngritjen e Klinikës së re të Kafshëve të Shoqërimit, vendosjen e një klinike ambulatore për kafshët e mëdha pranë FDE-së dhe modernizimin e laboratorit të farmakologjisë dhe toksikologjisë, krahas një sërë ndërhyrjesh të tjera të rëndësishme mirëmbajtëse. Ky progres është rezultat i një mbështetjeje të vazhdueshme nga autoritetet drejtuese të universitetit, të cilat kanë orientuar investimet drejt përmirësimit të kushteve të mësimdhënies, praktikës profesionale dhe marrjes së kompetencave praktike të studentëve. Megjithatë, dinamika aktuale e zhvillimit të shkencave veterinare dhe kërkesat e tregut kërkojnë që ky ritëm investimesh të thellohet. Disa laboratorë ende kanë nevojë për rinovim strukturor dhe modernizim të mobilimit, si dhe për sigurimin e kushteve të avancuara të biosigurisë që kërkohen nga standardet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ndërtimi i hapësirave të specializuara, si laboratorë me biosiguri të nivelit të lartë (p.sh., BSL-3), do

t'i mundësonte FMV-së të zhvillonte kërkim të avancuar mbi patogjenët me risk të lartë dhe të ofronte një gamë më të gjerë analizash në fushën e shëndetit publik, One Health dhe sigurisë ushqimore.

Klinika Veterinare, e cila tashmë ka një buxhet të dedikuar për pajisje të teknologjisë së fundit, përfaqëson një pikë kyçe në përmirësimin e shërbimit të kujdesit ndaj pacientëve. Përveç funksionit mësimor dhe ofrimit të shërbimeve klinike, klinika luan një rol të rëndësishëm edhe në kërkimin shkencor. Ajo ofron një ambient të kontrolluar ku mund të zhvillohen studime mbi sëmundjet, trajtimin dhe menaxhimin e kafshëve të shoqërimit, si dhe mbi zhvillimin e metodave diagnostikuese dhe terapeutike të reja. Përvoja e drejtpërdrejtë me rastet klinike jo vetëm që forcon aftësitë praktike të studentëve, por gjithashtu mund të kontribuojë në prodhimin e të dhënave shkencore të vlefshme, që mund të publikohen në revista ndërkombëtare dhe të përdoren për avancimin e njohurive veterinare. Në këtë mënyrë, klinika bëhet një pikë lidhëse midis mësimit praktik, shërbimit ndaj komunitetit dhe aktivitetit shkencor, duke ndihmuar në zhvillimin e një Fakulteti të Mjekësisë Veterinare modern dhe konkurrues.

Përdorimi i aparaturave moderne do të sillte përfitime të rëndësishme, jo vetëm në ofrimin e shërbimeve klinike të avancuara, por edhe në rritjen e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore. Instalimi i pajisjeve të reja në hapësirat e Klinikës së re Veterinare, krijuar në përputhje me infrastrukturën e modernizuar të Fakultetit, do të forconte cilësinë e formimit profesional dhe do të kontribuonte në rritjen e kapaciteteve akademike brenda vizionit të "Ndërkombëtarizimit të Arsimit të Lartë", në përputhje me strategjinë UBT-BOKU 2030.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe modernizimit të Laboratorit të Imazherisë, proces i cili është përmbyllur me sukses gjatë këtij viti. Ndërhyrjet kanë përfshirë përmirësimin e plotë të dhomës së ekspozimit, instalimin e portave mbrojtëse kundër rrezatimit, vendosjen e xhamit të plumbit dhe implementimin e sistemit të aspirimit, si dhe veshjen me fletë plumbi të të gjithë ambientit deri në një lartësi prej të paktën 2.5 metrash. Këto masa tashmë të realizuara sigurojnë funksionimin e laboratorit në mënyrë të sigurt dhe të certifikuar, duke e përputhur atë me të gjitha protokollet bashkëkohore të mbrojtjes radiologjike dhe duke e bërë të gatshëm për përdorim optimal si në shërbimin klinik, ashtu edhe në procesin mësimor.

Në tërësi, këto investime do të krijonin një infrastrukturë klinike dhe laboratorike që jo vetëm përmbush nevojat aktuale mësimore dhe kërkimore, por edhe rrit kapacitetin për të ofruar shërbime të specializuara për palë të treta, përfshirë pronarët e kafshëve, operatorët e industrisë ushqimore dhe aktorët e sektorit agro-ushqimor. Për më tepër, pajisjet moderne dhe mbështetja teknike për mirëmbajtjen e tyre do të mundësonin kryerjen e analizave të avancuara, zgjidhjen e problematikave të biznesit dhe ofrimin e konsulencave profesionale me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë dhe shëndetin publik.

Për studentët dhe stafin akademik, këto ndërhyrje do të reflektohen në rritjen e mundësive të kërkimit shkencor, rritjen e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare dhe aftësimin e tyre praktik përmes përfshirjes në shërbime diagnostike dhe laboratorike që kryhen për palë të treta. Në këtë mënyrë, FMV jo vetëm garanton cilësi më të lartë akademike, por ndërton një platformë të qëndrueshme që rrit impaktin shkencor dhe profesional të institucionit për vitet në vijim.

## VI) STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

### VI.1 Përfshirja e studentëve në aktivitete shkencore

Krahasuar me vitin pararendës, vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të studentëve që kanë realizuar praktika profesionale jashtë vendit nga 15 studentë në vitin 2024 në vetëm 6 studentë

në vitin aktual. Megjithatë, ky ndryshim duhet parë në kontekstin se fluktuacioni në pjesëmarrjen në thirrjet Erasmus është një fenomen normal, pasi numri i aplikuesve dhe përfituesve ndikohet nga faktorë të ndryshëm si interesat individuale, dinamika akademike, mundësitë financiare dhe prioritetet institucionale. Për pasojë, kjo ulje mund të konsiderohet një devijim i zakonshëm, ndërsa pritet që në vitin dhe vitet e ardhshme pjesëmarrja të rritet.

| Nr. | Fakulteti | Emërtimi Programit të Studimit | Nr Student. Përfitues | Universiteti dhe Vendi Pritës | Semestri | Cikli i Studimit | Fushat e Studimit | Mbështetja financiare për lëvizshmërinë e tyre |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FMV | Mjekësi Veterinare | Jurgena Matuka | Cordoba-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2025 | 2 | Master | Veterinari |
| 2 | FMV | Mjekësi Veterinare | Vilson Zelaj | Camerino-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2025 | 2 | Master | Veterinari |
| 3 | FMV | Mjekësi Veterinare | Nertila Dini | Dublin-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2024 | 2 | Master | Veterinari |
| 4 | FMV | Mjekësi Veterinare | Belinda Dhami | Dublin-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2025 | 2 | Master | Veterinari |
| 5 | FMV | Mjekësi Veterinare | Gjergji Papa | Thessaly-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2024 | 2 | Master | Veterinari |
| 6 | FMV | Mjekësi Veterinare | Eremir Sukthi | Thessaly-Fakulteti i Veterinarise | 2024-2024 | 2 | Master | Veterinari |

Nga tabela 6.1, vihet re se të gjithë studentët përfitues i përkasin Fakultetit të Mjekësisë Veterinare dhe programit të studimit "Mjekësi Veterinare" në ciklin Master. Universitetet pritëse Cordoba, Camerino, Dublin dhe Thessaly janë institucione të njohura të Bashkimit Europian në fushën veterinare, duke dëshmuar se cilësia e partneriteteve ndërkombëtare mbetet e lartë, ndonëse shtrirja ndër-fakultetare e mobiliteteve është ende e kufizuar. Procesi i përzgjedhjes së studentëve është kryer sipas procedurave standarde, përmes publikimit të thirrjes Erasmus në faqen zyrtare të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe realizimit të intervistave për përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë në bashkëpunim me anëtarë të zyrës Erasmus në UBT, çka tregon se mekanizmi formal i përzgjedhjes funksionon siç duhet.

Në këtë kontekst, zhvillimi i kurrikulës së re dhe hapja e mundshme e programeve në gjuhën angleze paraqiten si masa strategjike që pritet të rrisin më tej shanset për masivizimin e mobiliteteve në të dy drejtimet, si nga FMV – UBT drejt universiteteve partnere, ashtu edhe të studentëve të huaj drejt UBT-së. Rishikimi i programeve të studimit në përputhje me standardet e arsimit të lartë europian, integrimi i moduleve me karakter ndërkombëtar dhe rritja e fleksibilitetit të strukturës mësimore e bëjnë ofertën akademike më tërheqëse për bashkëpunim dhe mobilitet. Nga ana tjetër, ofrimi i programeve në gjuhën angleze rrit dukshëm aksesin e studentëve të huaj, përmirëson imazhin dhe konkurrueshmërinë e UBT-së në rrjetin europian të universiteteve, si dhe krijon kushtet për klasa të përziera ndërkombëtare me përfitime të shumëfishta akademike dhe kulturore.

Në përfundim, edhe pse këtë vit është vërejtur një ulje numerike e studentëve pjesëmarrës, kjo situatë shihet si pjesë e një fluktuacioni të zakonshëm. Duke marrë në konsideratë cilësinë e lartë të partneriteteve ekzistuese, funksionimin korrekt të procedurave të përzgjedhjes, si dhe perspektivat e hapura nga kurrikula e re dhe programet në gjuhën angleze, krijohet një bazë reale për rritjen e mëtejshme të mobiliteteve Erasmus dhe forcimin e dimensionit ndërkombëtar të UBT-së në vitet në vijim.

Pjesëmarrja e studentëve në projekte dhe konferenca shkencore është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Konferencat shkencore ofrojnë mundësi për të dëgjuar ekspertë të fushës duke ndihmuar studentët të fitojnë përvoja të reja, të cilat janë të dobishme për karrierën e tyre të ardhshme. Të dhënat e tabelës 6.2 tregojnë se studentët e Mjekësisë Veterinare janë të përfshirë në mënyrë aktive në kërkimin shkencor, si në publikime ashtu edhe në prezantime në konferenca brenda vendit, me tema që trajtojnë çështje aktuale dhe me rëndësi në mjekësinë veterinare. Disa prej tyre kanë bashkautorësi në një artikull të botuar në një revistë ndërkombëtare (*European Academic Research*), ndërsa të tjerë kanë prezantuar punimet e tyre në konferenca shkencore kombëtare si ICOALS- 5 dhe Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Mjekësisë Veterinare në Durrës. Megjithatë, vihet re se asnjë prej studentëve pjesëmarrës nuk është përfitues i bursave për kategori të veçanta, çka tregon se, ndonëse niveli i angazhimit kërkimor është premtues, nevojitet ende më shumë mbështetje financiare dhe stimuj për të zgjeruar përfshirjen dhe veçanërisht prezantimet në aktivitete shkencore jashtë vendit.

**Tabela 6.2**: Pjesëmarrja e studentëvë në konferenca brenda dhe jashtë vendit

| Nr. | Departamenti/ Fakulteti | Emërtimi i temës | Emër Mbiemër i studentit | Konferenca/ Brenda vendit/Jashtë vendit | Periudha kohore | Progr. Studim. | Studenti pjesemarr. përfitues i bursës për kategori të vecanta (Po/Jo) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | Mjekësi Veterin. | A Flow Cytometric Investigation of Neutrophiles Percentages in the Rabbit Peripheral Blood during an Induced Infection. | **Liljana Tairllari, Erinda Dautaj, Belinda Dhami, Nertila Dini** | Rumani | | Mjekësi Veter. | Jo |
| 2. | Mjekësi Veterin. | Serological evidence of Caprine Arthritis Encephalitis Virus (CAEV) in goats from the Elbasan region, Albania. | Vilson Zela | 5th Internat. Conference on Agriculture and Life Sciences of Albania (ICOALS 5), Tirana, Albania | | Mjekësi Veter. | Jo |
| 3. | Mjekësi Veterin. | Seasonal isolation dynamics of Shiga Toxin-Producing Escherichia coli (STEC) from recto-anal mucosa of slaughtered sheep using selective media. | **Nertila Dini, Belinda Dhami** | 5th Internat.Conference on Agric. and Life Sciences (ICOALS 5), Tirana, Albania | | Mjekësi Veter. | Jo |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | Mjekësi Veterin. | Bacteriological detection of Shiga Toxin-Producing Escherichia coli (STEC) in sheep fecal samples using TBX and SMAC. | **Belinda Dhami, Nertila Dini** | 1st International Congress of Albania Veterinary Medicine, Durres, Albania. | | Mjekësi Veter. | Jo |

## VI.2 Të dhëna mbi aktivitetin kërkimor të doktorantëve

Aktualisht, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare janë gjithsej 18 kandidatë për doktoraturë, nga të cilët 8 janë regjistruar në vitin akademik 2021–2022, 3 në vitin akademik 2022–2023 dhe 7 në vitin akademik 2024–2025. Ecuria e këtij procesi konsiderohet normale dhe gjatë periudhës nëntor 2025 – dhjetor 2025, në FMV janë zhvilluar prezantime në kuadër të punës shkencore të doktorantëve.

Të gjithë doktorantët e regjistruar në vitin akademik 2024–2025 ndodhen aktualisht në fazën e hartimit të metodikave kërkimore dhe referimit të tyre në departamentet përkatëse. Në tabelat e mëposhtme paraqitet një informacion i detajuar mbi ecurinë akademike dhe shkencore të secilit prej doktorantëve.

**Tabela :** Të dhëna të përgjithshme mbi doktorantët

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Doktorantë me projekt kërkimor të financuar*** | **Doktorantë që kanë zhvilluar stazhe kërkimore jashtë vendit** | **Doktorantë me bashkëudhëheqës të huaj** | **Përqindja e zbatimit të planit të referimeve*** |
| 1. | 2021-2022 | 8 | 3 | 2 | 2 | 75 % |
| 2. | 2022-2023 | 3 | 2 | 1 | - | 100 % |
| 3. | 2024-2025 | 7 | 2 | - | - | - |
| | **Totali** | **18** | **7** | **3** | **2** | |

Të dhënat e paraqitura tregojnë se Programi i Doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare po konsolidohet gradualisht, si në aspektin numerik ashtu edhe në atë cilësor. Nga gjithsej 18 doktorantë të regjistruar në periudhën 2021–2025, një pjesë e konsiderueshme (veçanërisht nga vitet 2021–2022 dhe 2022–2023) janë të përfshirë në projekte kërkimore të financuara, kanë realizuar stazhe kërkimore jashtë vendit dhe në disa raste kanë bashkëudhëheqës të huaj, çka dëshmon për një orientim të qartë drejt ndërkombëtarizimit dhe kërkimit cilësor. Përqindja e lartë e zbatimit të planit të referimeve, deri në 100% për doktorantët e regjistruar në vitin 2022–2023, tregon se aktivitetet shkencore po zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar. Për doktorantët e regjistruar në vitin 2024–2025, megjithëse disa tregues ende nuk janë plotësuar, fakti që një pjesë e tyre tashmë janë të përfshirë në projekte të financuara krijon premisa pozitive që këta indikatorë të përmirësohen më tej gjatë viteve në vijim.

**Tabela 6.4:** Aktiviteti botues i doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisnë Veterinare | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Doktorantë gjithsej** | **Artikuj shkencorë gjithsej** | **Artikuj shkencorë në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science** | **Referime/postera në aktivitete shkencore gjithsej** | **Referime/postera në aktivitete shkencore në vende të BE, OECD, G20.** |
| 1. | 2021-2022 | 8 | 7 | 5 | 10 | 5 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | 2022-2023 | 3 | 4 | 3 | 12 | 6 |
| 3. | 2024-2025 | 7 | - | - | - | - |
| **Totali** | | **18** | **11** | **8** | **22** | **11** |

Të dhënat e paraqitura pasqyrojnë një aktivitet të qëndrueshëm dhe në rritje të doktorantëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në fushën e kërkimit shkencor. Për periudhat 2021–2022 dhe 2022–2023, vihet re një produktivitet i konsiderueshëm si në publikimet shkencore, ashtu edhe në prezantimet në konferenca brenda dhe jashtë vendit. Nga 11 doktorantë gjithsej, janë realizuar 11 artikuj shkencorë, prej të cilëve 8 janë botuar në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science, duke dëshmuar për cilësi dhe impakt të lartë kërkimor. Po ashtu, numri i referimeve dhe posterave arrin në 22, me 11 prej tyre të prezantuara në vende të BE-së, OECD ose G20, gjë që tregon një përfshirje të dukshme ndërkombëtare dhe një prezencë aktive në komunitetin shkencor global. Edhe pse doktorantët e regjistruar në vitin 2024–2025 nuk kanë ende rezultate të raportuara, kjo është e pritshme duke qenë se ndodhen në fazat fillestare të studimeve të tyre; megjithatë, pritet që kontributet e tyre të pasqyrohen në vitet në vijim, duke vijuar trendin pozitiv të performancës shkencore në FMV.

**Tabela :** Pjesëmarrja në projekte e doktorantëve

| Nr. | Doktorantë të regjistruar në vitin akademik: | Programi i Doktoraturës në Fakultetin e Mjekësinë Veterinare | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Doktorantë gjithsej | Numri doktorantë të përfshirë në projekte kërkimore kombëtare | Numri i doktorantëve të përfshirë në projekte kërkimore ndërkombëtare | Numri i doktorantëve të që kanë realizuar mobilitete | Numri i doktorantëve që kanë realizuar kualifikime të tjera |
| 1. | 2021-2022 | 8 | 3 | - | 2 | - |
| 2. | 2022-2023 | 3 | 2 | - | 1 | - |
| 3. | 2024-2025 | 7 | 4 | 3 | | |
| **Totali** | | **18** | **9** | **3** | **3** | **-** |

**KONKLUZION:**

Ecuria e deritanishme e Programit të Doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare mund të konsiderohet përgjithësisht normale dhe në linjë me pritshmëritë akademike. Të dhënat tregojnë se nga 18 doktorantë gjithsej, një pjesë e mirë janë të përfshirë në projekte kërkimore të financuara, kanë zhvilluar stazhe jashtë vendit dhe bashkëpunojnë me bashkëudhëheqës të huaj, ndërkohë që është arritur një produktivitet i dukshëm shkencor me 11 artikuj të botuar, prej të cilëve 8 në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science, si dhe 22 referime/postera në aktivitete shkencore, gjysma e të cilave në vende të BE-së, OECD dhe G20. Në këtë kuadër, prezantimet e punës shkencore të doktorantëve në gjuhën angleze, të zhvilluara gjatë këtyre viteve, përbëjnë një tregues të qartë të orientimit drejt ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë akademike. Një element tjetër pozitiv është fakti që dy doktorantë po zhvillojnë aktualisht doktoraturën në Bari, Itali, duke qenë njëkohësisht edhe pjesë e personelit akademik të FMV, çka forcon lidhjen mes kërkimit, mësimdhënies dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Megjithatë, të dhënat sugjerojnë se ka ende hapësirë për përmirësim, veçanërisht sa i takon angazhimit më të gjerë të të gjithë doktorantëve në veprimtari jashtë auditorit dhe në mundësi kualifikimi jashtë vendit. Deri më tani, mobilitetet dhe përfshirja në aktivitete ndërkombëtare janë

realizuar kryesisht falë përpjekjeve institucionale, ndaj është e nevojshme që vetë doktorantët të shfaqin më shumë iniciativë dhe përgjegjësi individuale në kërkim të bursave, projekteve, konferencave dhe stazheve jashtë vendit. Rritja e këtij angazhimi do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e treguesve të performancës shkencore dhe në forcimin e profilit kërkimor të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## TË DHËNA MBI INFRASTRUKTURËN NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR.

## FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE (FSHP)

Kërkimi shkencor akoma nuk është në nivelet që kërkohet, kjo jo vetëm për shkak të mosfunksionimit të GMK-ve, por edhe me problemet e ndryshme që paraqesin laboratorët shkencorë, si:

- infrastruktura e pamjaftueshme, mungesa e lëndëve të para dhe atyre ndihmëse;
- mos funksionimi i pajisjeve të ndryshme laboratorike dhe riparimi i tyre.

Gjatë vitit 2024÷2025 përfundoi vwnia nw punw e pajisjeve për Laboratorin e Modifikimit Termik të Drurit. Laboratori u pajis me pajisje me vlerë mbi 1.200.000 lek, në kuadër të programit PIKSH.
Gjithashtu, përfundoi edhe ndërtimi i Ateljesë së Balsamimit dhe Muzeut të Faunës Pyjore në kuadër të Projektit PIKSH 2023, i cili siguroi një finacim prej 16,000 EUR për blerjen e pajisjeve për ngritjen e tij. Nga ana tjetër, financimi prej gati 12.500.000 lekësh në kuadër të projekti PIKSH, për pasurimin e fondit laboratorik të Laboratorit t Modifikimit Termik, nuk u realizuar dot, për arsye të dështimit të proçedurave të prokurimit.
Në FSHP funksionon një bibliotekë me kapacitet prej 20 postesh, e pajisur me kompjuter dhe internet. Ajo ofron për studentët një sallë studimi gjatë orarit zyrtar të punës.

**Tabela :** Të dhëna mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor;

| FSHP | Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore/…) | Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor* | Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)** |
|---|---|---|---|
| DP | Laboratori i Botanikës | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 modul) | |
| | Laboratori i Dendrologjisë (Ksiloteka) dhe silvikulturës | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 modul) | |
| | Atelie e teknologjisë së shfrytëzimit të pyjeve | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (2 module) | |
| | Laboratori i mbrojtjes së pyjeve | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 modul) | |
| | Laboratori i teknologjisë gjeohapesinore | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 modul) | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| DID | Laboratori i Teknologjisë së Drurit | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 artikull, 2 module) | |
| | Laboratori i Anatomisë së Drurit | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (1 modul) | |
| | Laboratori i Trajtimit Termik të Drurit | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (2 artikuj, 1 konferencë, 2 module) | |
| | Laboratori CAD CAM CAE | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (2 module) | |
| | Qendra Didaktiko - Eksperimentale e Drurit | Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (3 artikuj, 1 konferencë, 3 module) | Ofron shërbime për të tretët (Konceptimi, modelimi dhe realizimi i mobilimit të ambienteve të brendshme) |
| DFSHA | Laboratori i fizikës | Mbështet mësimdhënien (1modul) | |

**KONKLUZION:**

- Shërbimi për të tretë i laboratorëve që mbështesin kërkimin shkencor, nuk praktikohet;
- Një pjesë e pajisjeve nuk janë funksionale;
- Mungojnë protokollet e matjeve dhe testimeve, që pajisjet laboratorike duhet të realizojnë;
- Pajisjet nuk janë të kalibruara dhe çertifikuara së fundmi;
- Mungon një protokoll për trajnimin e laborantëve dhe specialistëve që përdorin pajisjet.

# 6. STUDENTËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

## 6.1. Perfshirja e studentëve në aktivitete shkencore

Përfshirja e studentëve është minimale dhe konsiston vetëm në pjesmarrjen e vetëm 7 studentëve në mobilitete, në kuadër të programit ERASMUS+.

Mungojnë botimet apo konferencat ku studentët kanë marrë pjesë. Kjo shpjegohet edhe me numrin e vogël të studentëve që diplomohen në ciklin e studimeve Master Shkencor.

**Tabela 6.1**: Pjesëmarrje e studentëvë në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mbeshtetja për lëvizshmërinë e tyre

| Nr. | Fakulteti | Emërtimi i Programit të Studimit | Nr. Studentëve Përfitues | Universiteti dhe Vendi Pritës | Semestri | Cikli i Studimit | Fushat e Studimit | Mbështetja financiare për lëvizshmërinë e tyre |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FSHP | Departamenti i Industrisë së Drurit | 3 | Universiteti Bartin<br>TURQI | II | Dizajni interierit dhe inxhinierise se drurit | Teknologji perpunim druri | Erasmus+ |
| | | | 2 | Universiteti i Shkencave te Jetes, Lublin<br>POLONI | II | | Dizajni i interierit | |
| 2 | FSHP | Departamenti i Pyjeve | 2 | Universiteti i shkencave bujqesore, Cluj<br>RUMANI | II | Inxhinieri pyjore | Menaxhimi i pyjeve | Erasmus+ |

## 6.2 Të dhëna mbi aktivitetin kërkimor të doktorantëve

Mungesa e programeve të doktoratës në FSHP ndikon negativisht në përpjekjet për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor. Në Fakultet janë 6 pedagogë të cilët janë asistent lektorë. 4 prej tyre janë regjistruar në ciklin e tretë të studimeve pranë FBM-së dhe i pesti në Universitetin e Ljubjanës në Slloveni. Asistenti i gjashtë ka shprehur dëshirën që të regjistrohen në ciklin e tretë të studimeve në fakultetin tonë, sapo të miratohet.

**Konkluzion**

- Duhen rishikuar prioritetet e kërkimit të njësive bazë me qëllim fokusimin në pak prioritete të rëndësishme.
- Aplikimi pa vonesa për riorganizimin e programit të doktoratës, qoftë edhe në kuadër të reformës BOKU.
- Të organizohet sistemi i monitorimit të efiçencës së laboratorëve që përdoren për aktivitete kërkimi.
- Fakulteti të fokusohet seriozisht në aplikimet për projekte kërkimi në bashkëpunim me partnerë të sektorit prodhues.

## INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE (IRGJB)

## Veprimtari për punën kërkimore në IRGJB

### FUSHAT PRIORITARE TË KËRKIMIT

1. *Eksplorimi & Koleksionimi i Resurseve Gjenetike të Bimëve.*
2. *Menaxhimi i koleksioneve ex situ (me fara dhe fushore).*
3. *Rigjenerimi dhe shumimi i materialit gjenetik të gjermoplazmës së vendit.*
4. *Karakterizimi dhe vlerësimi i aksesioneve të gjermoplazmës së vendit.*

**Tabela e realizimit të fushave prioritare të kërkimit shkencor në IRGJB**

| Fusha e kërkimit shkencor | Objektiviat* | Aktivitetet e planifikuara dhe detyrat konkrete | Realizimi i aktiviteteve |
|---|---|---|---|
| "Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore në zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare", **Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024. Faza I** | Vlerësimi i nivelit të erozionit të specieve dhe varieteteve lokal në fjalë, llojet e rreziqeve dhe propozimi i një plani veprimi për shpëtimin (një raport i detajuar ku përfshihen këto të dhëna) që mund të ndihmojë në ruajtjen e këtyre pasurive natyrore; | 1. Hulumtimi i të dhënave për zonat në studim nga literatura ekzistuese<br>2. Përgatitja e hartave topografike, organizmi i logjistikës dhe ndarja në grupe pune<br>3. Vizita në terren për identifikimin e bimëve me interes, evidentimi i shkallës së përdorimit/shfrytëzimit të llojeve bimore<br>4. Karakterizimi i bimësisë së identifikuar | Të dhënat nga regjistrimet gjatë eksplorimit përfshijnë identifikimin e gjithsej **90 specieve dhe 435 varietete** |
| "Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të bimëve bujqësore në zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare", **Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024. Faza II** | 1. Koleksionimi i mostrave të materialit faror dhe atij shumëzues (copa, rrënjë, etj, për së paku 32 aksesione), për pasurimin me aksesione të Bankës Gjenetike Kombëtare.<br><br>2. Përgatitja e raportit perfundimtar me speciet dhe varietetet, ku të pasqyrohen të gjitha gjetjet në kuadër të programit të zbatuar. | 1. Koleksionimi i mostrave të identifikuara dhe dokumentimi i tyre<br>2. Përpilimi i një raporti të hollësishëm dhe publikimi i rezultateve nëpërmjet artikujve/posterave | Numri i specieve të kultivarevë tradicional të koleksionuar nga rajoni Gramsh – Mokërr për shtim në fondin e Bankës Gjenetike<br>**22 specie dhe 110 varietete** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Eksplorimi & Koleksionimi i Resurseve Gjenetike të Bimëve | 1. Gjetjet nga kontakte në terren dhe bashkëpunim me fermer në rrethinat e Tiranës (aktivitet institucional).<br><br>2. Eksporime dhe 3 koleksionime ekotipesh ulliri & agrume në Tiranë; | 1. Drufrutore (ulli & agrume)2 Popullata të vjetra ulliri eksploruar në rrethinat e Tiranes;<br>cv. Ulli shekullor Dajti (Tujan, komuna Dajt)<br>cv. Ulliri Ilir (Durisht, komuna Petrel)<br>2 cv. Ulli Vajsi Grublleshit (komuna Ndroq)<br>Olivaster e kuqe, (Grubllesh, komuna Ndroq)<br>2 klone portokalli vendi (zona Laprak, Tinanē) | -Dy Popullata të vjetra ulliri eksploruar në rrethinat e Tiranës<br><br>-Tre ekotipe ulli dhe agrume |
| Menaxhimi i koleksioneve ex situ: bazë fara, fushore dhe aktive (farë + fidanë) | 1. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i fuqisë mbirëse të farës si tregues kryesorë të cilësisë dhe stabilitetit të koleksioneve gjatë periudhës së ruajtjes në koleksionin bazë në B. Gj.<br>2. Përshtatja e BMA në Valias për tipare të rëndësishme si rezistenca ndaj thatësirës dhe lagështirës së fushës, koha e lulëzimit dhe frutifikimi duke qenë se këto lloje janë marrë nga zona me klimë të ndryshme. | 1. Monitorimi u krye në laboratorin e IRGJB në përputhje me protokollet e ISTA dhe udhëzimet standarde të Bankës Gjenetike<br><br>2. Shtimi me pjesë vegjetative në bazën eksperimentale në Valias | 1. Monitorimi testit fuqisë mbirëse<br>-**16 acc**. të bamjes<br>-**11 acc**. të erëzave<br>-27 **acc.** të bimëve medicinale<br><br>2. Pasurimi koleksionit të bazës eksperimentale në Valias |
| | Monitorimi i ecurise së zhvillimit të 8 aksesioneve, të ndjeshëm ndaj stresit biotik dhe abiotik | 1. Monitorimin në terren të gjendjes së çdo aksesioni ulli.<br>2. Vëzhgim periodik për aspektin fitosanitar dhe për probleme të mundshme të ngadalësimit të ecurisë së zhvillimit vegjetativ nga faktorë të ndryshëm,<br>3. Planifikim zëvëndësimi i bimëve në koleksion që paraqesin degradim dhe prezencë infektimi.<br>4. Krasitje ripërtëritse | Koleksioni paraqet ecuri normale, megjithse duhet konsideruar fakti i disfavorshëm që një pjesë e mirë e aksesioneve nuk janë në vendorigjinën e vet të kultivimit |
| | U shumëzuan 28 aksesione të hardhisë të grumbulluara në rrethin e Përmetit për ruajtje në repozitor, të cilat paraqiten në gjendje të mirë shendetsore. | Mbjellja e tyre në vazo dhe ruajtja në serrë | Këto aksesione do të mbillen këtë vit në fushë |
| Rigjenerimi dhe shumëzimi i materialit gjenetik të gjermoplazmës së vendit | Rigjenerimi dhe shumëzimi i materialit gjenetik të B.GJ fasule dhe qiqër | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias e 4 acc.fasule dhe 5 acc.qiqra për shtimin e sasisë së farës për fermerin | U sigurua sasia e duhur për fermerin dhe B.Gj |
| | Rigjenerimi i 5 acc kamomil dhe 2 acc borzilok | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias e 5 acc. kamomil dhe 2 acc. Borzilok për | U sigurua sasi fare e mjaftueshme për fondin e B.GJ |
| | Rigjenerimi i për *12 acc të Elbit vjeshtor* 10 acc të thekrës,<br>1 tërshërë dhe 6 pazi | Ndjekja e proceseve të rigjenerimit në bazën eksp. Valias sipas deskriptorëve përkatës për 6 tipare | U sigurua sasi fare e mjaftueshme për fondin e B.GJ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Rigjenerimi/shumëzimi 17 acc të bamjes (Abelmoschus esculentus (L.) | Matja e treguesve sipas deskriptorit per rigjenerimin per 7 tregues | U sigurua një sasi fare e konsiderueshme për të gjithë aksesionet, si dhe një % mbirje më e lartë nga ajo që kemi marrë në laborator, gjë e cila vjen si rrjedhojë e vjetërsisë së farave. |
| | 2 ekotipe ulliri dhe agrume;<br>1) *Ulli Vajsi Grublleshi,*<br>*2) Olivaster e kuqe Ndroqi dhe*<br>2 forma portokalli vendi (klone shumë farësh). | 40 fidanë gjithsej ulliri dhe agrume, u vendosën në rrënjëzim me stimulim fitohormoni në serrë (Prezë). | Shtimi me copa të rrënëjzuara i 30 fidanëve ulli.<br>10 fidanë agrume për 2 forma portokalli vendi Të gjithë këto fidanë siguruan një fond rezervë bimësh në koleksion |
| Karakterizimi dhe vlerësimi i aksesioneve të gjermoplazmës së vendit | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për 7 acc B.M për të dalluar tiparet e tyre morfologjike. | Ndjekja e proceseve të karakterizimit dhe vlerësimit sipas deskriptorëve përkatës për 27 tipare primare dhe sekondare morfologjike dhe vlerësimi u bë për 3 tipare kryesore të tyre | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për 5acc. kamomil dhe 2 acc. borzilok |
| | Karakterizimi dhe vlerësimi u realizua për *12 acc të Elbit vjeshtor* 10 acc të thekrës, 1 tërshërë dhe 6 pazi | Ndjekja e proceseve të karakterizimit dhe vlerësimit sipas deskriptorëve *16 parametra/tipare:* ***Karakteristikat morfologjike (8 tipare); Karakteristikat agronomike (4 tipare); Cilësitë e kokrrës (4 tipare).*** | Acc treguan **variacion të gjerë fenotipik** |
| | Studimi i diversitetit morfologjik, nëpërmjet karakterizimit të tipareve për 17 acc autoktone të bamjes (Abelmoschus esculentus (L.) Moench. | Kryerja e matjeve për karakterizimin dhe vlerësimin per tiparet biomorfologjike dhe agronomike të bimëve u krye në bazë të 34 përshkruesve të vendosur nga (IPGRI, 1991), me 18 përshkrues cilësorë dhe 16 përshkrues sasiorë. | Nga karakterizimi dhe vlerësimi i 17 acc të bamjes veçuam acc AGB3690 (Oblike) për prodhimtari të lartë, uniformitet dhe rezistencë ndaj dëmtuesve, si dhe AGB5094 (Bamje trup e lartë) për fruta të mëdhenj dhe kërcell të fortë me shumë degëzime |
| | Karakterizimi dhe vlerësimi i 8 varieteteve (acc) nga koleksioni fushor (IRGJB) Valias, që kanë hyrë në prodhim.<br>Ulliri i bardhi Krujës, Mixan, Frang, Kushan, Kryps Berati, Ullaster vendi, Bahut | Nëpërmjet karakterizimit u bë identifikimi i diversitetit te acc, që rezultoi në nje shkallë dukshmërie mesatare | Një pjesë e mirë e varieteteve nuk janë në arealin e ngjashëm me vend origjinën, ndaj sjellja e moderuar e përshtatshmërisë së tyre në zonë, mbetet e justifikuar.<br><br>Evidentim i cv. Ulliri i bardh i Krujës, rezultoi me një përshtatshmeri disi më ndryshe në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | aspektin pozitiv, në raport me 7 acc. e tjerë në studim, kjo nëpërmjet evidentimit të treguesve nga performanca e zhvillimit vegjetativ dhe karakteristikave biologjike individuale. |
| | U karakterizuan 10 aksesionet e hardhisë | Gjatë vegjetacionit u vlerësuan 4 tregues të majës së rritjes dhe 7 tregues të gjethes. | u paraqitën me ndryshueshmëri për 2 karakteristika të lastarit dhe 4 karakterisika të gjethes. |
| | U karakterizuan 3 aksesioneve të kumbullës | U vlerësuan 5 tregues per tipare morfologjike dhe 7 tregues per tipare te kokrres të gjethes. | U paraqesiten ndryshueshmëri morfologjike midis tyre dhe si të tillë ata janë të ndryshëm dhe unik mbi bazën e karakteristikave morfologjike të tyre. |
| Projekti “Farat autoktone” GIZ Sustainable Development of Rural Areas (SRD) PN (number) 21.2315.6-006.00 | 1. Ruajtja e burimeve gjenetike bimore për ushqim dhe bujqësi<br>2. Kthimi i sasisë së farës në Bankën Gjenetike së dhënë për shumëzim te fermeri<br>3.Çertifikimi i 7 specieve të shumëzuara, gati për tregëtim<br>4.Promovimi dhe Integrimi i varieteteve vendase në bizneset agroturistike | 1. Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së projektit nëpërmjet ekspertizës te fermeri<br>2. Trajnime të ndryshme te agroturizmet<br>3.Ndërgjegjësimi i aktorëve të ndryshëm i vlerave të farave autoktone<br>4. Promovimi i kultivimit dhe ruajtjes së tyre | Kthimi i sasisë së farës për **48** nr. perime të ndryshme të shumëzuara nga fermeri Alban Çakalli duke pasuruar fondin e B.GJ |

**Tab.1 Numri i mostrave të rigjeneruara, karakterizuara, vlerësuara, koleksionuara dhe analizuara në laboratorin e B.GJ (Janar 2024-Nëntor, 2025).**

| **Procesi i realizuar/speciet** | **Njësia** | **Mostra/acc. analizuara** | **Kërkuesi/koleksionuesi /donatori** |
|---|---|---|---|
| **I. Monitorimi_aftësisë mbirëse** | **Nr.** | | |
| Aksesione të bamjes | acc. | **17** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të erëzave | acc | **11** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të bimëve medicinale | acc | **27** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme të perimeve (sjellë nga fermeri A.Ç) | acc | **44** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| **Shuma I** | **Totali** | **99** | |
| **II. Rigjenerime/analiza pas rigjenerimeve** | | | |
| Aksesione të bamjes | acc | **17** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të ndryshme drithëra (thekër, okër, tërshërë) | acc | **10+3+1=13** | Stafi akademik + stafi ndihmës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Aksesione leguminoze (fasule, qiqër, bathë,bizele) | acc | **4+6+24+23=57** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të pazisë | acc | **5** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| Aksesione të bimëve medicinale (kamomil dhe borzilok) | acc | **5+2=7** | Stafi akademik + stafi ndihmës |
| **TOTALI/RIGJENERIME** | **Totali** | **99** | |
| **III. Koleksionime** | | | |
| 90 specie dhe 435 varietete të ndryshme | acc | **90** | Stafi IRGJB |
| 22 specie dhe 110 varietete të ndryshme | acc | **22** | Stafi IRGJB |
| Mostra perime të ndryshme | acc | **22** | Alban Çakalli |
| Mostra të specieve dhe kultivarëve të koleksionuara gjatë vitit 2025(zona juglindore ), | acc | **54** | Prof. Robert Damo Univesiteti Korcë |
| mostra të specieve të egra | acc | **125** | Alban Ibraliu |
| **Shuma III** | **Totali** | **313** | |
| **TOTALI (I+II+III) (99+99+313) =511** | TOTALI | **511** | |

**KONKLUZION:** "Realizimi i qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit", evidentojmë se përgjatë vitit 2024-2025 fushat prioritare të kërkimit shkencor janë të mbuluar me aktivitetet përkatëse nga stafi akademik.

## TITUJT AKADEMIKË, UBT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

### Lista e personave që kanë fituar tituj akademikë në UBT (2024 – 2025)

**Lista e personave që kanë fituar titullin akademik "Profesor"**

| Nr | Fusha e Studimit/Fakulteti | Emri, mbiemri | Institucioni i Arsimit të Lartë nga vjen | Titulli akademik i fituar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Ledia Spartak Thoma | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Profesor |
| 2 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Gjokë Tom Uldedaj | Kolegji Universitar "Qiriazi" | Profesor |
| 3 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Bajram Hysen Korsita | U. "Aleksandër Moisiu", Durrës | Profesor |
| | | | | |
| 4 | Bujqësi dhe Mjedis | Elizabeta Hakik Susaj | Western Balkans University | Profesor |
| | | | | |
| 5 | Mjekësi Veterinare | Kastriot Pandeli Korro | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Profesor |
| | | | | |
| 6 | Shkencat Pyjore | Dritan Haxhi Ajdinaj | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Profesor |

**Lista e personave që kanë fituar titullin akademik "Profesor i asociuar"**

| Nr. | Fusha e Studimit/Fakulteti | Emri, mbiemri | Institucioni i Arsimit të Lartë nga vjen | Titulli akademik i fituar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Elton Vllasi Guberaj | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |
| 2 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Amalia Kiço Tola | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |
| 3 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Denisa Guri Kurtaj | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |
| 4 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Gerta Edmond Gogo | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |
| 5 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Merita Rexhep Toska | Universiteti Polis | Prof. asoc. |
| 6 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Ardi Ylber Bezo | Kolegji Universitar i Biznesit | Prof. asoc. |
| 7 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Arjeta Ilir Shpuza | U. "Aleksandër Moisiu", Durrës | Prof. asoc. |
| 8 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Enis Gazmend Fita | Kolegji Universitar i Biznesit | Prof. asoc. |
| 9 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Luçiana Ndoc Toti | U. "Aleksandër Moisiu", Durrës | Prof. asoc. |
| 10 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Pjetër Zef Ndreca | Universitetit Metropolitan Tirana | Prof. asoc. |
| 11 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Arben Barjam Hysi | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Prof. asoc. |
| 12 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Aurela Luan Braholli | Tirana Business University | Prof. asoc. |
| 13 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Jonada Manush Mamo | U. "Aleksandër Moisiu", Durrës | Prof. asoc. |
| 14 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Edlira Dhimitraq Llazo | U. "Aleksandër Moisiu", Durrës | Prof. asoc. |
| 15 | Ekonomi dhe Agrobiznes | Aelita Luftar Mani | Universiteti "Barleti" | Prof. asoc. |
| | | | | |
| 16 | Bujqësi dhe Mjedis | Marilda Selim Osmani | U. "Aleksandëra Xhuvani", Elbasan | Prof. asoc. |
| 17 | Bujqësi dhe Mjedis | Artan Hekuran Hysa | Epoka University | Prof. asoc. |
| 18 | Bujqësi dhe Mjedis | Ndoc Kol Vata | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |
| | | | | |
| 19 | Mjekësi Veterinare | Majlind Sulejman Sulçe | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. asoc. |

1. Duhet theksuar që procesi i promovimit akademik në UBT ka qenë tepër korrekt, transparent, duke u bazuar në VKM. Nr. 112, datë 23. 02. 2018, ndryshuar me VKM Nr. 128, dt. 06.03.2024 dhe Rregulloren për Fitimin e Titujve Akademikë në UBT, dt. 19.10.2021 (e ndryshuar)
2. Procesi i promovimit të personelit akademik ka patur vijimësi dhe vazhdueshmëri, duke bërë që mbledhjet e KPPA-së të organizohen rregullisht cdo muaj.

**Problematika të vërejtura gjatë procesit të fitimit të Titujve Akademikë Prof. Asoc dhe Profesor.**

Në kuadër të përgatitjes së dosjes së çdo kandidati nga UBT apo edhe jashtë UBT- së, në kërkim të fitimit të titullit akademik Prof. Assoc dhe Profesor, Zyra e Shkencës dhe Promovimit Akademik ka përgatitur Skedat përkatëse për të ndihmuar paraqitjen sa më të saktë të dokumentave, por edhe për ta lehtësuar procesin e kontrollit të dosjeve.

1. Problematikat e para fillojnë qysh në vendosjen e dokumentacionit në dosje, megjithëse ne, vazhdimisht kemi dërguar email shpjegues Zv/dekanëve të Shkencës dhe Projekteve.
2. Cdo kandidat brenda UBT-së e fillon procedurën në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Bazë, pra këto dy njësi janë përgjegjëse për gjithçka përmban dosja, aktivitetin shkencor të kandidatit, fushën e kërkimit të tij dhe faktin nëse kjo fushë përputhet me atë të kandidatit.
3. Cdo përgjegjës departamenti dhe çdo dekanat përgatit një relacion për seicilin kandidat, që aspiron të fitojë titullin Prof. Assoc dhe Profesor. Shpesh herë këto relacione nuk përputhen plotësisht me ato që realisht përmban dosja e kandidatit.
4. Skedat që vërtetojnë aktivitetin kërkimor shkencor të kandidatit, shpesh janë të pa firmosura nga drejtuesi i njësisë bazë apo nga drejtuesi i njësisë kryesore.

**PROBLEMATIKA TË VËREJTURA NË UBT LIDHUR ME PROGRAMIN E DOKTORATËS;**

Në respekt të Ligjit të Arsimit të Lartë, Ligjin Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", VKM-në, 112, dt. 23.02.2018 (e ndryshuar) kemi hapur dhe organizuar Programin e Doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Programi i Doktoratës funksionon tashmë në tre vite akademike:

- Viti akademik 2021-2022
- Viti akademik 2022-2023
- Viti akademik 2024-2025

Doktorantët fitues të vitit akademik 2024-2025, janë dërguar tashmë në QSHA për të marrë numrin e matrikulimit.

Me përpjekjet kolosale të autoriteteve drejtuese të UBT -së, impenjimin e Zyrës së Shkencës dhe Promovimit Akademik, në lidhje më ecurinë dhe funksionimin normal të të gjithë procesit, të pranimit të dosjeve të kandidatëve, përzgjedhjes së tyre, miratimit të metodikës, dhe ndjekjes së referimeve nëpër njësitë bazë (departamente), duhet theksuar se ky proces ka shkuar në rrugë të mbarë e të suksesshme.

Megjithatë, për një përmirësim të mëtejshëm të këtij procesi mund të evidentojmë edhe disa problematika si më poshtë:

1. Programet e studimeve të ciklit të tretë, duhet të organizohen si rregull brenda një projekti të madh kërkimor-shkencor e zhvillimor për këto studime. Një pjesë e mirë e doktorantëve të regjistruar në vitin akademik 2021-2022, prezantuan dhe punuan në kuadër të një projekti kërkimor -shkencor. Por duhet theksuar se, jo të gjithë doktorantët, sidomos ata të regjistruar në vitin akademik 2022-2023 kanë sjellë një projekt kërkimor-shkencor. Doktorantët e shpallur fitues në vitin akademik 2024-2025 kanë paraqitur të gjithë projekte kërkimore-shkencore, ose projekte të mbështetura dhe të finacuar nga të tretët.
   Mungesa e një projekti kërkimor -shkencor sjell vështirësi në realizimin e objektivave të vendosura qysh në metodikën e studimit, dhe më pas në referimet e doktorantit.
2. Nëse do t'i referohemi të dhënave të njësive kryesore, një pjesë e vogël e doktorantëve kanë realizuar stazhe kërkimore jashtë vendit. Kërkohet më shumë impenjim dhe interes nga ana e doktorantëve për të realizuar këto bashkëpunime, sepse UBT vazhdimisht i nxit dhe i promovon pedagogwt e rinj, për të punuar në ekip me profesorët e universiteteve të huaja partnere, në rajon dhe më gjerë.

3. Nisur nga vështirësitë e hasura në regjistrimin e doktorantëve të vitit akademik 2022-2023 në QSHA, duhet të sjellim në vëmendje problemin e gjuhës së huaj, anglisht, e cila për doktorantët kërkohet në nivelin $B_2$. Është mirë që në momentin e përzgjedhjes së kandidatëve, në dosjen e tyre të jetë e depozituar niveli $B_2$ i gjuhës së huaj, anglisht.

## 6.ANALIZA E PRODUKTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR PËR VITIN 2025

Aktiviteti botues i stafit akademik të UBT-së përbën një nga treguesit kryesorë të kapaciteteve të tij kërkimore dhe të rolit në komunitetin shkencor, brenda dhe jashtë vendit. Ai reflekton aftësinë e pedagogëve dhe kërkuesve për të gjeneruar, përpunuar dhe përçuar njohuri të reja përmes artikujve shkencorë, kapitujve në libra ndërkombëtare, monografive dhe kontributeve në aktivitete shkencore. Në të njëjtën kohë, ky aktivitet tregon nivelin e angazhimit profesional të stafit, i cili kombinon punën individuale me punën në ekipe dhe në projekte të përbashkëta me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë. Të dhënat e viteve të fundit tregojnë se një pjesë gjithnjë e më e konsiderueshme e produktit shkencor publikohet në revista me faktor impakti dhe në revista të indeksuara në databaza si Scopus dhe Web of Science, gjë që kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e vizibilitetit dhe të ndikimit akademik të UBT-së. Rritja e kapaciteteve botuese është ndikuar si nga kërkesat ligjore për promovimin akademik, ashtu edhe nga ambiciet individuale të personelit, ndërkohë që mbështetja financiare institucionale për kërkimin dhe botimin mbetet e kufizuar dhe shpesh nuk e mbulon të gjithë ciklin e produktit shkencor.

**KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË AKTIVITETIT BOTUES**

**Kontributi Individual dhe Cilësia Shkencore:** Një grup i konsiderueshëm anëtarësh të personelit akademik kontribuon rregullisht me artikuj në revista me integritet të lartë shkencor, shpesh me faktor impakti, duke e pozicionuar UBT-në si një aktor të dukshëm në disa fusha të kërkimit. Këto botime përfaqësojnë shpesh rezultatet më të qëndrueshme të punës kërkimore dhe të projekteve shkencore ku UBT është përfshirë, duke forcuar si kapacitetet individuale, ashtu edhe imazhin institucional. Megjithatë, numri i artikujve në revista me faktor impakti mbetet ende nën potencialin real kërkimor të universitetit, në raport me volumet e studimeve që zhvillohen çdo vit. Në disa raste, kërkues që kanë arritur titujt më të lartë akademikë tregojnë një motivim më të kufizuar për botime të reja, gjë që lidhet edhe me vështirësitë objektive për zhvillimin e kërkimit eksperimental në fusha ku kostot janë të larta.

**Bashkëpunimi Akademik:** Puna në bashkë-autorësi, brenda dhe ndërmjet departamenteve, ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së botimeve, duke mundësuar kombinimin e ekspertizave të ndryshme dhe transferimin e përvojës te stafi më i ri. Bashkëpunimet ndërdepartamentore dhe ndërdisiplinore, ndonëse të paformalizuara, po shndërrohen gradualisht në një praktikë të qëndrueshme pune në disa njësi, duke e bërë kërkimin më të lidhur me problematikat komplekse të sektorit bujqësor, mjedisor dhe ekonomik. Megjithatë, në shumë raste aktiviteti kërkimor vazhdon të mbështetet kryesisht në iniciativat individuale të pedagogëve dhe jo në plane të strukturuara kërkimore të miratuara paraprakisht nga njësitë bazë.

**Fokusimi në Fusha Prioritare të Kërkimit:** Në përgjithësi, tematika e botimeve reflekton prioritetet kryesore kërkimore të departamenteve dhe programeve studimore, në përputhje me strategjitë e UBT-së. Ky orientim tematik ka kontribuar në rritjen cilësore të produktit shkencor dhe në konsolidimin e ekspertizës në fusha ku universiteti ka traditë ose avantazh krahasues, duke mundësuar edhe transferimin e rezultateve të kërkimit në mësimdhënie dhe në punët me karakter konsulence. Një pjesë e artikujve adresojnë boshllëqe të rëndësishme njohurish në kontekstin shqiptar, duke krijuar bazë më të mirë për politika dhe praktika të bazuara në evidenca.

**Vizibilitet dhe Ndikim Ndërkombëtar:** Pjesa më e madhe e artikujve botohet në revista ndërkombëtare, çka e ka rritur profilin akademik të UBT-së dhe e ka vendosur atë si partner të besueshëm në rrjete kërkimore rajonale dhe evropiane. Për kërkuesit e rinj, pjesëmarrja në botime me faktor impakti dhe në revista të

indeksuara mbetet sfidë, por edhe një mundësi e rëndësishme për afirmim profesional; prandaj mbështetja institucionale për ta është thelbësore (trajnime, mentorim, mbulim pjesor i tarifave të publikimit etj.). Botimet brenda vendit, përfshirë revistën AJAS të UBT-së, janë ende më të kufizuara në numër krahasuar me ato ndërkombëtare, gjë që tregon një prirje për të synuar kryesisht tregun e jashtëm shkencor dhe e vë revistën institucionale nën presion për të rritur më tej cilësinë dhe për të tërhequr dorëshkrime.

Aktiviteti botues i UBT-së është një indikator i rëndësishëm i zhvillimit të kapaciteteve kërkimore dhe i angazhimit të stafit për të kontribuar në debatin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë, mungesa e fondeve të dedikuara për kërkimin shkencor dhe barra financiare që lidhet me publikimin në revista me impakt të lartë kufizojnë potencialin e plotë si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor; adresimi i kësaj problematike mbetet një nga parakushtet kryesore për rritje të mëtejshme. Në vijim paraqitet një analizë e aktivitetit botues të personelit akademik të njësive të veçanta dhe në nivel universiteti.

## BOTIMI I ARTIKUJVE SHKENCOR

Aktiviteti kërkimor i FBM-së gjatë vitit 2025, i pasqyruar në Fig. 1, tregon një nivel të lartë angazhimi të stafit akademik në botime shkencore. Numri tërësor i artikujve ka kaluar nga 112 artikuj në vitin 2024 në 135 artikuj në 2025, që përfaqëson një rritje prej 23%. Pjesën kryesore të produktit e përbëjnë artikujt e botuar jashtë vendit dhe sidomos ata në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science (90 artikuj kundrejt 74 një vit më parë ose një rritje prej 16%), ku spikasin veçanërisht departamentet e profilit mjedisor dhe agronomik. Koeficienti i efektivitetit artikuj/pedagog për FBM-në arrin në 1.6, nga 1.5 në vitin paraardhës, duke e pozicionuar këtë fakultet pak mbi mesataren e UBT-së (1.4). Megjithëse vërehet një aktivizim gradual i doktorantëve, numri i artikujve të tyre mbetet ende nën nivelin e dëshiruar, çka sugjeron nevojën për rritje të mentorimit dhe të mbështetjes për publikim.

Fig. 1 Artikuj shkencore te botuar nga personeli akademik i FBM




FBM – Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit/DAP – Dep. Akuakulturës dhe Peshkimit/DMB – Dep. Mbrojtjes së Bimëve./DHAP – Dep. Hortikulturës dhe Arkit. së Peizazhit/DSHZ – Dep. Shkencave Zooteknike/DSHA – Dep. Shkencave Agronomike/DMBN – Dep. Mjedisit dhe Burimeve Natyrore

Aktiviteti botues i FEA-s gjatë vitit 2025, i paraqitur në Fig. 2, tregon një dinamizëm të dukshëm të stafit akademik. Numri i artikujve të botuar brenda dhe jashtë vendit është rritur me 33%, nga 135 në 168 artikuj. Botimet në revista ndërkombëtare arrijnë në 158 artikuj (kundrejt 122 një vit më parë), ndërsa artikujt e indeksuar në Scopus/Web of Science janë rritur me 29% (nga 76 në 105). Kjo panoramë tregon se FEA po e forcon profilin e vet kërkimor sidomos në fushat e ekonomisë, politikave të zhvillimit rural dhe menaxhimit të biznesit agroushqimor, megjithëse vazhdojnë të ekzistojnë diferenca të dukshme ndërmjet departamenteve në nivelin e angazhimit.




FEA-Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit/DDA – Dep. Drejtimit të Agrobiznesit/DMTR – Dep. Menaxhimit të Turizmit Rural./DGJH – Dep. Gjuhëve të Huaja/DMI – Dep. Matematikës dhe Informatikës/DFK – Dep. Financë - Kontabilitet/DEPZHR – Dep. Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural

Fig. 3 paraqet produktin shkencor të FBU-së për vitin 2025. Në total, stafi akademik i këtij fakulteti ka realizuar 64 artikuj shkencorë, nga 29 në 2024. Pjesa dërrmuese e tyre janë botime ndërkombëtare (64 artikuj, kundrejt 27 një vit më parë), ndërsa artikujt e indeksuar në Scopus/Web of Science janë dyfishuar (nga 22 në 45) në raport me vitin paraardhës. Botimet brenda vendit mbeten të kufizuara (2 artikuj), por shërbejnë si një kanal i rëndësishëm për prezantimin e rezultateve në gjuhën shqipe dhe për adresimin e problematikave kombëtare në fushën e bioteknologjisë dhe të shkencës së ushqimit. Diferencat ndërmjet njësive bazë brenda FBU-së tregojnë nevojën për më shumë bashkëpunim ndërdepartamentor dhe për nisma të përbashkëta kërkimore.




FBU – Fakulteti Bujqësisë dhe Ushqimit/QKU – Qendra e Kërkimit të Ushqimeve/DK – Dep. i Kimisë/DSHUB – Dep. Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë/DTAU = Dep Teknologjive Agroushqimore

Personeli akademik i FMV ka arritur të realizojë 27% më shumë botime shkencore si rrjedhojë e bashkëpunimit me institucione të tjera kërkimore – shkencore (Fig. 4). Ajo që bie në sy në aktivitetin botues të kërkuesve të FMV-së është rritja vit pas viti e numrit të publikimeve me faktor impakti të lartë (≥ 4).




FMV – Fakulteti Mjekësisë Veterinare/DLK – Dep. Lëndëve Klinike/DSHPV – Dep. Shëndetit Publik Veterinar/DLPK – Dep. Lëndëve Paraklinike/DMMF = Dep. Moduleve Morfofunksionale

Produktit shkencor i FSHP-së për vitin akademik 2024–2025, i reflektuar në Fig. 5, është relativisht i ulët në raport me njësitë e tjera kryesore të UBT-së. Numri total i artikujve është rritur nga 10 në 1 në vitin 2025, ndërsa koeficienti artikuj/pedagog është në 1 (rritur nga 0.4 në 0.5. Pesha e artikujve në revista me faktor impakti ose të indeksuara në Scopus/Web of Science është e kufizuar 10 artikuj, gjë që lidhet më së shumti me mungesën e një programi doktorature në këtë fakultet.

Fig. 5: Artikuj shkencore te botuar nga personeli akademik i FSHP




FSHP – Fakulteti Shkencave Pyjore/DFSHA – Dep. Fizikës dhe Shkencave të Aplikuara/DP – Dep. Pyjeve/DID – Dep. Industrisë së Drurit

Aktiviteti kërkimor i IRGJB është përmirësuar disi në raport me vitin e kaluar, por ende me një numër modest artikujsh (Fig. 6). Gjithësesi, aktiviteti kërkimor është brenda misionit të institutit.

Fig. 6: Artikuj shkencore te botuar nga personeli akademik i IRGJB




IRGJB – Insituti Resurseve Gjenetike Bimore

Me qëllim korrigjimin e ndikimit të madhësisë së njësive kryesore, në Fig. 7 paraqiten koeficientët e efektivitetit artikuj/pedagog sipas njësive bazë, duke përfshirë të gjitha kategoritë e artikujve (brenda dhe jashtë vendit, të indeksuar dhe jo). Vlera mesatare në rang UBT-je është rritur nga 1 artikull në vit në 1.6 artikuj në vit. Figura lejon të identifikohen qartë njësitë që qëndrojnë mbi mesatare – ku spikasin disa departamente të FEA-s, FBM-së dhe FBU-së – si dhe ato që mbeten poshtë mesatares, çka sinjalizon fusha ku nevojiten më shumë mbështetje, bashkëpunim ndërdepartamentor dhe rishikim të prioriteteve kërkimore.




Nëse konsiderojmë vetëm artikujt e botuar në revista të indeksuara Scopus/Web of Science koeficienti mesatar, në raport me vitin 2024, është rritur nga 0.7 në 1.1 artikull/pedagog. Pavarësisht përmirësimit, ky tregues është i ulët në krahasim me universitete evropiane ku luhatet nga 2 - 4.



Në fazën e reformimit të kërkimit shkencor, Fig. 9 jep një panoramë të shpërndarjes së produktit shkencor ndërmjet njësive bazë të UBT-së, duke përfshirë të gjithë artikujt e botuar (të indeksuar dhe jo).




Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se disa fusha – si ekonomia dhe politikat e zhvillimit rural (11%), drejtimi i agrobiznesit (7%), matematika dhe informatika (7%), mjedisi dhe burimet natyrore (11%), shkencat agronomike (7%)) dhe shkencat e ushqimit e bioteknologjisë (7%) si edhe shkencat bazë veterinare (5%) – japin një kontribut të konsiderueshëm në numrin total të artikujve (446 artikuj). Figura vë në dukje edhe se një sërë njësish të tjera kanë volum më modest botimesh, gjë që duhet marrë parasysh në përcaktimin e kompetencave prioritare të universitetit dhe në planifikimin e mbështetjes për kërkimin.

Fig. 10 fokusohet vetëm te artikujt e botuar në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science, duke ofruar një pamje më të qartë të shpërndarjes së produktit shkencor me cilësi të lartë sipas njësive bazë. Siç shihet në grafik, numri më i madh i botimeve të këtij tipi vjen nga njësitë e ekonomisë dhe politikave të zhvillimit rural, drejtimit të agrobiznesit dhe matematikës-informatikës në FEA; nga departamentet e mjedisit dhe burimeve natyrore, shkencave agronomike dhe mbrojtjes së bimëve në FBM; nga shkencat e ushqimit dhe bioteknologjia në FBU; si dhe nga shërbimi publik veterinar në FMV dhe pyjet në FSHP. Kur këto të dhëna peshohen me numrin e pedagogëve në çdo departament, dallohet akoma më qartë një grup njësish me produktivitet të lartë në artikuj të indeksuar, të cilat mund të konsiderohen si bërthama kryesore e kompetencave kërkimore të UBT-së në nivel ndërkombëtar.

KRAHASIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS NUMRIT GJITHSEJ TE ARTIKUJVE NE REVISTA TE INDEKSUARA (SCOPUS & WEB OF SCIENCE)




Kur të dhënat e mësipërme për numrin e artikujve në revista të indeksuara i peshojmë sipas numrit të pedagogëve të njësisë bazë përkatëse, panorama është disi më e ndryshme, duke nxjerrë në pah një aktivitet të spikatur kërkimor në shkencat ushqimore, ato veterinare bazë, ekonomi dhe politika zhvillimi rural, mjedis dhe burime natyrore, akuakulturë, etj.

KRAHASIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS NUMRIT PER PEDAGOG TE ARTIKUJVE NE REVISTA TE INDEKSUARA (SCOPUS & WEB OF SCIENCE)



Është e qartë se çdonjëra prej këtyre njësive ofron disa fusha të gjera kërkimi por sidoqoftë ky vështrim panoramik i këtyre ndarjeve është i vlefshëm edhe për krahasimet që bëjnë shërbimet analitike të databazave të mëdha si Scopus dhe Web of Science. Gjithësesi, disa emërtimet departamentesh i referohen më shumë ndarjeve të moduleve se sa fushave të kërkimit, ndaj edhe nevojitet një përcaktim sa më i saktë i fushave të gjera të kërkimit në çdo departament dhe klasifikimi i botimeve sipas tyre.

Në tërësi, aktiviteti botues i stafit akademik të UBT-së ka shpërfaqur një arritje të kënaqshme në vitin akademik 2024-2025 me rreth 446 artikuj, ku 93% e tyre në revista ndërkombëtare, nga të cilët 305 artikuj në revista të indeksuara në Scopus ose Web of Science. **Në raport me vitin akademik 2023 – 2024, kemi një rritje prej 45% në numrin e artikujve, ndërsa rritja në artikuj të indeksuar është mbi 47%.** Këto të dhëna tregojnë se, pavarësisht kufizimeve në financimin e kërkimit, UBT arrin të ruajë një profil të dukshëm ndërkombëtar në publikime, megjithëse ekziston ende hapësirë për rritjen e volumit dhe të cilësisë së artikujve të indeksuar.

## PJESËMARRJA NË AKTIVITETE SHKENCORE

Për FBM-në, numri i kumtesave rritet ndjeshëm nga 133 në vitin 2023-2024 në 198 në vitin 2024-2025, që korrespondon me një rritje prej rreth +48,9%. Pjesëmarrja në konferenca kombëtare (me dhe pa proceedings) zvogëlohet nga 15 në 9 kumtesa, ndërkohë që kumtesat në konferenca ndërkombëtare rriten nga 118 në 189. Edhe pse pesha e kumtesave në konferenca ndërkombëtare me proceedings në total për FBM bie lehtë (nga rreth 71,4% në 65,2%), në vlerë absolute ato rriten ndjeshëm, nga 95 në 129 kumtesa, ndërsa kumtesat ndërkombëtare pa proceedings rriten nga 23 në 60. Kjo tregon se FBM jo vetëm ruan një angazhim të lartë në konferenca ndërkombëtare me proceedings, por edhe e zgjeron dukshëm prezencën në evente ku pjesëmarrja nuk shoqërohet me publikim të plotë, duke reflektuar një gamë më të gjerë aktivitetesh shkencore.




FBM – Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit/DMBN – Dep. Mjedisit dhe Burimeve Natyrore/DSHA – Dep. Shkencave Agronomike/ DSHZ – Dep. Shkencave Zooteknike/ DHAP – Dep. Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit/DMB – Dep. Mbrojtjes së Bimëve./DAP – Dep. Akuakulturës dhe Peshkimit/

FEA shfaq gjithashtu një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore. Numri total i kumtesave rritet nga 158 në 203 kumtesa (+28,5%). Nga pikëpamja strukturore, kumtesat në konferenca kombëtare (me dhe pa proceedings) bien nga 30 në vetëm 9, ndërsa kumtesat në konferenca ndërkombëtare rriten nga 128 në 194. Brenda tyre, kumtesat ndërkombëtare me proceedings kalojnë nga 118 në 161, duke e rritur peshën e tyre në totalin e FEA-s nga rreth 74,7% në 79,3%. Pra, FEA zhvendos dukshëm fokusin nga konferencat kombëtare drejt konferencave ndërkombëtare me proceedings, duke rritur njëkohësisht në mënyrë të dukshme volumin e përgjithshëm të prezantimeve shkencore.

Fig. 13: Kumtesa te mbajtura nga personeli akademik i **FEA** ne konferenca dhe aktivitetet te tjera shkencore




FEA – Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit/DEPZHR – Dep. Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural/DFK – Dep. Financë – Kontabilitet/ DMI – Dep. Matematikës dhe Informatikës/DGJH – Dep. Gjuhëve të Huaja/DMTR – Dep. Menaxhimit të Turizmit Rural/DDA – Dep. Drejtimit të Agrobiznesit

FBU regjistron një rritjen shumë të madhe në pjesëmarrjen në konferenca. Numri i kumtesave rritet nga 53 në 124 kumtesa, pra afërsisht +134% më shumë se një vit më parë. Në vitin 2023-2024, FBU raportonte vetëm 2 kumtesa në konferenca kombëtare dhe 51 në konferenca ndërkombëtare; në vitin 2024-2025 këto shifra kalojnë respektivisht në 9 kumtesa kombëtare dhe 115 ndërkombëtare. Rritja është veçanërisht e fortë në konferencat ndërkombëtare me proceedings, të cilat kalojnë nga 33 në 105 kumtesa, duke e rritur peshën e tyre në totalin e FBU-s nga rreth 62,3% në 84,7%. Kjo tregon një aktivizim shumë të fortë të njësive të FBU-s në prezantimin e rezultateve të kërkimit në konferenca ndërkombëtare me standarde të qarta botimi.




FBU – Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit/DTAU = Dep Teknologjive Agroushqimore/DSHUB – Dep. Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë/DK – Dep. i Kimisë/QKU – Qendra e Kërkimit të Ushqimeve

Për FMV-në, numri i kumtesave rritet në mënyrë më të moderuar, nga 57 në 67 kumtesa (+17,5%). Kumtesat në konferenca kombëtare (me dhe pa proceedings) bien nga 4 në 1, ndërsa kumtesat në konferenca ndërkombëtare rriten nga 53 në 66. Brenda tyre, kumtesat ndërkombëtare me proceedings rriten nga 34 në 48, duke e çuar peshën e tyre në totalin e FMV-s nga rreth 59,6% në 71,6%.




FMV – Fakulteti Mjekësisë Veterinare/DMMF = Dep. Moduleve Morfofunksionale/DLPK – Dep. Lëndëve Paraklinike/DSHPV – Dep. Shëndetit Publik Veterinar/DLK – Dep. Lëndëve Klinike

Pra, FMV ruan një bazë relativisht të qëndrueshme pjesëmarrjeje, por me një orientim gjithnjë e më të fortë drejt konferencave ndërkombëtare me proceedings, ndërkohë që roli i konferencave kombëtare mbetet në nivele shumë të ulëta.

FSHP shënon një rritje të dukshme të pjesëmarrjes, nga 16 në 25 kumtesa (+56,2%). Numri i kumtesave në konferenca kombëtare ndryshon pak në terma absolutë (nga 3 në 2), ndërsa kumtesat në konferenca ndërkombëtare rriten nga 13 në 23. Pjesën dërrmuese të aktiviteteve të FSHP-s e përbëjnë kumtesat ndërkombëtare me proceedings, të cilat rriten nga 13 në 21 kumtesa dhe përfaqësojnë rreth 81,2% të totalit në vitin 2023-2024 dhe 84,0% në 2024-2025. Kjo tregon se, edhe pse volumi absolut mbetet më modest se ai i fakulteteve të tjera të mëdha, FSHP ka një profil pjesëmarrjeje të konsoliduar në konferenca ndërkombëtare me proceedings.

Fig. 16: Kumtesa te mbajtura nga personeli akademik i **FSHP** ne konferenca dhe aktivitetet te tjera shkencore




FSHP – Fakulteti Shkencave Pyjore/DID – Dep. Industrisë së Drurit/DP – Dep. Pyjeve/DFSHA – Dep. Fizikës dhe Shkencave të Aplikuara

IRGJ kalon nga një pjesëmarrje pothuajse simbolike në një prezencë shumë më të dukshme. Numri total i kumtesave rritet nga vetëm 1 kumtesë në vitin 2023-2024 në 10 kumtesa në 2024-2025, një rritje prej rreth +900%. Të gjitha kumtesat e vitit të parë ishin në një konferencë ndërkombëtare me proceedings, ndërsa në vitin 2024-2025 IRGJ raporton 4 kumtesa ndërkombëtare me proceedings dhe 6 kumtesa ndërkombëtare pa proceedings. Kështu, pesha e kumtesave ndërkombëtare me proceedings në total bie nga 100% në 40%, por në të njëjtën kohë rritet dukshëm volumi absolut i prezantimeve. Kjo tregon një aktivizim të qartë të institutut në rrjetet shkencore ndërkombëtare, duke u zgjeruar si në numër aktivitetesh, ashtu edhe në format e pjesëmarrjes.




IRGJB – Insituti Resurseve Gjenetike Bimore

Shpërndarja e kumtesave sipas fakulteteve tregon një tablo të balancuar, por me disa zhvendosje interesante. FEA dhe FBM ruajnë volumet më të larta absolute, me nga 158 dhe 133 kumtesa në të dy vitet radhazi. Megjithatë, për shkak të rritjes së përgjithshme të totalit të kumtesave, pesha e tyre relative në nivel UBT bie: FEA nga 37,8 % në 31,2 %, ndërsa FBM nga 31,8 % në 26,2 %. Rritja më e madhe në krahasim me vitin akademik të mëparshëm regjistrohet në FBU. Numri i kumtesave në FBU rritet nga 53 në 124 kumtesa, që përfaqëson një rritje prej rreth 134 %. Pesha e këtij fakulteti në totalin e kumtesave kalon nga 12,7 % në 24,5 %. FMV mbetet në një nivel të qëndrueshëm me 57 kumtesa në të dy vitet (rreth 11–14 % të totalit). Kontributi i FSHP rritet nga 16 në 25 kumtesa (+56,2 %), ndërsa IRGJ kalon nga një pjesëmarrje simbolike me vetëm 1 kumtesë në 10 kumtesa në 2024-2025, duke kaluar nga 0,2 % në rreth 2 % të totalit.



Kur numri i kumtesave korrigjohet me numrin e stafit akademik, vërehen qartë ndryshimet në koeficientin kumtesa/pedagog (Fig. 19). Mesatarja në rang universiteti rritet nga rreth 1,5 kumtesa për pedagog në 2023-2024 në rreth 1,9 në 2024-2025, pra një rritje prej afro 28–29 %. FBM (2.5) dhe FEA (2.3) ruajnë një profil të lartë pjesëmarrjeje me koeficient që rritet ndjeshëm krahasuar me 2023-2024 (përkatësisht 1,72 dhe 1,78 kumtesa/pedagog). FBU shënon kërcimin më të fortë, nga 1,39 në 3,54 kumtesa/pedagog (rritje rreth 154 %), duke e vendosur veten në krye për intensitet aktiviteti, pasuar nga rritjet pozitive në FSHP (0,64 → 0,89; +39,5%) dhe sidomos në IRGJ, ku koeficienti rritet nga 0,13 në 1,25 kumtesa/pedagog, nisur megjithatë nga një bazë shumë e ulët.

FIG. 19: NUMRI I KUMTESAVE PER PEDAGOG SIPAS FAKULTETEVE




Me qëllim vlerësimin e pjesëmarrjes së aktivitete shkencore në nivelin e njësive bazë, çka është më afër fushave të gjera të kërkimit shkencor në UBT, është paraqitur grafiku në vijim (Fig. 20). Analiza sipas njësive bazë tregon se në vitin 2024-2025 numri më i madh i kumtesave vijon të përqendrohet në fushat “Mjedis dhe Burime Natyrore” (60 kumtesa) për FBM, “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” (47) për FEA, “Shkenca Ushqimore dhe Bioteknologji” (44) për FBU dhe “Shkenca Bazë Veterinare” (29), duke konfirmuar rolin e tyre si shtylla kryesore të aktivitetit shkencor të UBT-së. Në shumë prej këtyre njësive numri i kumtesave është ruajtur ose është rritur lehtë, çka tregon një konsolidim të praktikës së prezantimit të rezultateve kërkimore.

**Fig. 20: Numri i kumtesave ne aktivitete shkencore kombetare dhe nderkombetare sipas departamenteve**




Kur e korrigjojmë numrin e kumtesave me atë të pedagogëve të njësisë, evidentojmë një aktivizim më të lartë në disa njësi bazë të cilat për shkak të numrit të vogël të anëtarëve, siç është 'Akuakultura dhe Peshkimi' dhe 'Gjuhët e Huaja'. Mesatarja në rang universiteti është pjesmarrje në 1.5 aktivitete shkencore, një tregues i ulët për ambiciet e institucionit.

Duke parë koeficientin kumtesa/pedagog në nivel njësish bazë, del më qartë në pah diferencimi i angazhimit kërkimor. Në vitin 2024-2025 spikasin **"Qendra e Kërkimit të Ushqimeve"** me rreth **5,5** kumtesa për pedagog (rritje nga 2,0 një vit më parë), **"Akuakulturë dhe Peshkim"** me rreth **4,1** kumtesa/pedagog, si dhe **"Shkenca Ushqimore dhe Bioteknologji"** ku koeficienti rritet nga rreth **0,7** në **3,7**. Po ashtu**, "Kimi", "Ekonomi dhe Politika e Zhvillimit Rural"**, **"Teknologji Agroushqimore"** dhe **"Gjuhët e Huaja"** mbeten ndër njësitë me koeficient mbi mesataren e universitetit. Në anën tjetër, fusha si **"Industria e Drurit", "Fizika dhe Shkencat e Aplikuara"** dhe **"Resurset Gjenetike Bimore"** vazhdojnë të kenë nivele shumë të ulëta pjesëmarrjeje, duke sinjalizuar hapësira të konsiderueshme për rritje.




Pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore gjatë vitit akademik 2024-2025 ka shënuar një rritje të dukshme krahasuar me 2023-2024, dhe me një rritje të dukshme të koeficientit kumtesa/pedagog. Pjesëmarrja dominuese mbetet në konferenca ndërkombëtare, çka tregon se stafi i UBT-së po e orienton gjithnjë e më shumë aktivitetin e vet drejt forumeve shkencore jashtë vendit. **Në total u raportuan 507 kumtesa, ndaj 418 kumtesave vitin e kaluar, që përfaqëson një rritje rreth 21,3 %. Rritja vjen kryesisht nga aktivitetet ndërkombëtare, ku numri i kumtesave është rritur nga 364 në 447 (+22,8 %), ndërsa kumtesat në aktivitete kombëtare janë rritur nga 54 në 60 (+11,1 %).** Rritja e fortë e pjesëmarrjes nga FBU, FSHP dhe IRGJ e bën më të balancuar profilin e UBT-së, megjithëse disa njësi bazë vazhdojnë të mbeten në nivele minimale. Kjo tablo sugjeron potencial për të thelluar më tej kulturën e publikimit dhe prezantimit shkencor në të gjitha fakultetet dhe njësitë, sidomos në fushat ku aktiviteti është ende i kufizuar.

Shifrat tregojnë se në 2024-2025 ka përmirësim jo vetëm në sasi, por edhe në **cilësinë formale** të pjesëmarrjes. Numri i kumtesave **me proceedings**, si në konferenca kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, është rritur nga **323** në **410** kumtesa, pra rreth **+26,9 %**. Si rezultat, pesha e kumtesave me proceedings në totalin e aktiviteteve rritet nga rreth **77,3 %** në **80,9 %**. Ndërkohë, kumtesat **pa proceedings** qëndrojnë pothuajse në të njëjtin nivel (95 → 97 kumtesa), por pjesa e tyre në total bie nga rreth **22,7 %** në **19,1 %**, çka tregon një tendencë pozitive drejt raportimit të punimeve në forma të plota dhe të cituara.